



KOMISIONI
EUROPIAN

Bruksel, 16.10.2013
SWD(2013)416

DOKUMENT PUNE I PERSONELIT TË KOMISIONIT

RAPORTI I PROGRESIT 2013 PËR KOSOVËN

Në përcjellje të dokumentit

**KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN DHE
KËSHILLIN EVROPIAN**

Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014

{ COM(2013) 700 final }

* Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS- të OKB-së 1244/199 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | | |
|---------|---|----|
| 1. | Hyrje | 3 |
| 1.1. | Parathënie..... | 3 |
| 1.2. | Konteksti..... | 3 |
| 1.3. | Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës | 4 |
| 1.4. | Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë | 5 |
| 2. | Kriteret Politike | 6 |
| 2.1. | Demokracia dhe sundimi i ligjit | 6 |
| 2.2. | Të drejtat e minoriteteve dhe mbrojtja e minoriteteve..... | 14 |
| 2.3. | Çështjet regjionale dhe obligimet ndërkombëtare | 19 |
| 3. | Kriteret Ekonomike | 21 |
| 3.1. | Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut | 21 |
| 3.2. | Kapaciteti i përballjes me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian | 26 |
| 4. | Standardet Evropiane | 28 |
| 4.1 | Tregu i brendshëm | 28 |
| 4.1.1 | Lëvizja e lirë e mallrave | 27 |
| 4.1.2. | Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit | 30 |
| 4.1.3. | Lëvizja e lire e kapitalit | 31 |
| 4.1.4. | Doganat dhe tatimet..... | 31 |
| 4.1.5. | Konkurrenca | 33 |
| 4.1.6. | Prokurimi publik..... | 33 |
| 4.1.7. | Ligji i pronësisë intelektuale..... | 34 |
| 4.1.8. | Politikat e punësimit dhe ato sociale, politikat e shëndetit publik..... | 34 |
| 4.1.9. | Arsimi dhe hulumtimi | 36 |
| 4.1.10. | Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)..... | 37 |
| 4.2 | Politikat sektoriale | 39 |
| 4.2.1. | Industria dhe NVM-të..... | 39 |
| 4.2.2. | Bujqësia dhe peshkataria..... | 39 |
| 4.2.3. | Mjedisi dhe ndryshimet klimatike | 41 |
| 4.2.4. | Politikat e transportit | 42 |
| 4.2.5. | Energjia..... | 43 |
| 4.2.6. | Shoqëria informative dhe mediat | 45 |
| 4.2.7. | Kontrolli financiar | 46 |
| 4.2.8. | Statistikat | 47 |
| 4.3. | Drejtësia, liria dhe siguria | 48 |

| | |
|---|----|
| 4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi..... | 48 |
| 4.3.2. Pastrimi i parave | 50 |
| 4.3.3. Droga | 51 |
| 4.3.4. Policia | 52 |
| 4.3.5 Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit..... | 53 |
| 4.3.6 Mbrojtja e të dhënave personale | 54 |

1. HYRJE

1.1. Parathënie

Komisioni i raporton rregullisht Këshillit dhe Parlamentit për progresin që janë duke bërë vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor drejt integrimit Evropian, duke vlerësuar përpjekjet e tyre për të përmbushur kriteret e Kopenhagës dhe kushtëzimet e Procesit të Stabilizimit Asociimit.

Ky raport i progresit, i cili në masë të madhe ndjek strukturën e njëjtë sikurse në vitet paraprake:

- Shkurtimisht përshkruan marrëdhëniet mes Kosovës * dhe Bashkimit Evropian;
- Analizon gjendjen në Kosovë në kontekst të kriterëve politike;
- Analizon gjendjen në Kosovë mbi bazën e kriterëve ekonomike;
- Shqyrton kapacitetin e Kosovës për të zbatuar standardet evropiane, d.m.th për përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave me ato të *acquis*, në përputhje me Procesin e Stabilizimit Asociimit dhe prioritetet e përcaktuara në studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës.¹

Ky raport përfshin periudhën nga tetori i vitit 2012 deri në shtator të vitit 2013.² Progresi matet në bazë të vendimeve të marra, legjislacionit të miratuar, si dhe masave të zbatuara. Si rregull, legjislacioni apo masat që janë në përgatitje apo në pritje të miratimit nga parlamenti nuk janë marrë parasysh. Kjo qasje siguron trajtim të barabartë në të gjitha raportet, si dhe mundëson një vlerësim objektiv.

Raporti bazohet në informatat e mbledhura dhe të analizuar nga Komisioni. Janë përdorur shumë burime tjera, duke përfshirë kontributet nga autoritetet e Kosovës, Shtetet Anëtare të BE-së, Misioni i BE-së për sundim të ligjit (EULEX), raportet e Parlamentit Evropian³ si dhe informatat nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Komisioni nxjerr konkludime më të detajuara në lidhje me Kosovën në komunikatën e tij të veçantë për zgjerimin,⁴ në bazë të analizave teknike që janë paraqitur në këtë raport.

1.2. Konteksti

Deri më sot, Kosova është njohur nga 104 Shtete Anëtare të KB-së, përfshirë këtu 23 Shtete Anëtare të BE-së.

Gjatë periudhës së raportimit, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së ka lëshuar katër raporte. Në raportet e tij, ai ka shprehur vlerësimin për rolin kyç të Bashkimit Evropian dhe Përfaqësuesen e Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri në lehtësimin e negociatave që rezultuan në 'Marrëveshja e parë e parimeve që qeverisin normalizimin e marrëdhënieve' të 19 prillit. Ai përgëzoi liderшипin në Prishtinë dhe Beograd, të cilat demonstuan një angazhim serioz dhe të palëkundur ndaj këtij dialogu.

Forca e udhëhequr nga NATO (KFOR) ka vazhduar të ndihmoj në ruajtjen e sigurisë në Kosovë. Gjatë periudhës raportuese, prezenca e saj përbëhet nga një personel rreth 5 000 veta.

* Ky emërtim është pa paragjykim për pozicionin mbi statusin, dhe është në përputhje me Rezolutën e KS- të OKB-së 1244/199 dhe Opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës

¹ COM(2012) 602 final.

² Në muajin prill 2013, Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë lëshuan një raport të përbashkët ad hoc mbi çështjet specifike në të cilën Këshilli i ka pasur, në dhjetor 2012, ka kërkuar informata shtesë, JOIN(2013) 8 final të datës 22.04.2013.

³ Raportuesja për Kosovë është Znj. Ulrike Lunacek.

Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014, COM(2013) 700.

Policia e Kosovës në mënyrë progresive ka marr përgjegjësinë nga KFOR-i për mbrojtjen e disa objekteve kulturore dhe fetare.

1.3. Marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës

Në qershor, Këshilli autorizoi hapjen e negociatave për **Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit** ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Negociatat do të hapen zyrtarisht këtë muaj. Para këtij vendimi, Kosova duhej të adresonte një numër të prioriteteve të përcaktuara në një studim të fizibilitetit (tetor 2012). Ajo duhej që të vazhdonte zbatimin në mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve të arritura mes Beogradit dhe Prishtinës dhe të angazhohej në mënyrë konstruktive në gamën e plotë të çështjeve, me lehtësimin e BE-së. Ajo duhej të ndërmerre hapa mbi disa prioritete afatshkurtër në fushën e sundimit të ligjit, administratës publike, mbrojtjes së minoriteteve dhe tregtisë.

Në muajin prill, Komisioni dhe Përfaqësuesja e Lartë lëshuan një raport të përbashkët lidhur me progresin e Kosovës. Raporti kokludoi se Kosova ka përmbushur të gjitha prioritetet afat-shkurtëra të nënvizuara në studimin e fizibilitetit. Bazuar në këtë, Komisioni paraqiti një propozim për një vendim të Këshillit që autorizon hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës.

Kosova tani duhet të përqendrohet në avancimin e fushave të identifikuara nga studimi i fizibilitetit për të përmbushur detyrimet e saj në kuadër të një Marrëveshjeje Stabilizim Asociimi: sundim të ligjit, gjyqësor, administratë publike, reforma zgjedhore, Kuvend, të drejtat e njeriut, të drejtat themelore, mbrojtjen e pakicave, çështjet tregtare, tregun e brendshëm, çështjet fitosanitare dhe veterinare.

Kosova merr pjesë në **Procesin e Stabilizim-Asociimit** dhe ajo është angazhuar në mënyrë konstruktive në Dialogun e Procesit të Stabilizim Asociimit (DPSA). Cikli i takimeve të vitit 2013 të DPSA-së u kompletua nga një mbledhje plenare dhe takim plenarë i shoqërisë civile i mbajtur në korrik. Në qershor, Kosova është angazhuar në një dialog me BE-në mbi reformën në administratën publike nëpërmjet një grupi të posaçëm për reformën e administratës publike. Është lansuar një dialog i strukturuar mbi sundimin e ligjit në vitin 2011 për të lehtësuar dhe për të monitoruar progresin në fushën e sundimit të ligjit. Deri më sot, janë zhvilluar dy takime në maj të vitit 2012 dhe në shkurt të vitit 2013.

Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar dialogu për **liberalizimin e vizave**. Në shkurt, Komisioni ka lëshuar raportin e parë mbi përpjekjet e Kosovës drejt liberalizimit të vizave dhe janë zhvilluar tre takime të zyrtarëve të lartë.

Në dhjetor, Kosova u bë anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe një Vend i Operimeve të BERZH-it. Në muajin maj, Kosova organizoi një konferencë donatorësh për energjinë e qëndrueshme. Në qershor, Këshilli i Bankës Evropiane për Zhvillim (CEB) u pajtua për anëtarësimin e Kosovës. Më 7 qershor, Banka Evropiane e Investimeve (EIB) nënshkruan një marrëveshje kornizë me Kosovën. Marrëveshja i lejon bankës që të vazhdoj me financimin e projekteve në Kosovë dhe që të siguroj asistencë teknike. Përfshirja e EIB-së gjithashtu do të lehtësojë bashkëfinancimin e projekteve me donatorë të tjerë dhe të mbështesë zbatimin e instrumenteve të ndryshme, të tilla si Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

Kosova merr **ndihmë financiare** në kuadër të Instrumentit për Asistencën Para-anëtarësimin (IPA), Instrumenti për Stabilitet (IFS) dhe burime të tjera të financimit. Kosova merr pjesë në programet shumë-përfutuese të IPA-s. Në vitin 2013, një total prej 71.4 milion € është ndarë për Kosovën sipas programit vjetor të IPA-së. Asistenca para Anëtarësimin e BE-së është përqendruar në mbështetjen e sundimit të ligjit, ekonomi, tregti dhe industri, dhe në reformën e administratës publike. Asistenca e IPA-së zbatohet nga Komisioni dhe Zyra e BE-së. Qeveria e Kosovës dhe

Komisioni aktualisht janë duke përgatitur një Dokument Strategjik gjithëpërfshirës për periudhën 2014-2020, i cili do të sigurojë një kornizë koherente dhe strategjike për asistencën financiare nën Instrumentin e ri të Para-Anëtarësimit (IPA II).

Pasuar nga Komunikata e Komisionit 'Kosova - Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane',⁵ Këshilli autorizoi Komisionin për të negociuar një marrëveshje kornizë me Kosovën për t'i mundësuar që ajo të marrë pjesë në **programet e BE-së**. Në muajin prill, pas pranimit të tekstit të marrëveshjes kornizë nga ana e Kosovës, Komisioni miratoi një propozim për të nënshkruar dhe për të arritur këtë marrëveshje. Propozimi, aktualisht është duke u diskutuar nga Këshilli.

Në vitin 2012, misioni i BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, është rikonfiguruar. Mandati i EULEX-it është vazhduar deri në qershor të vitit 2014. Misioni u shkurtua me rreth 25% dhe aktualisht operon me dy seksione: një Divizion Ekzekutiv, i cili punon në mandatin ekzekutiv të misionit, dhe një Divizion i Fuqizimit, i cila përqendrohet në monitorimin, mentorimin dhe këshillimin e autoriteteve të Kosovës. Në përgjithësi, gjatë periudhës raportuese, Kosova ka pasur një bashkëpunim të mirë me EULEX-in. Gjithashtu ka vazhduar të jetë plotësisht mbështetës i hetimit të Task Forcës Speciale Hetimore, në përputhje me angazhimin e tyre të mëparshme në këtë drejtim. Me ç'rast ka përmbushur prioritetet përkatëse afatshkurtra të përcaktuara në studimin e fizibilitetit. Kosova duhet të vazhdojë mbështetës zbatimin, në mënyrë aktive, të mandatit të misionit, duke përfshirë edhe atë të Task Forcës Speciale Hetimore.

1.4. Normalizimi i marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë

Kosova dhe Serbia kanë marrë pjesë në mënyrë aktive dhe konstruktive në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, proces i cili ishte ngritur në një nivel të lartë politik me lehtësim të Përfaqësuesit të Lartë pas zgjedhjeve të vitit 2012 të mbajtura në Serbi. Shtatëmbëdhjetë takime të nivelit të lartë u zhvilluan nga të dy Kryeministrat që nga tetori i vitit 2012. Një takim po ashtu u zhvillua midis presidentëve Nikoliq dhe Jahjaga në shkurt dhe ata i vazhduan këto takime në kontekst të iniciativave të ndryshme në muajt qershor dhe korrik. Që nga janari i vitit 2013, takimet e dy kryeministrave kishin përqendrim veriun e Kosovës dhe ofrimin e strukturave të cilët kanë përmbushur nevojat të sigurisë dhe të drejtësisë së popullsisë lokale në një mënyrë që siguron funksionalitetin e strukturës së vetme institucionale dhe administrative në Kosovë, në përputhje me Konkluzionet e Këshillit të dhjetorit të vitit 2012.

Më 19 prill këto diskutime rezultuan me një *'Marrëveshje të parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve'*, të plotësuar në muajin maj nga një plan i përgjithshëm i zbatimit. Kjo arritje historike përfaqëson një ndryshim rrënjësor në marrëdhëniet në mes të dy palëve. 'Marrëveshja e parë' përfshin elementet e mëposhtme kyçe: formimi i Asociacionit/Komunitetit të komunave serbe në Kosovë; parimi i një force të vetme policore në Kosovë dhe integrimin në veri të Kosovës i gjithë policisë në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës; parimi i integritetit dhe funksionimit të të gjitha autoriteteve gjyqësore brenda kornizës ligjore të Kosovës; dhe zgjedhjeve komunale që do të mbahen në komunat veriore në vitin 2013 të lehtësuara nga OSBE-ja - zgjedhjet komunale që më pas janë vendosur të mbahen me 3 nëntor të vitit 2013 dhe të cilat do të mbahen në tërë Kosovën. Të dyja palët kanë rënë dakord që asnjëra të mos bllokojë, apo inkurajojë të tjerët për të bllokuar progresin e palës tjetër drejt rrugës së tyre përkatëse për në BE-së.

Në muajin shtator, palët po ashtu arritën marrëveshje mbi energjinë dhe telekomunikacionin. Zbatimi i marrëveshjeve tjera të arritur gjatë bisedimeve që janë zhvilluar deri më sot ka vazhduar. Marrëveshja për përfaqësimin e Kosovës është zbatuar në përgjithësi. Në muajin shkurt Kosova u bë pjesëmarrëse në Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal (KBR). Zbatimi i plotë i parimit të bashkëpunimit rajonal gjithëpërfshirës mbetet të sigurohet; problemet e tilla të hasura si ato në samitin e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF) duhet të shmangen. Për sa i përket MIK-ut, janë hapur pika të përbashkëta kufitare të përkohshme në të gjitha gjashtë hyrjet, të cilat janë funksionale dhe operuese. Marrëveshja e muajit dhjetor

mbi mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore është duke u zbatuar, por duhet rritur angazhimi i serbëve të Kosovës. Në muajin qershor ka filluar zbatimi i marrëveshjes mbi aranzhimet e ndërlihdjes.

Të dy palët gjithashtu kanë dakord për fillimin e mbledhjes së detyrimeve doganore dhe ngritjen e një fondi për zhvillimin e veriut të Kosovës. Sa i përket lëvizjes së lirë, regjimi i udhëtimit me letërnjoftim është funksional. Marrëveshja për vulat doganore vazhdon të zbatohet nga të dyja palët. Ka pasur po ashtu progres të mirë në regjistrin civil, zbatimi duhet të përfundojë deri në mars të vitit 2014. Sa i përket kadastrin, derisa zbatimi ka filluar në anën serbe, kurse nga ana Kosovare duhet të miratohet legjislacioni i nevojshëm për zbatimin e marrëveshjes mbi kadastrin. Zbatimi i marrëveshjes për pranimin e diplomave universitare po ecën normalisht.

Në përgjithësi, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë, të cilat tashmë kanë sjellur një numër të ndryshimeve të pakthyeshme në terren.

Gjatë periudhës raportuese, një numër i incidenteve të sigurisë ka ndodhur në pjesën veriore të Kosovës. Më 19 shtator, një pjesëtar i EULEX-it u vra në një sulm ndaj një autokolone të EULEX-it në veri të Kosovës. Liderhipi i Kosovës dhe Serbisë dënoi sulmin me fjalët më të ashpra. Më 8 mars, EULEX-i ka nisur një operacion të përbashkët me policinë e Kosovës dhe KFOR-in për ndalimin e një serie të sulmeve me granata të dorës në veri të Mitrovicës. Trazirat të mëtejshme janë raportuar pas inicimit të marrëveshjes së 19 prillit. Disa udhëheqës të serbëve të Kosovës, bënë thirrje për një referendum mbi marrëveshjen dhe kërcënuan të bojkotojnë zbatimin e saj. Përmbajtja dhe qasja përfshirëse e Prishtinës, se bashku me rolin pozitiv të Beogradit, kanë penguar shkallëzim e mëturshëm të situatës.

Stacionet policore serbe që veprojnë në veri të Kosovës janë mbyllur gradualisht mes 14 qershorit dhe 5 korrikut, që nga atëherë nuk ka më asnjë shenjë të aktivitetit funksional. Autoritetet serbe gjithashtu kanë ndaluar pagat për policet serb tashmë të punësuar nga policia e Kosovës në veri të Kosovës. Që nga 15 korriku gjykatat dhe prokuroritë paralele serbe ndaluan ndjekjen penale dhe gjykimin e rasteve kriminale në Kosovë. Është në vazhdim e sipër integrimi i policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë të Kosovës të punësuar më parë nga autoritetet serbe. Janë shpërbërë kuvendeve komunale të katër komunave veriore.

2. KRITERET POLITIKE

Ky seksion ekzaminon progresin e Kosovës drejt përmbushjes së kriterëve politike të Kopenhagës, të cilat kërkojnë stabilitet të institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve. Po ashtu monitoron bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore me vendet në zgjerim dhe Shtetet Anëtare dhe me përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, të tilla si bashkëpunimi me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

2.1. Demokracia dhe sundimi i ligjit

Parlamenti

Janë ndërmarrë hapa në përmirësimin e mbikëqyrjes së Kuvendit ndaj qeverisë, harmonizimit të planeve legjislativ në mes të Kuvendit dhe qeverisë, dhe transparencës së Kuvendit për shoqërinë civile. Kuvendi ka ndërmarrë aktivitete për vëzhgimin e punës së qeverisë, veçanërisht sa i përket rezultateve të dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës. Kuvendi po ashtu ka qenë në gjendje të demonstrojë unitetin politik dhe institucional mbi çështjet me rëndësi kyçe.

Në tetor të vitit 2012, Kuvendi miratoi një rezolutë për dialogun mbi normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Më 22 prill, u miratua një rezolutë mbi 'Marrëveshjen e parë mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve'. Kuvendi ratifikoi këtë marrëveshje në muajin qershor dhe ka miratuar ligjin për amnistinë në muajin korrik.

Kuvendi ka rritur numrin e debateve tematike parlamentare dhe interpelancat e ministrave. Gjatë periudhës raportuese, komitetet kanë ndërmarrë aktivitete të mëtejshme për monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe kanë gjeneruar raporte, disa prej tyre janë të bazuar nga vizitat e anëtarëve të Kuvendit në terren.

Konsultimet dhe dëgjimet publike me shoqërinë civile dhe ekspertët e pavarur për përgatitjen e legjislacionit të ri janë duke u bërë një tipar i shpeshtë. Kuvendi ka hapur një pozitë për një zyrtar për marrëdhënie me shoqërinë civile dhe koordinim të donatorëve. Në muajin prill, Kuvendi miratoi programin e vet të punës. Ky program kombinon agjendën legislative të qeverisë për vitin 2013, planet vjetore të punës për komitetet parlamentare dhe një plan veprimi për negociatat mbi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.

Vendimi i Kuvendit për të debatuar çështjen e ashtuquajtur Kiqina (në të cilën u gjetën fajtorë për vrasje ish-anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) dhe një përpjekje për të miratuar një vendim që ndërhyr me procesin gjyqësor ishte një hap prapa për përpjekjet e Kosovës për të ndërtuar institucione të pavarura dhe të forta të qeverisjes demokratike. Kjo është një çështje e serioze.

Kosova ka nevojë të finalizojë procesin e reformës zgjedhore që ishte nisur në vitin 2011. Kjo duhet të sigurohet që korniza ligjor për zgjedhjet i pasqyron më mirë praktikën më të mira në BE dhe se zbatimi është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Mbikëqyrja e qeverisë duhet të përmirësohet, duke përfshirë përcjelljen e rekomandimeve të komiteteve në ministri. Kuvendi gjithashtu ka nevojë të përmirësojë kuptimin e rolit të tij në mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullatorë. Në këtë drejtim, mekanizmat adekuate duhet të krijohen. Bazat ligjore të paqarta për raportim, koordinimi i dobët me qeverinë dhe në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit dhe dështimi për përcaktimin e mekanizmave të anëtarëve të bordit që të mbajnë përgjegjësi janë disa ndër sfidat kyçe të cilat duhet të adresohen. Kjo do të ndihmojë që të sigurohet emërimi në kohë i menaxherëve të pavarura dhe profesional si dhe anëtarëve të bordeve të këtyre institucioneve.

Janë të nevojshme përpjekjet e mëtejshme nga Kuvendi dhe komisionet e tij për të siguruar kontrollin e buxhetit, sidomos në fushat e tilla si shëndetësia, bujqësia, asistencë sociale, kultura dhe arsimit. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet raporteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Komisioni për mbikëqyrje të financave publike, gjithashtu ka nevojë të zhvillojë një mekanizëm për t'i përcjellur rekomandimet që u jepen organizatave buxhetore.

Është rritur numri i stafit që mbështet punën e komisioneve. Kapaciteti i komisioneve për të shqyrtuar projektligjet mbetet i kufizuar. Sekretariati i Kuvendit duhet të sigurojë të dhëna të koordinuara më mirë për departamentet e ndryshme të Kuvendit për komisionet. Projektligjet si dhe amendamentimet e legjislacionit kanë nevojë për ekzaminim më të mirë për harmonizim me *acquis-in*. Kuvendi ka nevojë të përmirësojë rregullat ekzistuese të procedurës, sidomos në sqarimin e efektit ligjor dhe kuptimit të vendimeve të ndryshme të bëra në seanca plenare. Duhet të merret parasysh ndarja e votës mbi amendamentet dhe votimi përfundimtar mbi një ligj në seancën plenare. Gjatë diskutimeve në Kuvend dhe komision janë vërejtur disa mangësi dhe shkelje të rregullave të procedurës (për shembull, koha e pamjaftueshme mes të prezantimit të një propozimi dhe diskutimi i tij në komision dhe seancë plenare).

Është përmirësuar pavarësia financiare e Kuvendit. Komisioni për buxhet i Kuvendit ka rritur përfshirjen e tij në konsultimet e qeverisë mbi projekt buxhetin e Kuvendit. Janë të nevojshëm hapa të mëtejshëm në rritjen e pavarësisë financiare dhe administrative të Kuvendit, sidomos

duke përmirësuar rregulloren e punës së Kuvendit, legjislacionin e Kuvendit përfshirë ligjin, dhe ndarje e infrastrukturës së TI-së së Kuvendit nga qeveria.

Në përgjithësi, Kuvendi ka vazhduar rritjen graduale të kapaciteteve dhe përmirësimin e rolit të tij në qeverisje demokratike. Debati në lidhje me rastin e Kiqines ishte një hap mbrapa sa i përket kësaj çështje. Kuvendi dhe institucionet e tij duhet të fokusohen në prioritetet e identifikuar në studimin e fizibilitetit, posaçërisht sa i përket reformës zgjedhore, funksionit të kontrollit dhe mbikëqyrjes, pavarësisht financiare si dhe administrative të kuvendit.

Qeveria

Qeveria e Kosovës ka rritur kapacitetin e saj për adresimin e prioritetëve për procesin e integritimit Evropian. Përcjellja e prioritetëve afatshkurta të studimit të fizibilitetit tregon qartë këtë, siç e bën këtë edhe përgatitja për negociatat e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Këshilli Kombëtar për Integritim Evropian në kuadër të Zyrës së Presidentes ka vazhduar të përmbush dhe të ndjekë objektivin e zhvillimit të konsensusit për integritimin evropian.

Qeveria ka miratuar një strategji ambicioze legjislative të ndjekur nga një plan vjetor i punës. Agjenda legjislative mbetet subjekt i ndryshimeve të shpeshta. Një themelimi i qartë institucional dhe ndarja e përgjegjësisë kanë kontribuar në koordinim më të mirë të agjendës së BE-së dhe prioritetëve të saj përbrenda qeverisë. Ministrinë kanë filluar gjithashtu të ndjekin kërkesat e reja për konsultime ndër-ministore. Kjo është një bazë e mirë për të menaxhuar ngarkesën gradualisht në rritje të punës së procesit të integritimit evropian. Qeveria ka përmirësuar harmonizimin me rregulloren e punës. Prezantimi i tabelës së pajtueshmërisë të *acquis-it* është një hap para dhe duhet të përdoret në mënyrë sistematike. Një sistem i dokumenteve ideore që i parapriu projektligjeve dhe vendimeve politike është vendosur, është përgatitur një numër i dokumenteve.

Qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin, ende ka nevojë të përmirësojë kapacitetin e saj për verifikimin dhe konfirmimin e përputhshmërisë së legjislacionit me *acquis-in e BE-së*. Planifikimi i paraprak dhe analiza e kostos së zbatimit të legjislacionit mbetet sfidë. Strategjitë duhet të jenë të koordinuara mirë në mënyrë që të shmangin mbivendosjen dhe mospërputhjen. Zbatimi i politikave dhe legjislacionit që përfshijnë disa ministri kanë nevojë të përmirësohen. Kapaciteti për të menaxhuar agjendën e integritimit në BE është shpërndarë në mënyrë të pabarabartë në gjithë qeverinë, sidomos në aspektin e cilësisë së burimeve njerëzore.

Vazhdon të jetë një çështje shqetësuese fakti që anëtarët e qeverisë ende mungojnë në interpelanca ose mbledhje relevante të komisioneve parlamentare. Kjo parandalon Kuvendin të kryej funksionin e tij mbikëqyrës. Ministrinë gjithashtu kanë nevojë të përmirësojnë përcjelljet nga kërkesat e komisioneve parlamentare.

Qeveria lokale po ashtu ka përmirësuar kapacitetin e saj. Kjo përfshin shembujt e adresimit të kthimit dhe ri-integritimit, transparencës së informacionit për menaxhim dhe buxhet, dhe raportimin mbi vendimmarrjen komunale. Ka pasur shembuj të përmirësimeve në organizimin e administratës komunale. Në tetor të vitit 2012, Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore e krijuar nga autoritetet Kosovare u bë funksionale. Zyra ka 54 të punësuar, prej të cilëve rreth 70% prej tyre janë serbë, disa prej të cilëve janë përballur me kërcënime dhe sulme sporadike në pasuritë e tyre gjatë periudhës së raportimit.

Komunat do të përfitojnë nga udhëzimet më të qarta nga niveli qendror dhe planifikimi i integruar (prioritetet e politikës së bashku me buxhetimin). Puna dhe vendimet e komunave duhet të jenë më transparente. Komunat e vogla dhe rurale të themeluara në vitin 2009 - 2010 kanë nevojë për zgjidhje alternative institucionale ashtu që ata të mund të ofrojnë qasje të barabartë në shërbime. Menaxhimi i tokës duhet të adresohet për të siguruar zhvillimin e tyre ekonomik.

Zgjedhjet komunale të nëntorit do të zhvillohen nën kornizën e tanishme ligjore për shkak të mungesës së progresit në reformën zgjedhore. Në bazë të marrëveshjes së 19 prillit, Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe në Kosovë është paraparë të themelohet pas zgjedhjeve komunale. Kjo do të kërkojë përpjekje të qëndrueshme nga të gjithë të interesuarit.

Në përgjithësi, strukturat themelore për qeverisje në të dy nivelet, qendrore dhe lokale janë krijuar. Kapaciteti ndryshon nëpër ministri të ndryshme. Niveli komunal është ende i dobët. Mbledhja e të dhënave, vlerësimet e ndikimit financiar, objektivat e politikave dhe koordinimi ndër-ministror duhet të luajë një rol më të madh në procesin legjislativ. Janë të nevojshme përpjekjet e mëtejshme për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së qeverisë, duke përfshirë edhe atë në nivel komunal. Autoritetet lokale kanë nevojë për më shumë mbështetje për të vazhduar me procesin e decentralizimit.

Administrata publike

Kosova ka përmbushur prioritetet afatshkurtra të studimit të fizibilitetit në fushën e administratës publike. Ka miratuar legjislacionin dytësor të ligjeve mbi shërbimin civil dhe pagesat për shërbyesit civilë. Kosova ka filluar zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për administratën publike. Në muajin qershor, përmes grupit të veçantë mbi administratën publike, Kosova ka filluar një dialog me BE-në mbi këto çështje. Në muajin dhjetor, Kuvendi miratoi një shkallë të përkohshëm të pagesave për institucionet e përzgjedhura të pavarura të mbikëqyrjes siç është Institucioni i Avokatit të Popullit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe Komisioni i Pavarur për Media.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka vazhduar të përqendrohet në promovimin e menaxhimit të shëndoshë financiar të administratës publike dhe llogaridhënies përgjatë qeverisë. Kjo përfshin ngritjen e një funksioni të qëndrueshëm të auditimit të performancës. Është rritur bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i kësaj zyrë. Instituti i Kosovës për Administratë Publike ka vazhduar të ofrojë trajnime për shërbyesit civilë.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit mbi reformën në administratën publike vazhdon të jetë një sfidë e madhe për Kosovën. Kjo kërkon më tepër burime njerëzore dhe buxhetore. Planifikimi i aktiviteteve duhet të rregullohet për t'i pasqyruar burimet që janë në dispozicion. Zbatimi i ligjit për pagat e shërbyesve civilë ka mbetur pezull në pritje të finalizimit të klasifikimit të punës. Duhet të fillojë vlerësimi i performancës për shërbyesit civilë. Legjislacioni i ri është i nevojshëm për rregullimin e pagave për zyrtarët e lartë dhe të reformojë sistemin e pagave për sektorë të rëndësishëm siç janë arsimit dhe shëndetësia.

Autoritetet Kosovare duhet të sigurojnë një përcjellje të duhur të rekomandimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil. Momentalisht, kjo nuk është duke ndodhur me një numër të konsiderueshëm të rekomandimeve. Ndarja dhe distribuimi i shërbyesve civilë që u përkasin minoriteteve neper ministri të ndryshme duhet të jetë në përputhje me legjislacionin. Kosova gjithashtu duhet të rishikojë organizimin e administratës publike në nivel komunal, veçanërisht në kompetenca të deleguara dhe emërtim të drejtorëve.

Në përgjithësi, Kosova ka miratuar legjislacionin dytësor të ligjeve mbi shërbimin civil dhe pagat e shërbyesve civilë. Reforma e administratës publike vazhdon të karakterizohet në përgjithësi nga mungesa e profesionalizmit dhe motivimit nga ana e stafit. Ekziston edhe ndërhyrja politike në shërbimin civil. Kosova duhet të përqendrohet në prioritetet e përcaktuara në studimin e fizibilitetit, veçanërisht në zbatim të legjislacionit, strategjisë dhe planit veprues.

Avokati i popullit

Kosova përmbushi prioritetet afatshkurtra të studimit të fizibilitetit në lidhje me Avokatin e Popullit. Numri i personelit dhe buxheti i institucionit të Avokatit të Popullit është rritur. Qeveria ka ndarë hapësira të reja për këtë institucion. Tani ka burime të nevojshme për t'i kryer detyrat e veta. Qeveria ka respektuar pavarësinë e Avokatit të Popullit duke mos ndryshuar buxhetin e zyrës kur është dorëzuar buxheti i përgjithshëm në parlament. Pavarësia buxhetore e Avokatit të Popullit duhet të bëhet më e qëndrueshme. Gjatë vitit 2012, Avokati i Popullit ka pranuar 20% më shumë peticione nga publiku sesa në vitin e kaluar. Autoritetet e Kosovës kanë nevojë të përmirësojnë zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë

Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës ka shqyrtuar një numër më të madh të ligjeve sesa në periudhën e kaluar raportuese. Mbikëqyrja e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës gjithashtu është përmirësuar dhe komisioni përkatës parlamentar është takuar më shpesh. Vetëm anëtarët e parlamentit me leje të lëshuar nga një zyrë nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të agjencisë së inteligjencës mund të marrë një rol efektiv në komision. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar mbikëqyrje adekuate civile të forcave të sigurisë. Kuvendi ka nevojë të përmirësoj profesionalizmin dhe ekspertizën e tij mbi çështjet e sigurisë. Në muajin korrik, Këshilli i Atlantikut të Veriut ka deklaruar se Forca e Sigurisë së Kosovës ka arritur kapacitetin e saj të plotë funksional.

Shoqëria civile

Task- forcat për integrimin Evropian dhe Këshilli Kombëtar për integrimin Evropian kanë vazhduar të përfshijnë përfaqësuesit lokal të shoqërisë civile. Strategjia e qeverisë dhe plani i veprimit mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile për vitet 2013-2017 u përgatit me përfshirjen e përfaqësuesve të shoqërisë civile. U miratua gjatë muajit korrik. Bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Kosovës vazhdon të jetë ad-hoc. Edhe atëherë kur të ndodhin konsultime publike për projekt-legjislacione, përcjellja shpesh është e pakënaqshme. Ka një financim publik të kufizuar për p.sh. shërbimet sociale të ofruara nga shoqëria civile në emër të autoriteteve. Autoritetet qendrore dhe lokale kanë nevojë të përmirësojnë bashkëpunimin me shoqërinë civile, sidomos sa i përket përshkrimit dhe ekzekutimit të politikave publike.

Sistemi gjyqësor

Në muajin janar u prezantua një sistem i ri gjyqësor dhe një kod i ri penal si dhe ka hyrë në fuqi kodi i procedurës penale. Gjykata Supreme ka lëshuar një opinion formal për korrigjimin e paqartësive në lidhje me zbatimin retroaktiv të dispozitave kalimtare në lidhje me pranimin e provave para-gjyqimit në rastet që kanë filluar para se kodi i ri procedural të hyjë në fuqi. Përqendrimi tani duhet të jetë mbi zbatimin e legjislacionit. Zbatimi i legjislacionit mbi sistemin e certifikimit për përkthyesit dhe interpretuesit duhet të miratohet. Në përgjithësi, rishikim i sistemit të ri të gjykatave dhe prokurorive është i nevojshëm për vlerësimin e progresit.

U miratua një ligj mbi zyrën e Avokaturës së Shtetit. Instituti Gjyqësor i Kosovës ka vazhduar të ofrojë trajnime për aftësim ligjor duke u përqendruar në ngritje të kapaciteteve. Në muajin korrik u organizua me sukses provimi pranues për gjyqtarë dhe prokurorë. Kosova ka lidhur marrëveshje dypalëshe për ndihmë të ndërsjellët juridike me Shqipërinë dhe Italinë. Ministria e Drejtësisë vepron bazuar me kërkesat për ndihmë të ndërsjellët juridike të pranuar nga

vendet që nuk e njohin Kosovën, qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet EULEX-it. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbetet pikë zyrtare e kontaktimit me Interpolin. Kosova ka nevojë të zgjeroj kapacitetet e veta dhe përvojën për të qenë një partner efektiv në kuadër të ndihmës së ndërsjellët juridike.

Sa i përket *pavarësisë dhe paanshmërisë*, janë raportuar rastet e ndërhyrjes politike në gjyqësor. Kjo përfshin pikat e bëra nga qeveria dhe Kuvendi mbi vendimet në lidhje me krimet e luftës (grupi i Kleçkës dhe Drenicës). Kjo është vërejtur po ashtu edhe nga Gjykatat Supreme dhe Kushtetuese. Ka pasur edhe një përpjekje nga ana e Kuvendit për të hetuar një rast që kishte kaluar në të gjitha hapat e procedurës gjyqësore (rasti Kiqina). Në shqyrtimin e një çështje penale (që përfshin një kryetar komunal) në janar, Gjykata Kushtetuese, duke marrë përsipër rastin dhe duke e referuar atë rast përsëri në Gjykatën Supreme për rishqyrtim, gabimisht sugjeroi se ajo mund të merr përsipër të veprojë si gjykatë (shtesë) e shkallës së fundit.

Në vitin 2012, 0.47% e BPV-së është shpenzuar në buxhetin për gjyqësorin. Të dy Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial kanë miratuar kodet e etikës. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial kanë forcuar procedurat e nevojshme dhe kanë nënshkruar memorandume mirëkuptimi me policinë për të garantuar sigurinë e duhur dhe masat mbrojtëse për gjyqtarët, prokurorët dhe personelin tjetër gjyqësor. Kosova ende ka nevojë të bëjë më shumë për të zbutur rreziqet e formave të tërthorta të frikësimit apo ndikimit mbi stafin e sistemit gjyqësor dhe dëshmitarët.

Mbeten të emërohen edhe dy anëtar të Këshillit Gjyqësor. Për të garantuar pavarësinë gjyqësore, një shumicë e konsiderueshme e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor duhet të zgjedhën nga kolegët e tyre. Kosova duhet të bëjë ndërrimet e nevojshme për të lejuar këtë. Gjykata Kushtetuese ka nëntë gjykatës duke përfshirë tre gjykatës ndërkombëtar. Nuk janë plotësuar të gjitha pozitat në Gjykatën Kushtetuese, gjë që mund të paraqes një sfidë për të përbërë kuorumin prej shtatë gjykatësve. Këshilli Gjyqësor ka përmbushur 334 prej 404 pozitave në përgjithësi dhe 125 nga 146 pozitat për prokurorë janë plotësuar. Të dy edhe Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial vazhdojnë të përballen me sfida në plotësimin e vendeve të rezervuara për personat që u përkasin minoriteteve. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të sigurohet se personat e emëruar për pozitën e gjyqtarit apo prokurorit të kenë përvojën e nevojshme profesionale dhe të plotësojnë kushtet e caktuara Kalimi i programit fillestar të arsimit ligjor duhet të mbetet pjesë e kriterit të përshtatshmërisë që një kandidat të kualifikohet si gjykatës apo prokurorë.

Sa i përket *përgjegjshmërisë*, Këshilli Gjyqësorë ka miratuar legjislacionin zbatues mbi organizimin dhe aktivitetet e Këshillit, dhe mbi emërimin dhe vlerësimin e gjyqtarëve. Një panel për vlerësimin e performancës së gjykatësve ka kryer vlerësimet e para në funksion të vërtetimit të mandateve fillestare të gjykatësve. Sanksionet disiplinore janë shqiptuar në 14 raste nga Këshilli Gjyqësorë (në vitin 2013) dhe në 11 raste nga Këshilli Prokurorial (në vitin 2012 dhe 2013). Asnjë prej tyre nuk ka rezultuar me shkarkim. Duhet të forcohet kodi i sjelljes së gjyqtarëve. Rregulloret disiplinore në të dy këshillat duhet të rregullohen për të garantuar që procedurat disiplinore dhe politikat në luftën kundër korrupsioni në gjyqësorë të dërgojnë në rezultate konkrete.

Sa i përket *efikasitetit*, Këshilli Gjyqësor ka krijuar strukturën e re të gjykatës. Ka emëruar me shpejtësi kryetarët e rinj të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës themelore. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial kanë miratuar rregullore mbi organizimin e brendshëm dhe funksionimin e zyrave të gjykatave dhe prokurorive, duke e finalizuar kështu kornizën për zbatimin e reformës gjyqësore. Vonesat në transfere të rasteve janë mbajtur në minimum. Ngarkesat e gjykatave janë duke u shqyrtuar. Duhet të përmirësohet administrata e gjyqësorit si dhe alokimi i rasteve në zyrat e prokurorisë dhe në të gjitha gjykatat. Mungesa aktuale e sallave të gjykatës pritet të përmirësohet në të ardhmen si rezultat i rinovimeve të vazhdueshme.

Sistemi i ri prokurorial kërkon vendosjen e një zyre të re të ankesave të prokurorisë dhe kalimin në një sistem me shtatë zyre të prokurorisë themelore krahas prokurorisë speciale. Këshilli Prokurorial dhe Prokurori i Shtetit në përgjithësi kanë transferuar dosjet brenda një kohe të arsyeshme. Megjithatë, në disa raste, duke përfshirë edhe rastet e mashtrimeve, nuk janë transferuar deri në muajin maj. Ka pasur vetëm progres të kufizuar në lidhje me rastet që përfshijnë mashtrimin gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010. Të gjitha 232 aktakuzat janë paraqitur, por që nga shtatori i vitit 2013, një numër i konsiderueshëm i tyre mbetën që të gjykohen.

Zbatimi i strategjisë dy-vjeçare për të zvogëluar numrin e rasteve të vjetruara deri në dhjetor të vitit 2008 rezultoi në një reduktim të rasteve të vjetruara prej rreth 65%, duke lënë rreth 63 500 raste të pazgjidhura. Përveç kësaj, Kosova ka nevojë të adresoj rastet e mbetura që janë mbledhur gjatë viteve të fundit. Në fund të vitit 2012, numri i përgjithshëm i rasteve që presin të zgjidhen para gjykatave themelore ishte mbi 218 740. Ky numër është rritur në mbi 235 000 raste në vitin 2013, pjesërisht për shkak të reformës së gjykatave, që ka dërguar në përfshirjen e rasteve të kundërvajtjeve të lehta në statistika. Në sistemin aktual të regjistrimit të rasteve, është e mundshme që rasti i njëjtë është numëruar disa herë. Duhet të zbatohet plotësisht shpërndarja e rasteve dhe sistemi i menaxhimit. Ka një numër të madh të rasteve (mbi 100 000) të vendimeve që ende duhet të ekzekutohen. Si pjesë e strategjisë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, një ligj i ri mbi procedurat e zbatimit ka prezantuar një sistem të përmbartimit privat me synim të reduktimit të numrit të rasteve që presin të ekzekutohen. Kosova duhet të siguroj një mbikëqyrje adekuatë të këtyre akterëve privat.

Në gjykatën themelor të Mitrovicës gjatë periudhës raportuese janë mbajtur vetëm gjykime penale nga EULEX-i.

Puna e prokurorisë speciale është ngadalësuar; numri i kufizuar i prokurorëve vendor nuk janë në gjendje të marrin raste të reja, për shkak të ngarkesës së punës ekzistuese. Shtatë nga pesëmbëdhjetë pozitat për prokurorë vendorë duhet të plotësohen. Kosova duhet të rrisë përpjekjet për rekrutimin e tyre, pasi që puna dhe juridiksioni i saj janë jetik për trajtimin e rasteve të rëndësishme, rasteve të nivelit të lartë dhe atyre të ndjeshme. Në këtë moment, ka mungesë të kapacitetit dhe angazhimit për të hetuar krimet që bien nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale.

Për të siguruar *qasje më të mirë në drejtësi*, zyrat e ndihmës juridike janë themeluar në 11 komuna. Kosova gjithashtu ka një klinikë mobile të ndihmës juridike. Autoritetet e Kosovës duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë qasshmërisë në drejtësi nga viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, grave dhe fëmijëve. Një total prej 99 ndërmjetësve janë të licencuar dhe gjashtë qendra ndërmjetësimit operojnë në tërë Kosovën. Gjatë vitit 2012 dhe 2013, më shumë se 300 raste i janë referuar qendrave të ndërmjetësimit. Pothuajse gjysma e rasteve kanë përfunduar me sukses gjatë procesit të ndërmjetësimit

Në përgjithësi, Kosova duhet të adresoj prioritetet e studimit të fizibilitetit. Ndërhyrjet politike në punën e gjyqësore mbetet një shqetësim serioz. Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të përgjigjen me vendosmëri ndaj sulmeve kundër individëve dhe institucioneve gjyqësore. Degët e tjera të qeverisë duhet të bëjnë të njëjtën. Nevojat për siguri të stafit gjyqësor, dëshmitarëve dhe të paditurve duhet të trajtohen. Kosova duhet të siguroj zbatim efikas të legjislacionit. Duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë harmonizimit të legjislacionit primar dhe legjislacionit zbatues. Juridiksioni i prokurorisë speciale duhet të mirëmbahet dhe kapacitetet lokale të forcohen. Numri i rasteve të vjetra kërkon përpjekje të vazhdueshme. Përmirësimi i përpunimit të të dhënave dhe menaxhimi i rasteve do të ndihmojë në këtë drejtim.

Lufta kundër korrupsionit

Korniza legjislative kundër korrupsionit është e vendosur në masë të madhe. Ndryshimet në ligjin për financimin e partive politike janë miratuar për të trajtuar mangësitë e mëhershme (p.sh. rregullon donacionet nga subjektet juridike të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime për

organet qeveritare). Kodi i rishikuar Penal ka prezantuar veprat penale për konfliktin e interesit, dhe për deklarimin e rrejtshëm të pasurisë nga zyrtarët publik, apo për dështimin e tyre të deklarimit të pasurisë. Në muajin shkurtë, Kuvendi miratoi strategjinë e re dhe planin e veprimit (2013-2017) kundër korrupsionit, një prioritet afatshkurtër i studimit të fizibilitetit të vitit 2012. Për herë të parë, një vlerësim i rrezikut nga korrupsioni që mbulon sektorët me prioritet i është bashkangjitur strategjisë.

Gjatë periudhës raportuese, departamenti special kundër korrupsionit në policinë e Kosovës në bashkëpunim me EULEX-in ka filluar gjashtë hetime. Ata mbuluan vepra penale si keqpërdorimi i pozitës zyrtare, dhënia dhe marrja e ryshfetit, si dhe mashtrimet. Agjencia Kundër Korrupsionit ka vazhduar të koordinoj zbatimin e strategjisë, të ligjeve mbi deklarimin e pasurisë nga zyrtarët publik dhe për parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit. Agjencia ka kapacitete të mjaftueshme për të kryer detyrat e saj aktuale. Është përmirësuar bashkëpunimi në mes Agjencisë dhe prokurorisë. Prokuroria tani ofron reagime sistematike për Agjencinë mbi përcjelljen e rasteve. Këshilli Prokurorial gjithashtu ka krijuar një rrjet të prokurorëve që koordinon luftën kundër korrupsionit në gjashtë zyrat e prokurorive themelore dhe në zyrën e Prishtinës. Ka pasur një rritje të ndjekjeve penale kundër personave në pozita të larta në nivelin lokal dhe në atë qendrorë. Janë të nevojshme përpjekjet e vazhdueshme për të siguruar përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe politikanëve të nivelit të lartë.

Në vitin 2012, më pak se 1% e zyrtarëve publik nuk e kanë deklaruar pasurinë e tyre. Rastet përkatëse janë dërguar në prokurori. Kur është fjala për verifikim, agjencia së pari e bën një kërkim sistematikë paraprak për gabimet apo informatat që mungojnë. Si pasoj e kësaj, përafërsisht në rreth 20% të parashtrësive, janë ndërmarrë kontrollet thelbësore, me një fokus mbi ato kategori të zyrtarëve, me një shkallë të lartë të përgjegjësisë apo që janë të ekspozuar ndaj pozitave të ndjeshme (të tilla si prokurimi publik), ose në rastet që duken të dyshimta. Hapat e parë janë ndërmarrë për të përmirësuar raportimin në luftën kundër korrupsionit. Në nëntor, Këshilli Prokurorial ka miratuar një strategji për bashkëpunimin ndër-institucionale në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Çështja kryesore shqetësuese mbetet zbatimi i kornizave ligjore dhe politike. Bashkëpunimi ndërmjet agjencive të përfshira vazhdon të jetë i dobët. Deklarime të rreme dhe konfliktet e interesit ende trajtohen si kundërvajtje administrative, ndërsa Kodi Penal i parashikon si vepra penale. Kjo mospërputhje duhet të trajtohet si një çështje prioritare. Numri i rasteve të përcjella nga prokuroria mbetet nën 10%. Vetëm pak raste rezultojnë me ngritje të aktakuzës. Për të përmirësuar zbatimin, autoritetet e tjera (administrata tatimore, njësia hetimore financiare dhe prokuroria) duhet t'i ofrojnë Agjencisë Kundër Korrupsionit informacionet e nevojshme.

Strategjia e re kundër korrupsionit nuk është përkrahur me buxhet apo me një vlerësim të burimeve të nevojshme. Asaj i mungojnë mekanizmat detyrues në mënyrë që institucioni të përmbush përgjegjësitë e tij. Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit kërkon pronësi më të madhe nga të gjithë akterët e përfshirë, përkrahje të vazhdueshme në nivelin më të lartë politik dhe angazhim nga të gjithë palët që janë të përfshira. Vlerësimi i rrezikut të zonave të rrezikuara duhet të rishikohet rregullisht.

Mbi parandalimin e konfliktit të interesit, agjencia ka theksuar se më shumë se 800 zyrtar publik kanë më shumë se dy vende të punës (disa deri në pesë). Agjencia rekomandoi që zyrtarëve nuk u lejohet që të mbajnë në të njëjtën kohë më shumë se një vend të punës që përfshinë një shkallë të caktuar të përgjegjësisë (financiare). Nuk ka pasur përcjellje mbi këtë këshillë. Për më tepër, ende ka raste në të cilat personat nuk i ndalojnë përfshirjen e tyre aktive në bizneset private, apo nuk i ofrojnë Agjencisë deklaratat e kërkuara në këtë drejtim kurë i pranojnë postet publike.

Vendosja institucionale për t'u përbashkuar me korrupsionin mbetet e ndërlikuar. Sistemi është i ndarë, me role dhe përgjegjësi të paqarta. Nuk ka sistem të përbashkët të statistikave. Këshilli

Kombëtar Kundër Korrupsionit u krijua me qëllimin për të siguruar përgjegjësi dhe llogaridhënie të institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, këshilli nuk mban takime të rregullta. Për më tepër, takimet e tij janë publike dhe numri i pjesëmarrësve është rritur. Kjo ngritë shqetësime në lidhje me efikasitetin dhe autoritetin e këtij këshilli.

Task Forcës kundër korrupsionit në kuadër të prokurorisë speciale, e përbërë nga prokurorët vendor dhe ndërkombëtar, hetuesve të policisë së Kosovës dhe ekspertëve kundër korrupsionit, i mungojnë dy nga pesë prokurorët vendor. Kjo në mënyrë të konsiderueshme ngadalëson hetimet, edhe nëse dy prokurorët janë alokuar për task forcën në baza të përkohshme. Për më tepër, anëtarëve të task forcës nga policia u mungon hapësira dhe pajisjet themelore. Mungon ekspertiza e kontabilitetit financiar në mjekësinë ligjore. Përveç task forcës, zyrat e prokurorisë lokale janë gjithashtu përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit. Rezultatet e tyre deri më tani kanë qenë të kufizuara.

Në përgjithësi, Kosova ka përmbushur prioritetet afatshkurtra të studimit të fizibilitetit. Ka miratuar një strategji të re kundër korrupsionit dhe Kosova e ka mbajtur angazhimin në luftën kundër korrupsionit. Për të plotësuar obligimet e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, Kosova duhet të zbatoj kornizat dhe politikat legislative dhe politike, si dhe të ofroj prova konkrete të rezultateve në luftën kundër korrupsionit. Parandalimit efektiv të korrupsionit në të gjitha nivelet e shoqërisë duhet t'i jepet prioritet më i lartë.

Lufta kundër krimit të organizuar

Gjatë periudhës së raportimit, Kosova ka përmbushur prioritetet afatshkurtra të studimit të fizibilitetit. Udhëheqësit e sajë politik dhe autoritetet gjyqësore dhe për zbatimin e ligjit kanë mirëmbajtur angazhimin për të dorëzuar rezultatet në luftën kundër krimit të organizuar. Ata kanë vazhduar të punojnë në partneritet me EULEX-in në çështjet praktike operacionale në baza ditore. Kosova ka miratuar strategjitë e reja dhe planet e veprimit kundër krimit të organizuar, narkotikëve dhe terrorizmit. Kosova gjithashtu ka një strategji dhe plan të veprimit kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Kuvendi i Kosovës gjithashtu ka miratuar një ligj për konfiskimin e pronave dhe ka rishikuar ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Marrëveshja mbi objektivat për sundimin e përbashkët të ligjit është nënshkruar në muajin nëntor nga Kosova, PSBE-ja dhe EULEX-i.

Siç është përcaktuar në studimin e fizibilitetit, për të përmbushur obligimet e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e kornizës politike dhe legislative. Ajo duhet të ofroj prova konkrete të rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar, sidomos në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore, drogave (dhe prekurësorëve të tyre) dhe trafikimin e armëve. Besueshmëria e statistikave duhet të përmirësohet

Për një analizë të detajuar të zhvillimeve në luftën kundër krimit të organizuar, *shih 4.3 – Drejtësia, Liria dhe Siguria.*

2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Kushtetuta e Kosovës rendit **instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut** të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë dhe përbëjnë një pjesë integrale të kornizës ligjore të Kosovës. Pasi që Kosova nuk është pjesë e asnjë instrumenti ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, as anëtare e Këshillit të Evropës, raportimet e sajë mbesin ad hoc.

Sa i përket **promovimit dhe zbatimit të drejtave të njeriut**, komisioni përkatës i Kuvendit ka mbajtur përgjegjëse në masë të madhe qeverinë. Kjo lidhet në veçanti me zbatimin e pakënaqshëm të rekomandimeve të lëshuara nga Avokati i Popullit, Sfida kyçe për Kosovën është të përmirësoj zbatimin e kornizës ekzistuese ligjore dhe zbatimin e vendimeve për

përmirësimin e shkeljeve të drejtave të njeriut. Skema komplekse dhe mbulimi i pjesshëm institucional për raportimin mbi këto të drejta, si dhe promovimi dhe mbrojtja e tyre duhet të thjeshtëzohet dhe të jetë efikase, si në nivelin qendrorë ashtu edhe në atë lokal.

Kosova ka vazhduar të adresoj **parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit** në burgje, duke përfshirë edhe luftën kundër mos ndëshkimit. Shërbimet korrektuese kanë pranuar dy ankesa për *torturë dhe keqtrajtim* në vitin 2012. Pas hetimit, të dy rastet janë hedhur poshtë. Në vitin 2013, nuk është marr asnjë ankesë. Komiteti drejtues i përbërë nga Avokati i Popullit, Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, është duke monitoruar situatën në këtë drejtim në qendrat e ndalimit. Anëtarët e komitetit drejtues duhet të avancojnë më shumë përvojën dhe burimet e tyre për të kryer inspektime të balancuara dhe të sakta.

Sistemi i burgjeve, në veçanti Qendra Korrektuese e Dubravës, vazhdon të përballlet me sfida të konsiderueshme. Trajtimi mjekësor është i pamjaftueshëm. Sfida të rëndësishme lidhen me korrupsionin, nepotizmin, kontrabandën dhe diskriminimin në sistemin e burgjeve. Disa të burgosur gëzojnë “privilegje të zgjeruara” dhe e keqpërdorin sistemin. Kjo rrit rrezikun që ata do të mund të kryejnë aktivitete kriminale nga burgu, duke përfshirë frikësimin e dëshmitarëve. Kosova duhet të zhvilloj kategorizimin adekuat të burgosurve. Mekanizmat e brendshme të ankesave duhet të bëhen më efikas dhe efektiv.

Mbi **lirin e shprehjes**, kuvendi ka modifikuar dy Nene të Kodit Penal mbi përgjegjësinë penale të mediave dhe mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, ashtu siç është përcaktuar në studimin e fizibilitetit. Autoritetet e Kosovës (Presidenti, Zyra e Kryeministrit dhe Ministrija për Integritet Evropian) dënuan në mënyrë të menjëhershme dhe kërkuan një hetim për sulmet në zyrat e revistës Kosova 2.0, që kishte publikuar një botim special duke u fokusuar në temën e seksit, duke përfshirë orientimin seksual dhe çështjet e identitetit gjinor.

Një prokuror i EULEX-it dhe një prokuror nga zyra e prokurorisë themelore në Prishtinë kanë ngritur një aktakuzë kund tre qytetarëve të Kosovës për përfshirjen e tyre në sulmin kundër Kosova 2.0.

Legjislacioni që mbulon lirin e shprehjes është i fragmentuar (14 ligje në total) dhe jo-efektiv. Ligjet përcaktojnë një total prej dhjetë institucioneve që janë përgjegjëse për këtë fushë. Zbatimi i legjislacionit është i nevojshëm për të përcaktuar fushëveprimin dhe aktivitetet e sakta të këtyre institucioneve. Aktualisht, ka një mbulim të pjesshëm. Kosova nuk e ka një ligj gjithëpërfshirës për media, duke lënë kështu të parregulluara fushat kyçe sa i përket funksionimit të mediave. Kjo përfshinë çështje të tilla si autonomia e gazetarëve dhe redaktorëve, mbrojtja e standardeve profesionale në gazetari, të drejtën për kundërshtim të përgjegjshëm për gazetarët dhe të drejtën e përgjigjes dhe korigjimit nga qytetarët.

Kërcënimet kundër gazetarëve dhe redaktorëve kanë vazhduar të raportohen dhe gazetarët vazhdojnë të përballen me presionin ekonomik dhe me kërcënime. Asociacioni i Gazetarëve Profesionalist në Kosovë (AGPK) ishte aktivë në dënimin e sulmeve kundër mediave dhe gazetarëve gjatë gjithë vitit 2012. Megjithatë, pas emërimit të bordit të ri në muajin prill, disa nga anëtarët e bordit u larguan, duke përmendur lidhjet e ngushta në mes të Kryetares me bizneset dhe me përfaqësuesit politik. Standardet profesionale në gazetarinë e transmetimit dhe në atë të shtypit duhet të përmirësohen, me fokus të veçantë në mediat online.

Pavarësia e Komisionit të Pavarur të Mediave është vështirësuar nga mungesa e burimeve dhe ndërhyrjet politike në emërimin e komisionit dhe bordit të tij të apelit. Një anëtar i komisionit dhe dy anëtar të bordit të apeleve janë emëruar pavarësisht nga fakti që kanë qenë të papranueshëm. Mbetet të emërohet edhe një anëtar i komisionit. Shumë nga puna e komisioni është paralizuar nga vendimet e paligjshme të këshillit të saj për të shkarkuar KE-në (Kreun Ekzekutiv). Por ky vendim është hedhur poshtë nga gjykata

Qëndrueshmëria financiare afatgjate e transmetuesi publik të Kosovës (RTK) mbetet ende e pasigurt. Modeli i fundit i financimit është i bazuar vetëm në gjendjen e buxhetit, që

minimizon pavarësinë redaktuese të RTK-së. Bordi i RTK-së duhet të ketë njëmbëdhjetë anëtarë – personalitete publike të cilat kanë treguar paanësi politike. Tre anëtar ende nuk janë emëruar, si pasojë e politizimit të emërimit të tyre nga ana e Kuvendit. (*shih 4.2.6 – Shoqëria informative dhe mediat*).

Liria e tubimit dhe organizimit vazhdon të ushtrohet në Kosovë. Gjatë periudhës së raportimit, ka pasur disa protesta dhe tubime publike kundër vendimeve të qeverisë dhe kuvendit. Lëvizjet publike dhe opozitare janë të lira të shprehin pakënaqësitë me politikën qeveritare.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit vazhdon të ushtrohet në Kosovë. Shkolla Ortodokse funksionon mirë në hapësirat e sajë historike në Prizren. Kosova ka qenë e gatshme të përkrah rindërtimin e vendeve të Kishës Ortodokse Serbe. Kontaktet në mes të udhëheqësve fetar të Kishës Katolike Shqiptare të Kosovës, Udhëheqësve Islamik dhe Udhëheqësve të Kishës Ortodokse Serbe kanë qenë më të rregullta dhe marrëdhëniet janë duke u përmirësuar. Një katedrale katolike është duke u ndërtuar në qendër të Prishtinës. Policia e Kosovës ka marrë përsipër përgjegjësitë nga KFOR-i për mbrojtjen e vendeve historike dhe fetare. Deri më tani, vetëm manastiri i Deçanit mbetet nën mbrojtjen e KFOR-it. Mbrojtja e Patriarkanës së Pejës ka kaluar nga KFOR-i tek policia e Kosovës në muajin Gusht.

Një numër i vendeve të trashëgimisë fetare kanë qenë objekt i vjedhjeve të vogla dhe vandalizmit, duke përfshirë kishat ortodokse serbe dhe varrezat ortodokse dhe myslimane. Në shkurt, dëmtimi i varrezave Ortodokse Serbe ka zbuluar ndjeshmërinë e vendeve me vlerë për komunitetin serb në Kosovë gjatë tensionimit politik. Mekanizmi për raportimin dhe përcjelljen e aktiviteteve të tilla duhet të përmirësohet.

Sa i përket të **drejtave të grave dhe barazisë gjinore**, qeveria ka miratuar legjislacionin zbatues për ligjin mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje. Instituti gjyqësor ka ofruar trajnime në këto çështje për gjyqtarët, prokurorët, avokatët e viktimave dhe punëtorët social. Agjencia për Barazi Gjinore ka përgatitur një plan të veprimit për zbatimin e rezolutës përkatëse të OKB-së. Synimi është të fuqizohet pozita e gruas në proceset vendimmarrëse dhe në strukturat e sigurisë, si dhe të ofrohet kompensim për të mbijetuarit e dhunës seksuale të lidhura me konfliktin me anë të përmirësimit të qasjes në drejtësi, rehabilitim dhe integrim. Legjislacioni që njeh të mbijetuarit e dhunës seksuale të konfliktit si viktimë civile të luftës ende nuk është miratuar nga Kuvendi. Financimi qeveritar i strehimoreve për viktimat e dhunës familjare dhe të trafikimit nuk është i qëndrueshëm. Ligji mbi barazinë gjinore duhet të amendamentohet. Përfaqësimi i grave në sektorin publik si dhe atë privatë mbetet i ulët, sidomos në pozitat e larta. Prezantimi i pushimit të paguar të lehonisë deri në nëntë muaj ka pasur një ndikim negativ në punësimin e grave në disa raste, veçanërisht në sektorin privat. (*Shih 4.1.8 - Punësimi dhe politikën sociale, politikën e shëndetit publik*)

Sa i përket të **drejtave të fëmijëve**, qeveria ka miratuar një strategji të re rinore dhe një plan të veprimit 2013-2017 të Kosovës. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka krijuar 34 këshilla të veprimit lokal rinor duke përfshirë disa të themeluar në vitet 2009-2010. Raportimi mbi zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit mbi të drejtat e fëmijëve 2009-2010 është përmirësuar. Departamentet e të miturve tani janë themeluar në të gjitha gjykatat dhe zyrat e prokurorisë. Ministria e Drejtësisë gjithashtu ka trajnuar 15 ndërmjetësues mbi kundërvajtësit e mitur dhe për mbrojtjen e viktimave. Një rishikim i legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve duhet të bëhet në mënyrë që të identifikohen mangësitë. Sa i përket mbrojtjes së fëmijëve, sistemi mbetet i fragmentuar, si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelet lokale. Përqendrimi duhet të jetë në përmirësimin e zbatimit të legjislacionit dhe në uljen e varësisë nga përkrahja e donatorëve ndërkombëtar.

Sa i përket personave **shoqërisht të rrezikuar dhe personave me aftësi të kufizuara**, Kosova ka përmirësuar kornizën e saj legjislative. Në gusht, qeveria miratoi strategjinë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2013-2023) dhe një plan të veprimit (2013-2015). Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka miratuar disa udhëzime administrative për

të përmirësuar qasjen në arsim për personat me aftësi të kufizuara. Ligji i sapo miratuar për personat e verbër ka hyr në fuqi në muajin janar. Që nga muaji shkurt, Kuvendi ka transmetuar seancat me interpretim në gjuhën e shenjave për të shurdhëritë. Ndërtesat publike në Kosovë mbeten kryesisht të pa-qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Qasja në hapësirat publike për personat me aftësi të kufizuara është jo adekuate. Këshilli Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar i Kosovës duhet të përmirësoj funksionimin e tij me mbështetjen e Zyrës për Qeverisje të Mirë. Autoritetet e Kosovës gjithashtu duhet të përmirësojnë angazhimin e tyre me organizatat e personave me aftësi të kufizuara kur të përgatisin dokumentet e politikave dhe legjislacionit. Ata gjithashtu duhet të përmirësojnë zbatimin e zotimeve të bëra sa i përket mos-diskriminimit dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara.

Ligji **Kundër Diskriminimit** është nën rishikim së bashku me vendosjen e përgjithshme institucionale. Zbatimi i politikave jo-diskriminuese është i dobët.

Në muajin maj, Zyra për Qeverisje të Mirë ka mbajtur një tryezë të rumbullakët mbi çështjet e **lesbikëve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjinjorëve dhe interseksualëve (LGBTI)**. Ky komunitet përballet me sfida të mëdha në Kosovë. Ai vazhdon të përballet me diskriminim, kërcënime dhe dhunë. Një lëvizje fetare, që shpreh urrejtje kundër komunitetit LGBTI përmes mediave konvencionale dhe mediave sociale, u regjistrua si parti politike.

Në fushën e të **drejtave të punës dhe atyre sindikale**, ligji i amandamentuar mbi grevat ka hyrë në fuqi. Këshilli Socio-Ekonomik dhe grupet e punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë kanë diskutuar kushtet e punësimit. Inspektorati i punës ka kryer mbi 7 000 inspektime në sektorët publikë dhe privatë. Ka lëshuar mbi 1800 paralajmërime me shkrim dhe mbi 150 masa ndëshkuese. Sindikatave i'u mungon kapaciteti për të marr pjesë në mënyrë efektive në vendimmarrje, hartimin e legjislacionit dhe dialogun politik me qeverinë. (*Shih 4.1.8 - Punësimi dhe politikat sociale, politika e shëndetit publik.*)

Sa i përket të **drejtave pronësore**, Kuvendi ka miratuar ligjin mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e tokës së paluajtshe të komunës si dhe ligjeve për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe për planifikimin hapësinor. Nga një total prej mbi 42 500 kërkesa të regjistruara nga Agjencia Kosovare e Pronës, mbi 39 000 janë shqyrtuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës. Zyrat e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë në Serbi veprojnë si zyra ndërlidhëse për Agjencinë Kosovare të Pronave. Numri i vendimeve të Komisionit për kërkesa pronësore të Kosovës dhe i rasteve të refuzuara nga Sekretariati Ekzekutiv qëndron në rreth 38480 prej të cilave 35500 i janë ofruar paditësve dhe rreth 2000 të paditurve. Numri i zbatimit të vendimeve të Komisionit gjatë periudhës raportuese është rreth 20400.

Mangësitë serioze mbeten në njoftimin e personave të zhvendosur sa i përket shpronësimit të pronës së tyre të patundshme. Zbatimi i urdhrave për dëbim dhe administrimi i pronës përgjatë tërë Kosovës mbetet një sfidë. Numri i lartë i dëbimeve është rreth 820 prej të cilave rreth 350 në veri të Kosovës. Financimi i Agjencisë së Pronës mbetet i pasigurt dhe i paqëndrueshëm. Shumë kërkesa të pazgjdhura për kompensimin e pronës janë para gjykatave. Gjykatat e instancës së dytë shpesh i dërgojnë rastet prapë në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Kontestet pronësore ndër etnike zgjaten padrejtësisht. Nuk ka asnjë skemë për kompensimin e banesave në pronësi publike. Mbetet shqetësim mungesa e strategjisë për të rregulluar vendbanimet jo-formale. Zyra e Koordinatorit për të Drejtat Pronësore në Zyrën e Kryeministrit nuk ka as personel e as financim.

Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës është gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, megjithëse disa ligje të rëndësishme kërkojnë përmirësime. Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e tyre. Strukturat që merren me mbrojtjen, promovimin, zbatimin dhe raportimin e të drejtave duhet të jenë të efektshme si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Ndërhyrjet politike dhe ekonomike në media, kërcënimet ndaj gazetarëve dhe

qëndrueshmëria afat-gjate e financimit të transmetuesve publik mbetet çështje që duhet të adresohen urgjentisht. Mekanizmat si dhe Vetëdijësimi i përgjithshëm dhe dëshira për të adresuar çështjet kundër diskriminimit duhet të fuqizohen edhe më tutje. Incidentet e dhunshme kundër komunitetit LGBTI duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht. Gjithashtu ka nevojë për më shumë përqendrim në hetimin e veprave kundër objekteve fetare. Zbatimi dhe mbrojtja e të drejtave pronësore është një sfidë kryesore dhe një prej prioriteteve të studimit të fizibilitetit. Në veçanti, sistemi gjyqësor i Kosovës duhet të përmirësoj përpjekjet e tij për të zgjidhur rastet më shpejtë. Autoritetet e Kosovës duhet të bëjnë më shumë për të pasur qasje tek personat e zhvendosur sa i përket shpronësimit të patundshmërive të tyre.

Të drejtat dhe mbrojtja e pakicave, të drejtat kulturore

Pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur në shtator të vitit 2012, korniza ligjore e Kosovës vazhdon të garantoj përfaqësimin e **minoriteteve**. Ajo e mbështet të drejtën e personave që i përkasin minoriteteve, dhe mbron interesat jetësor dhe të drejtat kulturore, duke i përfshirë edhe ato të Kishës Ortodokse Serbe. Komunitatet me shumicë serbe në jug të Kosovës gradualisht i kanë forcuar kapacitetet e tyre. Ato gjithashtu marrin pjesë në organe të tilla si Asociacioni i Komuniteteve të Kosovës. Zyra për çështje të komunitetit ka rritur ndihmën e saj për familjet e rrezikuara sociale dhe për projektet infrastrukturore.

Është emëruar një Komisioner i ri Gjuhësor në muajin dhjetor. Zyra ka rekrutuar stafin e ri, ka krijuar ueb-faqen e sajë, ka zhvilluar një formë të ankesës online dhe ka kryer aktivitetet e shpërndarjes. Masat e politikës gjuhësore të propozuara nga Komisionari tek Zyra e Kryeministrit mbetet të miratohen. Reagimi i ngadaltë i autoriteteve të zbatimit të ligjit, në veçanti i sistemit gjyqësorë, në rastet që përfshijnë persona që i takojnë minoriteteve e ngrit mosbesimin e tyre vis-a-vi me institucionet e Kosovës. Kosova duhet të përmirësoj prezantimin proporcional të minoriteteve në polici dhe në gjyqësi.

Pas miratimit të ligjit mbi transmetuesit publik, është licencuar një kanal televiziv në gjuhën serbe (RTK2). Ai i ka filluar transmetimet e kufizuara në Qershor dhe që nga gushti ka qenë plotësisht funksional. Momentalisht, kanali është në dispozicion vetëm përmes operatorëve kabllorë. Qasja në arsim për komunitetet e minoritare mbetet e kufizuar. Pengesat gjuhësore dhe mungesa e materialeve shkollore relevante janë pengesa të mëdha për integrimin e fëmijëve të kthyer dhe të riatdhesuar në sistemin arsimor. Nuk ka pasur përparime në udhëzimet në gjuhën serbe në kuadër të plan programit të Kosovës. Gjuha serbe ende nuk është në dispozicion si një gjuhë e dytë zyrtare jashtë zonave të banuara kryesisht nga Serbët. Studentët nga komuniteti Serb dhe shumica e studentëve Romë dhe Goran janë regjistruar në shkollat të administruara nga Serbia.

Një rishikimi afatmesëm i planit të veprimit të strategjisë për integrimin e komuniteteve **Romë, Ashkali dhe Egjiptian (RAE)** (2009-2015) u përfundua në muajin korrik. Janë identifikuar tre veprime për përmirësim. Alokimi i duhur i buxhetit, bashkëpunimi më i mirë midis autoriteteve qendrore dhe komunale, si dhe bashkëpunim më i mirë mes qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile. Ministrja për Integrim Evropian mori zyrtarisht postin e kryesueses të komitetit drejtues ndërministror. Zyra për Qeverisje të Mirë mbetet përgjegjës për këto çështje në nivel të punës. Kampi Osterode u mbyll zyrtarisht në muajin dhjetor.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit mbetet i dobët dhe i paqëndrueshëm. Komunitetet jo-shumicë vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha. Fëmijët që vuajnë nga kontaminimi me plumb kërkojnë kujdes të mëtejshëm. Mbyllja e kampit Leposaviq ende duhet të përfundojë. Arsimiti, shërbimi social dhe regjistrimi civil i komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian duhet të përmirësohen edhe më tej. Komunitatet janë zotuar për financimin e gjashtë qendrave mësimore parashkollore për fëmijët e këtyre komuniteteve. Angazhimet e tjera për përmirësimin e arsimit (p.sh. mbështetja e ndërmjetësuesve për të ndihmuar këta fëmijë të integrohen në jetën

e shkollës), mbeten për t'u zbatuar. Gjuha rome është duke u ofruar në disa pilot klasa në Prizren. Megjithatë, mësuesi në fjalë është duke punuar *pro bono* si dhe nuk ka libra të lëshuara nga qeveria.

Sa i përket **refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit**, shumica e Këshillave Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Këshillave Lokal për Siguri Publike janë krijuar për të adresuar shqetësimet e sigurisë të të gjitha komuniteteve. Funksionimi i këtyre këshillave duhet të përmirësohet.

Numri i të kthyerve vullnetarisht ka rënë nga 1140 në vitin 2011- në 970 në vitin 2012. Në vitin 2012, një total prej 220 familjeve kanë marrë ndihmë për strehim nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve. Ministria ka krijuar një grup punues për të hartuar një strategji të re për Komunitete dhe Kthim pasi që strategjia aktuale skadon në vitin 2013.

Qëndrueshmëria e procesit të kthimit vazhdon të dëmtohet nga kërcënimet reale dhe të perceptuara të sigurisë (në komunitetin me shumicë shqiptar si dhe në atë me shumicë serbe). Gjendja është përkeqësuar më shumë nga incidentet e vazhdueshme që prekin të kthyerit dhe pronat e tyre, si dhe vendet fetare dhe trashëgimin kulturore. Qasja e kufizuar në pronë, procedurat e bllokuara apo të vonuara për kthim të pronës, qasja e kufizuar në shërbimet publike, dhe mungesa e mundësive ekonomike gjithashtu vazhdon të jetë pengesa kryesore për kthim dhe ri-integrim të qëndrueshëm. Pengesat për kthimin dhe integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian janë një shqetësim i veçantë.

Sa i përket të **drejtave kulturore**, Këshilli zbatues dhe monitorues, i themeluar në muajin shkurt, vazhdon të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Kishës Ortodokse Serbe. Këshilli është takuar në baza mujore dhe ka adresuar shqetësimet e Kishës. Sfida kryesore për këshillin është të siguroj që vendimet e tij të shndërrohen në rezultate konkrete në terren. Me iniciativën e Zyrës së Kryeministrit, policia e Kosovës ka themeluar një njësi speciale për të mbrojtur objektet fetare Serbe dhe vendet e trashëgimisë kulturore në Kosovë. Ajo mbulon katër rajone dhe punëson 203 policë të Kosovës. Pjesa e policëve serbë në njësinë e veçantë ka nevojë që të rritet.

Ka përparuar zbatimi i Ligjit për qendrën historike të Prizrenit. Në anën tjetër, nuk ka pasur progres në zbatimin e Ligjit për Hoçën e Madhe. Është i nevojshëm udhëzimi i vazhdueshëm nga niveli qendror për të siguruar se ligjet janë zbatuar plotësisht. Bashkëpunimi në mesë të ministrive përkatëse dhe në mes të nivelit qendror dhe ati lokalë është duke u përmirësuar ngadalë. Ai duhet të intensivikohet dhe të menaxhohet në një mënyrë më të strukturuar për të siguruar një proces të qëndrueshëm. Në përgjithësi, zbatimi i kornizës legjislative që rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mbetet i dobët. Autoritetet e Kosovës duhet të adresojnë shkeljet e shpeshta të legjislacionit që ndikojnë negativisht në vendet e trashëgimisë kulturore. Ata gjithashtu duhet të demonstrojnë një angazhim më të fuqishëm për planifikimin hapësinorë të trashëgimisë kulturore. Interesat e biznesit shpesh mbizotërojnë mbi interesat e trashëgimisë kulturore.

Në përgjithësi, Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e prioriteteve të studimit të fizibilitetit. Legjislacioni zbatues mbi mbrojtjen e minoriteteve dhe drejtave kulturore mbetet një sfidë e rëndësishme. Koordinimi ndërinstucional në mes të institucioneve vetëqeverisëse qendrore dhe lokale ka nevojë të përmirësohet. Incidentet e sigurisë dhe krimeve që shënjestrojnë personat që i përkasin pakicave dhe pronën e tyre duhet të hetohen dhe të ndiqen penalisht plotësisht dhe në mënyrë të menjëhershme. Planifikimi Hapësinor duhet të marrë parasysh kërkesat e vendeve historike dhe të trashëgimisë kulturore. Veprime të fuqishme duhet të merren për të ndaluar ndërtimet ilegale dhe për të korrigjuar ndërtimet ilegale të cilat tashmë kanë ndodhur.

Burimet dhe përpjekjet duhet të jenë më të fokusuara për të shënuar progres në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për komunitetet Roma, Ashkali dhe Egjiptian. Kosova duhet

ta mbyll kampin e Leopsaviçit. Fokusi duhet të jetë mbi arsimin, shërbimet sociale dhe regjistrimin civil të këtyre komuniteteve. Kosova aktualisht mbështetet kryesisht në ndihmën nga komuniteti ndërkombëtar në këtë fushë.

2.3 Çështjet regjionale dhe obligimet ndërkombëtare

Sa i përket marrëdhënieve me Serbinë, *shih seksionin 1.4. - Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.*

Kosova ka vazhduar bashkëpunimin me komunitetin ndërkombëtar, duke përfshirë **Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ)**, në hetimin dhe ndjekjen penale të **krimeve të luftës**. Ish kryeministri Ramush Haradinaj është liruar nga Tribunali në muajin nëntor.

Njësia për hetimin e krimeve të luftës e policisë së EULEX-it dhe njësia e Kosovës për hetimin e krimeve të luftës kanë kryer një hetim të përbashkët në fshatrat Babin Most dhe Vushtrri. Hetimet rezultuan me arrestimin e dy të dyshuarve në rastin e Babin Most-it dhe me një kërkim në vendbanimet e tyre. Njësia speciale e policisë së Kosovës dhe njësia e mjekësisë ligjore e policisë së Kosovës ka ofruar mbështetje operative. Kosova vazhdon të përballlet me sfida në hetimin e krimeve të luftës me institucionet e veta gjyqësore dhe atyre për zbatimin e ligjit. EULEX-i, duke përfshirë Task Forcën Speciale Hetimore, ka vazhduar ushtrimin e mandatit të tij ekzekutiv në këtë fushë.

Në muajin mars u krijua grupi punues ndër-ministror që merret me të kaluarën dhe me procesin e pajtimit. Kjo është bërë për t'ju adresuar shkeljeve të kaluara të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të ligjit ndërkombëtar humanitar në Kosovë. Krijimi i grupit punues është një hapë pozitiv, por ndikimi i tij praktik ende nuk është materializuar.

Fati i pazgjidhur i **personave të zhdukur** nga konflikti i vitit 1990 është ende një çështje e shqetësimit humanitar në Ballkanin Perëndimor. Që nga korriku i viti 2013, një total prej 11 859 personave ende mungojnë si rezultat i konflikteve në regjion, sipas shifrave të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK). Nga këto, 7886 rastet ndërlidhen me konfliktin në Bosnje dhe Hercegovinë, 2 246 me konfliktin në Kroaci dhe 1727 me konfliktin në Kosovë. Mungesa e informatave mbi varrezat e reja për shkak të mungesës së vullnetit politik, dhe vështirësitë në identifikimin e mbetjeve njerëzore tashmë të zhvarrosura vazhdon të jetë pengesa kryesore në zgjidhjen e rasteve të mbetura të personave të zhdukur.

Grupi punues për personat e zhdukur i kryesuar nga KNKK-ja ka mbetur korniza brenda të cilës autoritetet e Kosovës i kanë ndjekur zotimet e tyre. Komisioni parlamentar për personat e zhdukur ka marrë përgjegjësitë e tij në lehtësimin e vlerësimit dhe zhvarrosjes së varrezave të reja potenciale si dhe për koordinimin e veprimeve të palëve të tjera të interesit. Megjithatë, i mungon mbështetja e lartë politike. Ai duhet të jetë pro-aktiv dhe të rrisë kapacitetet për të kanalizuar dhe rrisë kërkimin për informata të reja mbi fatin dhe vendndodhjen e personave të zhdukur. Ritmi i zgjidhjes së rasteve të personave të zhdukur i ulët, me vetëm 44 raste të zgjidhura në një periudhë prej 12 muajsh.

Rishikimi nga ana ekspertit të EULEX-it/ Departamenti i Mjekësisë Ligjore të mbetjeve të personave të paidentifikuar të ruajtura në morgun e Prishtinës ka përfunduar. Rezultatet janë bërë publike në një raport në vitin 2012. Janë identifikuar 45 persona. Raporti gjithashtu konkludoi se jo të gjitha mbetjet janë si rezultat i konfliktit. Politik-bërësit duhet të vendosin për hapat e ardhshëm. Departamenti i Mjekësisë Ligjore nuk i ka kapacitetet për të plotësuar standardet e kërkuara për rimarrjen, analizimin dhe identifikimin e qëndrueshëm dhe adekuat të mbetjeve të njerëzve. Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Kryeministrit duhet të bëjnë më shumë që të investojnë në rekrutimin dhe zhvillimin e ekspertëve të nevojshëm për një praktikë të qëndrueshme të mjekësisë ligjore. Nevojiten përpjekje të veçanta për të rritur besimin e komuniteteve jo-shqiptarë mbi punën e departamentit.

Duhet të përshpejtohet zbatimi i ligjit për personat e zhdukur (i miratuar në vitin 2011). Burimet e nevojshme për të krijuar një regjistër qendror ende nuk janë alokuar. Miratimi i legjislativës dhe regjistrit qendrorë është ende në pritje. Është i nevojshëm Koordinimi dhe bashkëpunimi i rritur dhe i përmirësuar në mes të komisioneve qeveritare dhe Departamentit të mjekësisë ligjore.

Mungesa e një marrëveshje formale në mes të Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë mbetet një pengesë për të sqaruar dyshimet lidhur me mbetjet e personave të paidentifikuara në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

Në përgjithësi, ka përfunduar rishikimi i mbetjeve të paidentifikuara të personave të ruajtura në morgun e Prishtinës. Ka mungesë të vullnetit politikë, ekspertizës dhe burimeve për të adresuar këtë çështje të personave të zhdukur. Kosova është në fazën e hershme të hetimit të krimeve të luftës pa ndihmën ndërkombëtare.

Bashkëpunimi regional dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore janë një element thelbësor i procesit të integritimit Evropian të Kosovës. Më 28 shkurt 2013, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) ka vendosur të amendamentojë statutin për të lejuar Kosovën të bëhet pjesëmarrëse me të drejta të vetat. Formula për pjesëmarrjen e Kosovës në KRB është një bazë e mirë për Kosovën që të rrisë dhe të zgjerojë pjesëmarrjen e sajë në forumet e tjera rajonale.

Kosova merr pjesë në forumin e Observatorit të Transportit të Evropës jug-lindore (SEETO), në traktatin e komunitetit të energjisë, Qendra Juglindore Evropiane për Mësime të Ndërmarrësi (QJLEMN), grupi punues i përhershëm për zhvillim rajonal rural në Evropën Juglindore (EJL), Rrjeti Rajonal Mjedisor për Aderim, Rrjeti i Shoqatave të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (EJL).

Sa i përket **marrëdhënieve bilaterale me vendet e tjera në zhvillim**, Kosova ka vazhduar të ketë marrëdhënie shumë të mira me Shqipërinë me të cilën ka nënshkruar marrëveshje mbi shkëmbimin dhe mbrojtjen e informatave të klasifikuara, ndihmën gjyqësore në rastet penale, për ekstradimin, transferimin e personave të dënuar dhe bashkëpunimin mbi tatimin dhe luftimin e evazionit tatimorë.

Bosnja dhe Hercegovina nuk e ka njohur Kosovën. Vizat për qëndrimin afatshkurtër për qytetarët e Kosovës lëshohen vetëm me ftesë nga misionet e huaja diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në Bosnje dhe Hercegovinë, apo për arsye humanitare.

Korniza e gjerë kontraktuale për bashkëpunim me *ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë* ka vazhduar të zhvillohet me nënshkrimin e marrëveshjeve mbi njohjen reciproke të pensioneve, mbi avancimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit kulturor, dhe mbi hapjen e një pikë kalimi të ri kufitar. Patrullat e përbashkëta të monitorimit përgjatë kufirit duhet të adresojnë sfidat e trafikimit ilegal të mallrave dhe për migrimin ilegal. Një mosmarrëveshje tregtare u zhvilluar në shtator të vitit 2013. Është çështje shqetësuese, mënyra në të cilën situata në kufi u përshkallëzua për disa ditë, para se të zgjidhet në mënyrë bilaterale, jashtë procedurave të CEFTA-së.

Në lidhje me *Malin e Zi*, negociatat janë në rrugë e sipër për të përmbyllur marrëveshjet mbi ekstradimin, zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore në çështjet penale, dhe asistencën ligjore në çështje penale. Një komision i përbashkët nën menaxhimin e demarkacionit të kufirit ka filluar punën.

Kosova ka mbajtur lidhje shumë të mira me Turqinë, me të cilën ka finalizuar negociatat mbi një marrëveshje për tregtinë e lirë.

Në përgjithësi, marrëveshjet e arritura në kontekst të dialogut në mes të Beogradit dhe Prishtinës ka rritur bashkëpunimin regional. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi mbetet të përfundohet.

3. KRITERET EKONOMIKE

Në ekzaminimin e zhvillimeve ekonomike në Kosovë, qasja e komisionit udhëzohej nga përfundimet e Këshillit të Evropës në Kopenhagë në qershor të vitit 1993, që ka deklaruar se anëtarësimi i bashkimit evropian kërkon ekzistimin e një ekonomie funksionuese të tregut dhe aftësinë për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian.

3.1 Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut

Bazat e politikës ekonomike

Kosova ka zhvilluar më tej marrëdhëniet e saj me institucionet ndërkombëtare financiare. Ka vazhduar të zbatohet me sukses Marrëveshjen "Stand By" 20 muajsh me 105 milion € të negociuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) në prill të vitit 2012. Në dhjetor të vitit 2012, Kosova është bërë anëtare e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Në qershor të vitit 2013, Kosova ka nënshkruar një Marrëveshje Kornizë me Bankën Evropiane për Investim (BEI), që i lejon BEI-së të financojë projekte në Kosovë. Mekanizmi i Mbikëqyrjes Fiskale ka vazhduar me mbajtjen e takimeve dy herë në vit me Komisionin Evropian. Kosova gjithashtu ka nisur përgatitjet për një Program Ekonomik dhe Fiskal, që është procedura standarde e mbikëqyrjes ekonomike për kandidatët potencial. Në fillim të majit, qeveria e Kosovës ka miratuar kornizën e saj afatmesme të shpenzimeve, që mbulon vitet nga 2014-2016. Në përgjithësi, vendosmëria për të ndjekur politikat ekonomike të orientuara në treg është mbajtur dhe reformat në disa fusha janë përshpejtuar.

Stabiliteti makroekonomik

Ekonomia e Kosovës ka qenë më pak e mbrojtur nga efektet negative të krizës ekonomike në Evropë se në vitet e kaluara, duke treguar shenja të një ngadalësimi ekonomik. Situata e përgjithshme ekonomike mbetet sfiduese me një shkallë të lartë të papunësisë. Rritja e BPV-së është zvogëluar nga 4.4% në vitin 2011 në 2.5% në vitin 2012 dhe gjithashtu ka të ngjarë që të mbetet e ulët në gjashtë mujorin e parë të vitit 2013. Politika më e matur fiskale dhe zvogëlimi i shpejtë i rritjes së kredisë kanë ndaluar kërkesën e brendshme, në veçanti duke shuajtur aktivitetet e investimit. Remitancat, një shtytës i madh i konsumit privat, ka filluar të rimëkëmbet vetëm në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2012. Perspektiva e dobët ekonomike në një numër të vendeve me diasporë të konsiderueshme Kosovare rrit pasigurinë. Statistikat ekonomike, llogaritë kombëtare në veçanti, kanë mbetur jashtëzakonisht të vogla, duke penguar vlerësimin gjithëpërfshirës të situatës ekonomike. BPV për kokë banori⁶ ka arritur në 2721 Euro në vitin 2012, e barabartë me 11% të mesatares BE-27, pothuajse e pandryshuar në krahasim me nivelin e saj në vitin 2011. Në përgjithësi, rritja ekonomike e Kosovës është dobësuar dhe mbetet e brishtë.

Në vitin 2012, deficitin aktual i llogarisë (duke përfshirë transferet zyrtare) është zvogëluar në 7.7% të BPV-së, nga 13.8% të BPV-së në vitin 2011. Transferet e larta rrjedhëse dhe importimi më i ulët i mallrave dhe shërbimeve ka ndihmuar të zvogëlohen pabarazitë e jashtme. Nga ana tjetër, ecuria e eksportimit të mallrave është përkeqësuar (ka rënë për 1.0% të BPV-së), pasi që kërkesa e jashtme dhe çmimet për metalet dhe prodhimet e metalit, eksporti kryesor i Kosovës, ka rënë. Si rezultat, pabarazitë tregtare kanë mbetur të konsiderueshme, me një deficit tregtar prej 35.1% të BPV-së, duke reflektuar një bazë të pazhvilluar dhe të ngushtë të prodhimit vendor.

Suficiti në kapital dhe në llogarinë financiare (duke përfshirë ndryshimet në fondet rezervë) ka qëndruar në 13.2% të BPV-së në vitin 2012. Investimet e huaja neto të drejtpërdrejta kanë rënë në nivelin e tyre më të ulët që nga viti 2005 në 4.3% të BPV-së. Struktura e investimeve ka mbetur në përgjithësi e pandryshuar, me rreth gjysmën e investimeve të drejtpërdrejta të huaja (FDI) që shkojnë në sektorin e patundshmërive dhe ndërtimeve, 12% në shërbimet financiare, dhe vetëm 13% të kanalizuar në prodhim. Deficiti në portofolion e investimeve është zgjeruar në 3.8% të BPV-së, por flukset e fuqishme hyrëse të investimeve tjera,

kryesisht në valutë dhe në depozite, kanë rritur asetet rezervë, që janë rritur për 5.4% të BPV-së. Gabimet dhe lëshimet neto kanë mbetur shumë të lartë (4.9% të BPV-së), që është afër nivelit të tyre në vitet paraprake. Në përgjithësi, dis-balanci i jashtëm kanë rënë, edhe pse ende është shumë i lartë, veçanërisht në tregtinë e mallrave. Hyrjet neto nga investimet e huaja të drejtpërdrejta kanë rënë dukshëm dhe kanë vazhduar të kanalizohen kryesisht në sektorët jo-tregtar

Papunësia është shumë e lartë në 35.1%, sipas Anketës së Forcës së Punës (janar - qershor 2012), e cila për shkak të ndryshimeve metodologjike, nuk lejon krahasimin me vitet e kaluara. Regjistri i papunësisë është digjitalizuar dhe është lancuar në fillim të vitit 2012. Numri i njerëzve të regjistruar zyrtarisht si të papunësuar ka rënë për rreth 22%. Megjithatë, reduktimi i mprehtë kryesisht pasqyron ndryshimet në sistemin e regjistrimit, se sa në përmirësimin e situatës në tregun e punës. Shumica e të papunësuarve janë të pakualifikuar (60%) dhe numri i të papunësuarve me arsim universitar është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Struktura e tregut të punës sinjalizon një mos përputhje në mes të aftësive të nevojshme në tregun e punës dhe atyre të ofruara nga sistemi arsimor. Punësimi formal në sektorin privat ka pasur një rritje sipas të dhënave mbi numrin e kontribuuesve në fondin e kursimeve pensionale dhe në Trustin e Kursimeve. Statistikat në dispozicion nuk ofrojnë një pamje të qartë të tregut të punës, veçanërisht duke marrë parasysh punësimin e konsiderueshëm informal. Në përgjithësi, informacioni në lidhje me tregun e punës është i paktë dhe i pjesshëm. Papunësia mbetet shumë e lartë, me dobësi të konsiderueshme strukturore dhe me mangësi në aftësi në tregun e punës. Ka pak mundësi punësimi, sidomos për të rinjtë.

Norma mesatare vjetore e inflacionit ishte 2.5% në vitin 2012. Pasi është ngritur për disa muaj në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2012, inflacioni nga viti në vit ka rënë në 1.2% në muajin gusht të vitit 2013. Ky moderim ishte kryesisht i nxitur nga efekti bazik dhe nga çmimet më të ulëta të ushqimit dhe çmimeve të energjisë. Produktet energjetike kanë pasur ndikim delacionist për herë të parë në tre vitet e fundit. Inflacioni i shërbimeve gjithashtu është ulur dukshëm. Inflacioni bazë (jo-ushqimor, jo-energjetik) ka qenë i qëndrueshëm, afër 1%, duke gravituuar rreth mesatares të saj afatgjate. Në përgjithësi, inflacioni ka rënë dhe ka vazhduar të nxitet kryesisht nga çmimet e ushqimit dhe energjisë.

Kosova është duke përdorur Euron si valutë kryesore. Rrjedhimisht, Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka vetëm instrumente të kufizuara të politikës. Shtimi i furnizimit më para në përgjithësi ka rënë dukshëm dhe ka qëndruar në 4.6% vit pas viti deri në fund të korrikut të vitit 2013, krahasuar më 9% para një viti. Megjithatë, monetizimi i ekonomisë, i maturë nga shkalla e mesatares së përgjithshme të parasë ndaj BPV, është rritur nga 40.7% në vitin 2011 në 43% në vitin 2012. Korniza për ofrimin e asistencës për likuidim urgjent është funksionalizuar dhe autoritetet kanë financuar një fond rezervë të veçantë me 46 milion euro. Në përgjithësi, korniza valutore ka vazhduar të funksionoj relativisht mirë.

Deficiti i buxhetit të vitit 2012 doli i afërt me atë të synuar me 2.6% të BPV-së. Totali i të hyrave u rritë vetëm për 1.8% dhe ra në 26.9% të BPV-së nga 27.3% në vitin 2011. Përderisa aktiviteti ekonomik u zvogëlua, taksat kufitare dhe të hyrat jo-taksative ishin nën performancën e duhur, përderisa kursimet në shpenzimet për mallra dhe shërbime në nivel qendror dhe në shpenzime kapitale që nuk lidhen me autostradën kompensuan të hyrat e ulëta në nivelin qendror dhe atë komunal. Megjithatë, shpenzimet totale janë rritur për 5.3% për vit apo për 0.7 pikë të përqindjes, në 29.6% të BPV-së. Shpenzimet rrjedhëse kanë arritur në 18.1% të BPV-së, nga 17.4% në vitin 2011, të nxitura nga rritjet në të gjitha kategoritë e mëdha. Shpenzimet kapitale dhe kreditimi neto kanë rënë lehtë për 0.2 pikë përqindje, në 11.2% të BPV-së dhe më shumë se 40% e tyre janë shpenzuar në një projekt të vetëm, autostradën për në Shqipëri. Depozitat qeveritare të cilat janë në dispozicion në bankën qendrore janë rritur nga 160 milion € (3.4% të BPV-së) në vitin 2011 në 216 milion € (4.4% të BPV) në fund të vitit 2012. Në vitin 2012, autoritetet kanë filluar lëshimin e faturave të

brendshme të thesarit me 3-6 muaj maturitet, e zgjatur deri në një vit maturitet në prill të vitit 2013. Mbështetur nga likuidet i tepërt bankar dhe ekzekutimi rigoroz buxhetor, të ardhurat kanë rënë në mënyrë konstante dhe janë luhatur në mes 0.5% dhe 1.5% për faturat 3 dhe 6 mujore respektivisht, në tremujorin e tretë të vitit 2013. Borxhi total i qeverisë është rritur për 156 milion €, por ka mbetur i ulët në 8.3% të BPV-së deri në fund të vitit 2012, prej të cilave, gati se një e pesta ishte borxh i brendshëm. Transparenca e buxhetit u përmirësua edhe më tej, Ministria e Financave filloj botimin e informacioneve tremujore mbi nivelin dhe strukturën e borxhit të qeverisë në faqen e saj elektronike.

Në dhjetor të vitit 2012, Kuvendi ka miratuar buxhetin e vitit 2013, duka paraparë një deficit të konsoliduar prej 181 milion € (3.5% të BPV-së). Buxheti përmban masat fiskale rregulluese, kryesisht në ngritjen e të hyrave shtesë jo-taksative nga rezervat nëntokësore të linjtit dhe një shitje të licencave të telekomit. Për t'u mbrojtur kundër rreziqeve të paparashikuara fiskale, buxheti gjithashtu përfshinë një rezervë emergjente prej 20 milion € në zotime të pa-alokuara për shpenzime. Alokimi prej rreth 0.5 % të BPV-së është paraparë për nisjen e një projekti tjetër të madh, shumëvjeçar për transportin rrugorë, një autostradë që lidhë Prishtinën me Shkupin. Performanca e buxheti të vitit 2013 ishte në përgjithësi në rrugën e duhur deri në fund të korrikut. Deficiti i konsoliduar ishte rreth 6.6 milion €, që është dukshëm më i ulët se sa periudha korresponduese e vitit të kaluar. Rritja e të hyrave është nxitur nga efektet bazë dhe të hyrat nga tatimet vendore. Deri në fund të korrikut, rritja vit-pas-viti në shpenzimet totale ishte 1.3%. Megjithëse shpenzimet rrjedhëse, subvencionet dhe transferet janë rritur ndjeshëm (për 1.6% të BPV-së), shpenzimet e reduktuara kapitale që nuk janë të lidhura me autostradën mbajnë shpenzimet totale në një nivel modest.

Në prill, ofertuesi fitues për privatizimin e 75% të telekomit të PTK-së në pronësi shtetërore është përzgjedhur. Megjithatë, procesi i privatizimit ka përjetuar vonesa, me përfundim final që mbetet i pasigurt. Në anën tjetër, një numër i iniciativave me ndikim potencial të rëndësishëm mbi qëndrueshmërinë e buxhetit janë duke u përgatitur në shëndetësi, financimin komunal, dhe përfitimet për veteranët e luftës dhe të burgosurit politik. Në këtë aspekt, PTK-ja është një marrëveshje kyçe që pritet të sjell 277 milion € në buxhet.

Në muajin korrik, me ndryshimet në ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, parlamenti ka prezantuar një rregull detyruese fiskale që do të zbatohet nga viti 2014. Rregulla parasheh 2% të BPV-së si kulmi i deficitit të përgjithshëm qeveritar. *Në përgjithësi*, performanca e buxhetit ka mbetur kryesisht në rrugën e duhur, në një mjedis sfidues ekonomik dhe social, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të kufizuar ekspozimin e buxhetit ndaj një numri të iniciativave të reja shpenzuese.

Në vitin 2012, rritja dhe kërkesat e brendshme u zvogëluar, pasi disa prej faktorëve kryesor që më parë i përkrahnin ato, zgjerimin fiskal, remitanat e fuqishme dhe rritjen rrjedhëse të kreditimit janë kufizuar apo ngadalësuar. Në kornizën e një programi të mbështetur nga FMN-ja, hapa të rëndësishëm janë marrë për të frenuar qeverinë në shpenzime dhe për të përmirësuar stabilitetin financiar. Megjithatë, vazhdojnë pabarazitë e konsiderueshme të brendshme dhe të jashtme. Dobësitë strukturore dhe mungesat e aftësive në tregun e punës mbeten të konsiderueshme dhe ka pakë mundësi për punësim, sidomos për hyrësit e rinj në tregun e punës, duke përkeqësuar një situatë tashmë të vështirë sociale. *Në përgjithësi*, Kosova ka arritur mbajtje stabilitetin makroekonomik dhe fiskal, përkundër shenjave të dukshme të dobësimit të rritjes ekonomike. Politikat fiskale mbeten të kujdesshme dhe përzierja e politikës makroekonomike është përmirësuar. Përpjekjet e mëtejshme të rëndësishme janë të nevojshme për të përmirësuar karakteristikat strukturore të ekonomisë.

⁶ Në Kosovë nuk ekziston një masë për përdorimin PPS-së (Standardet e Fuqisë Blerëse)

Ndërveprimi i forcave të tregut

Nga 61 ndërmarrje në pronësi publike, 44 menaxhohen nga komunat. Mes atyre të menaxhuara nga niveli qendror, gjashtë ndërmarrje kanë pasur fitime operative në vitin 2012. Kjo përfshinë Korporatën Energjetike të Kosovës, Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës (PTK), e cila gjithashtu ka paguar 45 milion € në dividendë për buxhetin. Disa kompani në sektorin e transportit, ujit dhe mbeturinave kanë vazhduar të pësojnë humbje. Ato mbeten shpenzues të rëndësishëm të buxhetit, megjithëse në përmasa më të vogla se në vitet e kaluara. Privatizimi i Kompanisë Kosovare të Distribuimit dhe Furnizimit me Energji (KEDS) u përfundua me kujdes kur konsorciumi turk Calik-Limak morri përsipër kompaninë në maj të vitit 2013. Është vonuar privatizimi i 75 % të aksioneve të PTK-së në pronësi shtetërore, që fillimisht ishte paraparë të kryhet deri në korrik. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka vazhduar privatizimin e ndërmarrjeve të vogla. Të ardhurat totale nga fillimi i procesit të privatizimit kanë arritur në 574.4 milion € në kuadër të vitit 2012 vazhdon kontributin me 16.7 milion € Progres i kufizuar është bërë në likuidimin e kompanive nga portfoli i AKP-së. Në vitin 2012, janë mbyllur vetëm dy procedura të likuidimit dhe 179 firma mbeten në procesin e likuidimit. Të ardhurat nga shitja e asetëve të ndërmarrjeve në likuidim ka arritur në 62.700.000 € nga të cilat 11.300.000 € janë mbledhur në vitin 2012. Në përgjithësi, privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore ka përparuar, edhe pse në mënyrë të pabarabartë, ndërsa privatizimi dhe likuidimi i ndërmarrjeve nga portofolio i AKP-së ka mbetur prapa.

Hyrja dhe dalja nga tregu

Gjatë vitit 2012, 2261 biznese të reja janë regjistruar, që është një rritje prej mbi 20% në krahasim me vitin e kaluar. Nga ana tjetër, u mbyllën 334 biznese, ose 16.7% më shumë se në vitin 2011. Bizneset e konsiderojnë mungesën e qasjes në financa, ndërprerjet e energjisë, konkurrenca e pandershme (në mesin e ndërmarrjeve lokale) dhe korrupsionin si pengesat kryesore për të bërë biznes. *Në përgjithësi*, administrimi i dobët, furnizimi i pasigurt me energji elektrike dhe sundimi i mangët i ligjit kanë vazhduar të pengojnë zhvillimin e sektorit privat, edhe pse disa përparime janë bërë në lidhje me hyrjen në treg.

Sistemi Ligjor

Sistemi ligjor ka vazhduar të vuajë nga qasshmëria dhe efikasiteti i dobët, vonesat dhe grumbullimi i rasteve të vjetra të pazgjdhura. Zbatueshmëria e dobët e kontratave ka mbetur një nga shqetësimet kryesore të kompanive dhe investitorëve në Kosovë. Ajo është gjithashtu një nga faktorët që shpjegojnë normat relativisht të larta të interesit të aplikuar nga bankat komerciale për sektorin privat. Ajo ka kontribuar në rritjen e kredive të këqija. Ka pasur progres lidhur me infrastrukturën e të drejtave pronësore, edhe pse saktësia e të dhënave mund të përmirësohet edhe më tej. Përderisa procedurat e shpronësimit janë aplikuar në një mënyrë përgjithësisht të kënaqshme dhe pronarët e pronave janë kompensuar kryesisht, autoritetet nuk kanë kryer konsultimet dhe njoftimet e duhura të pronarëve të zhvendosur. Transaksionet dhe hipotekat e regjistruara kanë vazhduar të rriten, duke treguar një rritje të përdorimit të pronës si kolateral dhe pranimin nga ana e bankës të dhënave të regjistrimit kadastral për qëllime të kredit dhënies. Në vitin 2012, vlera e përgjithshme e hipotekave është rritur për 49%, duke arritur kështu 1.3 miliard euro. Disa libra të regjistrimit të tokave mbeten në Serbi. Një marrëveshje mbi regjistrat kadastral është arritur në kuadër të kornizës së negociatave Beograd - Prishtinë. Mbetet të miratohet legjislacioni i duhur për zbatimin e marrëveshjes. *Në përgjithësi*, ka pasur një rritje të përdorimit të pronës si kolateral. Korniza ekzistuese ligjore është e pazhvilluar dhe zbatimi i saj ka mbetur i dobët. Zbatimi i vështirë, i gjatë dhe i kushtueshëm ligjor dhe korrupsioni i përhapur ka vazhduar të pengojnë mjedisin e biznesit.

Zhvillimi i sektorit financiar

Në vitin 2012, sektori financiar i Kosovës u zgjerua me 8.5% me asete në vlerë prej 3.8 miliard € Sektorit bankar mbeti mbizotërues dhe kontribuon në 74% të të gjitha asetëve të

sektorit financiar, i pasuar nga fondet pensionale (19.5%). Numri i përgjithshëm i bankave që operojnë në Kosovë u rrit në nëntë në vitin 2012, pasi një bankë e re hyri në treg. Numri i fondeve pensionale (2) dhe kompanive të sigurimit (13) ka mbetur i pandryshuar. Përqendrimi i sistemit bankar mbetet i lartë, me 70 % të aseteve të menaxhuara nga tri bankat më të mëdha. Pothuajse 90% e aseteve në këtë sektor mbahen nga bankat e huaja. Fitimet në sektorin bankar arritën në 19.2 milion € në vitin 2012, një ulje e konsiderueshme (46.7 %) në krahasim me vitin 2011. Proporcioni i kredive të këqija (jo-performuese) nga 5.8% që ishte në fund të vitit 2011 u rrit në 7.6 % nga totali i kredive në qershor. Kjo ndodh për shkak të përkeqësimit të cilësisë së kredive në tregti, pasuri të patundshme dhe sektorë të ndërtimit. Megjithatë, kreditë e këqija mbeten në mënyrë adekuate të parashikuara dhe bankat vazhdojnë të mbajnë likuiditet të konsiderueshëm shtesë.

Kërkesa më të rrepta rregullative për sa i përket kapitalit, i cili ka hyri në fuqi në vjeshtë të vitit 2012, kanë vënë nën presion disa prej treguesve solid të bankave. Disa banka kanë rënë nën minimumin rregullativ prej 12% dhe duhet të ri-kapitalizohen. Megjithatë, raporti i mesatarë i mjaftueshmerisë së kapitalit qëndroi në 16% në fund të korrikut të vitit 2013. Amandamentimet në ligjin e sigurimit të depozitave, i miratuar në dhjetor, parashikoi një rritje të pragut për depozitat e siguruar nga shuma aktuale prej 2000 € në 5000 € deri në vitin 2018. Kapitali i Fondit të Sigurimit të Depozitave është forcuar dhe ishte miratuar një rezolutë për rritjen e fondit të saj rezervë për 8-9% të të gjitha depozitave të siguruar gjatë një periudhe prej 14 vitesh.

Në prill të vitit 2013, Gjykata Kushtetuese lëshoi një vendim që shpalli një numër nënesh të ligjit mbi bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet jo-bankare financiare të vitit 2012 në kundërshtim me Kushtetutën. Nenet në fjalë i referohen mundësisë së institucioneve mikrofinanciare të OJQ-ve për t'u bërë kompani aksionare. Në përgjithësi, ka pasur hapa të rëndësishëm për forcimin e stabilitetit financiar dhe mbikëqyrjes, edhe pse ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësime të mëtejshme. Kreditë e këqija janë rritur, mjaftueshmëria e kapitalit të bankave dhe treguesit e përfitimit janë përkeqësuar, edhe pse sistemi në tërësi ka mbetur mjaft stabil.

Aktiviteti i kredive është ngadalësuar fuqishëm, nga nivelet dyshifrore të rritjes në rreth 4% deri në fund të vitit 2012. Megjithatë, pjesa e totalit të kredive dhe financimi i qirasë në BPV-në është rritur paksa në 36.3%. Që nga fillimi i vitit 2013, bankat tregtare kanë zgjeruar në kredi të reja 87 milion € 4% më pak sesa në periudhën përkatëse të vitit të kaluar. Rënia ka qenë e theksuar sidomos në kreditë për investime të reja për korporatat jo financiare, të cilat kanë rënë me 29%, ndërsa kreditë konsumatore dhe hipotekare janë rritur fuqishëm, me 45% respektivisht 17%.

Një sondazh i kryer nga banka qendrore tregoi se bankat aplikojnë kritere më të rrepta për kredi, kryesisht për shkak të një perceptimi negativ të situatës së përgjithshme ekonomike. Kreditë për sektorin tregtar vazhdojnë të dominojnë portofolin e kredive, duke llogaritur 36% të tyre deri në fund të qershorit të vitit 2013. Kreditimi vazhdoi të financohet brenda vendit; raporti në mes të kredive dhe depozitave ka rënë në 77.5%, duke kufizuar rrezikun e krizës së rrjedhjes përmes financimit ndërkufitar.

Në vitin 2012, depozitat u rritën me 8.3%, duke arritur në 2.3 miliard € ose 46.4% të BPV-së deri në fund të vitit. Deri në fund të muajit korrik, rritja në depozita është ngadalësuar dhe ka mbetur në 4.6%. Pozicioni tashmë i mirë i likuiditetit të sistemit bankar është përmirësuar më tej dhe bankat komerciale kanë rritur stoqet e tyre në bankën qendrore në rreth 300 milionë €. Shpërndarja mesatare e normave të interesit në mes të kredive dhe depozitave ka rënë paksa, por ka mbetur në nivel të lartë prej 9,85% sa ishte në vitin 2012. Në fillim të vitit 2013, rritja e të ardhurave nga interesi bankar për herë të parë ndonjëherë kalon në humbje, ndërsa shpenzimet e interesit dhe dispoziat kanë vazhduar të rriten, duke zvogëluar përfitimin e bankave. Në përgjithësi, baza e depozitave ka vazhduar të rritet me një normë më të fuqishme,

derisa aktiviteti kreditues është ngadalësuar dhe kushtet e kreditimit kanë mbetur të shtrënguara.

3.2 Kapaciteti i përballjes me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian

Ekzistenca e një ekonomie funksionale të tregut

Stabiliteti makroekonomik është ruajtur në masë të madhe, përkundër sfondit të krizës ekonomike në Evropë dhe mos-balancimeve të vazhdueshme të larta të brendshme dhe të jashtme. Në një mjedis të vështirë, disa hapa janë ndërmarrë për forcimin e kornizës së sistemit financiar, përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe kufizimin e shpenzimeve buxhetore. Në të njëjtën kohë, përpjekje të tjera të rëndësishme janë të nevojshme për të zhvilluar një sektor privat konkurrues dhe për vendosjen e qëndrueshmërisë fiskale. Në përgjithësi, sundimi i dobët i ligjit, një ekonomi e madhe joformale dhe një kornizë e pazhvilluar e politikës kanë vazhduar të pengojnë ekonominë.

Kapitali njerëzor dhe fizik

Disa përparime janë bërë në sektorin e arsimit, veçanërisht për sa i përket sistemeve dhe procedurave për zbatimin e një qasje të gjerë sektoriale në arsim. Në përputhje me kornizën arsimore të kuadrit profesional, janë hapur qendra të reja të aftësisimit profesional, është shqyrtuar plan-programi dhe është krijuar një certifikatë e standardizuar e akreditimit për disa drejtime profesionale. Arsimi ka mbetur një nga programet më të mëdha qeveritare, që llogaritet për rreth 4% e BPV-së. Megjithatë, burimet e alokuara për këtë mbetet ende relativisht të ulëta. Modernizimi i shërbimit të punësimit publik ka vazhduar dhe Sistemi Informativ i Menaxhimit të Punësimit është funksional, duke mbajtur një bazë të të dhënave të punëkërkuësve. Në përgjithësi, në sektorin e arsimit ka pasur disa përmirësime. Megjithatë, ai ende ndikohet nga mungesa e objekteve adekuate, mirëmbajtja dhe sigurimi i cilësisë. Karakterizohet nga rezultatet e dobëta të cilat nuk plotësojnë mjaftueshëm kërkesat e tregut të punës. Investim i rëndësishëm në kapitalin njerëzor është i nevojshëm për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Investimi i përgjithshëm vlerësohet të ketë rënë në vitin 2012. Megjithatë, ajo qëndroi në një nivel relativisht të lartë prej rreth 31% të BPV-së. Investimet e Qeverisë (kryesisht në infrastrukturën rrugore) janë rritur dhe mbeten të larta në 11% të BPV-së, ndërsa duket se ka pasur një rënie në investimet private. Ka pasur përfshirje të vogël të sektorit privat në fushat kyçe si në ujë dhe ujërat e zeza, shërbimet rrugore dhe hekurudhore. Ndërtimi i autostradës (R7) drejt Tiranës ka vazhduar dhe është planifikuar të përfundojë në vitin 2013. Puna në autostradën e re për Shkup pritet të fillojë kah fundi i vitit 2013, me një alokim të 28 milion € (0.5% të BPV-së), me kusht që të ardhurat e shitjes së PTK-së të jenë në dispozicion. Në fushën e infrastrukturës energjetike, Konsorciumi Calik-Limak në maj të vitit 2013 mori përsipër Kompaninë Kosovare për Distribucion dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS-in) dhe i kanë premtuar 300 milionë € për modernizimin dhe funksionalizimin e rrjetit të shpërndarjes. Pak është bërë në përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Janë të pamjaftueshme informatat në lidhje me nivelin dhe strukturën e investimeve private. Në përgjithësi, përveç infrastrukturës rrugore, ka pasur pak përmirësim në kapitalin fizik. Shpenzimi kapital i qeverisë ka mbetur i përqendruar kryesisht në ndërtimin e autostradës, në kurriz të nevojave të sektorëve tjerë.

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Sektori i ndërmarrjeve në Kosovë mbetet i dominuar nga ndërmarrjet e vogla dhe mikro-ndërmarrjet. Tregtia me pakicë vazhdon të jetë sektor dominues, me një pjesëmarrje prej 31.3% të të gjitha ndërmarrjeve të reja, duke shënuar një rënie të vogël në pjesën e përgjithshme në krahasim me vitet e kaluara. Ekziston një sektor i madh joformal i nxitur nga mangësitë në taksa, politikat e shpenzimeve dhe në zbatimin e ligjit, duke përfshirë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Kjo zvogëlon bazën tatimore dhe efikasitetin e

politikave ekonomike. Mbetet sfida qasja në financa dhe kostot e tyre. Në vitin 2013, qeveria i u bashkua një projekti të financuar nga BE-ja i cili mbështet mikro-ndërmarrjet dhe NVM-të e orientuara drejt eksportit. Qëllimi i projektit është të përmirësojë teknologjinë e tyre dhe të rrisë kapacitetin e prodhimit. *Në përgjithësi*, sektori i tregtisë me pakicë u bë më pak dominuese në strukturën e përgjithshme të ndërmarrjeve, kryesisht për shkak të rritjes së ndërmarrjeve të sapo regjistruara në bujqësi. Sektori i madh joformal vazhdon të përbëjë një sfida të madhe.

Ndikimi i shtetit në konkurrueshmëri

Subvencionet buxhetore dhe transferet kapitale në ndërmarrjet publike (NP-të) kanë rënë paksa, në rreth 1.1% të BPV-së në vitin 2012. Subvencionet u janë dhënë NP-vë në energji, hekurudha, ngrohje qendrore, ujit dhe mbeturinave, dhe minierave të Trepçës. Qeveria ka vazhduar me skemën e grandeve të përbëra nga pagesat e kombinuara për bujqit dhe blegtorët si dhe grandet që përputhen për sektorët e bulmetit, frutave dhe perimeve në nivel të fermës. Në vitin 2013, qeveria zgjeroi pagesën e kombinuar në sektorët tjerë (p.sh., misrit, lulediellit dhe hortikulturës) dhe kanë vazhduar grandet e përshtatshme për pylltarinë, skemat e ujitjes, bimët aromatike dhe përkrahjen për zonat më pak të favorizuara. Brenda sektorit të energjisë, rregullatori i energjisë (ZRRE) ka aprovuar një rritje të çmimeve të energjisë elektrike prej 8.9% në vitin 2012 dhe ka refuzuar rritje të mëtejshme për vitin 2013. *Në përgjithësi*, ndërhyrja e shtetit në ekonomi ka rënë, por ende mbetet e lartë. Ende nuk është themeluar korniza institucionale për monitorimin dhe miratimin e ndihmës shtetërore.

Integrimi ekonomik me BE-në

Hapja e ekonomisë, e matur nga vlera e importeve dhe eksporteve të mallrave dhe shërbimeve në raport me BPV-në, ka mbetur e qëndrueshme me rreth 71.2%. Pjesa e eksporteve në Shtetet Anëtare të BE-se është zvogëluar në krahasim me vitin 2011. Ajo llogaritet për pothuajse 39.6% të totalit të eksporteve të mallrave (43% në vitin 2011). Pjesa e eksporteve drejt vendeve pjesëmarrëse të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) është rritur ndjeshëm me rreth 37.8% të totalit të eksporteve (26% në vitin 2011), sidomos për shkak të rritjes së eksporteve me Shqipërinë dhe Malin e Zi. Vendet e BE-së dhe CEFTA-së kanë mbetur prejardhja kryesore e importeve të Kosovës, me aksione rreth 39% respektivisht 34%. Me rreth një të tretën e investimeve të përgjithshme, vendet e BE-së mbeten investitorët më të mëdhenj në Kosovë. *Në përgjithësi*, integrimi ekonomik me BE-në mbetet i rëndësishëm.

4. STANDARDED EUROPIANE

Ky seksion shqyrton kapacitetin e Kosovës për të përafuar gradualisht legjislacionin dhe politikat e saj me *acquis-in* në fushat e tregut të brendshëm, politikat sektoriale dhe drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, në kontekstin e Procesit të Stabilizimit Asociimit. Po ashtu analizon kapacitetet administrative të Kosovës. Në çdo sektor, vlerësimi i Komisionit mbulon progresin e arritur gjatë periudhës raportuese, dhe përmbledh nivelin e përgjithshëm të përgatitjes së Kosovës.

4.1 Tregu i brendshëm

4.1.1 Lëvizja e lirë e mallrave

Në muajin shkurt, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka miratuar një strategji të përgjithshme mbi lëvizjen e lirë të mallrave, e cila i jep prioritet miratimit të rregulloreve në këtë fushë. Ishte miratuar zbatimi i legjislacionit në Këshillin Profesional të **Standardizimit**. Është vendosur një sistem i bazës së të dhënave për standardet. Memorandumet e mirëkuptimit janë nënshkruar me agjencitë e standardizimit të Shqipërisë, Ish-Republikës Jugosllave të

Maqedonisë dhe Turqisë. Gjatë periudhës së raportimit, rreth 1200 standarde Evropiane (EN) janë miratuar si standarde kosovare. Sidoqoftë shumica e këtyre standardeve, ende nuk janë përkthyer në gjuhët zyrtare të Kosovës.

Sa i përket **vlërësimit të konformitetit**, janë miratuar katërmbëdhjetë rregullore mbi kërkesat teknike (nëntë të mbuluara nga direktivat e qasjes së re, pesë nën direktivat e qasjes së vjetër). Dy rregullore janë miratuar mbi produktet që përbëjnë një rrezik për konsumatorët (njoftimi dhe shkëmbimi i shpejtë i informacionit). Një organ inspektimi i produkteve të naftës (ISO 17020) dhe pesëmbëdhjetë laboratorë testues ishin akredituar në përputhje me standardet EN / ISO. Dy laboratorë testues dhe dy organe inspektuese janë certifikuar në përputhje me standardet EN / ISO në fushën e lëndëve djegëse me bazë të naftës.

Për sa i përket **akreditimit**, u miratua zbatimi i legjislacionit mbi formën, përmbajtjen dhe përdorimin e logos së akreditimit. Dy akreditime janë tërhequr për shkak se organet e akredituara nuk përputheshin më me kërkesat legjislative. Staf i Drejtorisë së Akreditimit është rritur për dy zyrtar të kontabilitetit në gjithsej pesë zyrtar.

Sa i përket **metrologjisë**, një ligj mbi metalet e çmuara dhe disa udhëzime administrative janë miratuar, duke përfshirë tarifën e agjencisë, peshat dhe kërkesat tjera për testim. Memorandumi i mirëkuptimit është nënshkruar me Turqinë dhe Shqipërinë. Në dhjetor, departamenti përgjegjës për metrologjinë, metrologjinë industriale dhe shkencore si dhe mbikëqyrjen metrologjike në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ishte caktuar si agjenci. Po ashtu, kapacitetet e saj janë rritur. Pesëmbëdhjetë nga njëzet vendet e lira të punës janë plotësuar. Mbetet i kufizuar kapaciteti i stafit për të përfituar plotësisht nga asistencat teknike e ofruar. Disa laboratorë janë themeluar në Prishtinë dhe Prizren, por funksionet e tyre nuk janë plotësisht në përputhje me standardet e nevojshme cilësore.

Sa i përket **mbikëqyrjes së tregut**, në muajin maj u amendamentua ligji për inspektoratin e tregut si dhe ai mbi sigurinë e përgjithshme të produkteve. Departamenti i mbikëqyrjes së tregut ishte riorganizuar dhe transformuar në një agjenci. Janë përfunduar marrëveshjet e bashkëpunimit me doganën për verifikimin e produkteve jo-ushqimore industriale, si dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe luftimit të piraterisë. Gjatë periudhës raportuese, janë kryer mbi 1500 inspektime. Mbi 60 raste janë dërguar në gjykatë. Gjykatat morën gjashtë vendime.

Amandamentimet në ligjin për **mbrojtjen e konsumatorit** janë miratuar në nëntor. Ligji mbulon fushat të cilat më parë nuk adresoheshin, duke përfshirë emërtimin, shitjen në ankand, zbritjet, pagesat e avancuara, kontratat derë-më-derë, shërbimet financiare (kredi për konsumatorë, norma e interesit), kontratat për mbiterheqje dhe kartelat e kreditit, praktikën e padrejta tregtare, praktikën mashtruese tregtare, praktikën agresive tregtare, reklamat dhe blerjet mashtruese dhe krahasuese, dhe shitjet përmes internetit. Gjithashtu ishte miratuar zbatimi i legjislacionit mbi emërtimin dhe deklarimin e mallrave.

Është ristrukturuar Departamenti i mbrojtjes së konsumatorit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Departamenti ka tre pozita, njëra prej të cilave ende duhet të plotësohet. Rolet përkatëse të departamentit të mbrojtjes së konsumatorit dhe inspektoratit të tregut janë të përcaktuara. Struktura e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit ishte azhurnuar. Ajo përbëhet nga shtatë anëtarë, duke përfshirë Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Agjencionin e Ushqimit dhe Veterinarisë, përfaqësuesve të biznesit, shoqërisë civile dhe një ekspert të pavarur.

Afër 220 ankesa janë parashtruar gjatë periudhës raportuese. Janë zgjidhur rreth 120 raste. Zyra për mbrojtjen e konsumatorit ka zhvilluar një bazë të re të të dhënave dhe një ueb-faqe të avancuar që synon përmirësimin e komunikimit me klientët. Është zbatuar një program i rritjes së vetëdijes për konsumatorët.

Në përgjithësi, Kosova ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e përafrimit me *acquis-in*, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit. Kërkohen përpjekje të mëtejshme në

fushën e legjislacionit të sigurisë së produktit. Kapaciteti administrativ, profesionalizmi dhe ekspertiza duhet të përmirësohen për të siguruar zbatimin më të mirë të legjislacionit. Ministrinë dhe agjencitë e ndryshme aktive në këtë fushë duhet të përmirësojnë koordinimin e tyre.

4.1.2 Lëvizja e personave, shërbimeve dhe e drejta e themelimit

Sa i përket **lëvizjes së personave**, Kosova ka negociuar marrëveshje dypalëshe për sigurimet shoqërore me Austrinë, Gjermaninë dhe Zvicrën. Është arritur një marrëveshje me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, për periudhat e sigurimit mbi të drejtën e përfitimit nga të drejtat pensionale. Përpjekje të konsiderueshme janë të nevojshme për të siguruar përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit nga Kosova në këtë fushë.

Sa i përket të **drejtës së themelimit dhe lirisë për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare**, Kuvendi ka miratuar një numër të ligjeve në vitin 2012 siç janë: ligji për tregtinë e jashtme (duke përfshirë tregtinë në shërbime), ligjin për masat mbrojtëse në importe dhe ligjin mbi mbrojtjen e konsumatorit (që mbulon shitjen e produkteve dhe ofrimin e shërbimeve, si dhe shërbimeve financiare të konsumatorit).

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka ngritur një bazë të të dhënave të tregtisë në shërbime. Përafrimi me *acquis-in* është në një fazë shumë të hershme dhe ka disa kufizime për shtetasit e vendeve të treta në ofrimin e shërbimeve në Kosovë. Kosova është duke negociuar liberalizimin e tregtisë në shërbime brenda CEFTA-s. Autoriteti i Kualifikimeve të Kosovës ka miratuar dhe regjistruar gjashtë kualifikime profesionale në sistemin e Kosovës, e cila është në përputhje me kornizën evropiane të kualifikimeve. Autoriteti i Kualifikimeve ka akredituar dymbëdhjetë ofrues të programeve të aftësisimit profesional. Përafrimi me *acquis-in* mbi **njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale** dhe programeve të aftësisimit profesional është ende i kufizuar.

Ligji për **shërbimet postare** parasheh një zonë të rezervuar për letrën/pakon që peshon nën një kilogram. Përpjekjet për liberalizimin e mëtejshëm të tregut janë në vazhdim e sipër, por duhet të intensifikohet për të siguruar liberalizimin e plotë të sektorit. Kosova gjithashtu është duke ndërmarre hapa për të siguruar konkurrencën në tregun e komunikimeve elektronike. Një total prej nëntëmbëdhjetë ofruesish të shërbimeve të reja të telekomunikacionit dhe një operatori për shërbime postare janë licencuar në vitin 2012.

Sa i përket **shërbimeve financiare**, ligji për sigurimin e depozitave është amandamentuar në muajin dhjetor. Ndryshimi lejon një rritje graduale në madhësinë e depozitave të siguruara (nga 2000 € të tanishme në 5000 € në vitin 2018) paralelisht me rritjen e pritshme në fondin e sigurimit të depozitave. Ligji i rishikuar zvogëlon afatin maksimal për ri-pagesat ndaj depozituesve të siguruar nga 60 deri 30 ditë. Gjithashtu përmirëson shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet fondit të sigurimit të depozitave dhe bankës qendrore.

Është miratuar legjislacioni zbatues duke futur disa nga kërkesat e rrezikut të Basel II. Ndryshimet përfshijnë rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit, rregullorja mbi administrimin e rrezikut funksional dhe rregullorja për mjaftueshmërinë e kapitalit të bankës. Banka qendrore duhet të finalizojë rishikimin e legjislacionit ekzistues. Sektori i sigurimeve u zgjerua në vitin 2012. Pësia e tij në sektorin e përgjithshëm financiar mbetet relativisht e ulët, që përbën vetëm 3.4% të totalit të aseteve financiare. Në të njëjtën kohë, tregu i sigurimeve përfaqëson 2.7% të BPV-së.

Sa i përket letrave me vlerë, një platformë elektronike tregtare e themeluar nga banka qendrore u bë funksionale. Qeveria me sukses ka lëshuar bono thesari 3-mujore, 6-mujore dhe 12-mujore. Borxhi i jashtëm përfaqëson 6.5% të BPV-së. Borxhi i brendshëm është 1.4% i BPV-së. Të gjitha aktivitetet e huamarrjes, duke përfshirë borxhin e jashtëm dhe atë të brendshëm, ishin në përputhje me strategjinë e borxhit vjetor. Gjatë periudhës raportuese,

borxhi ne raport me BPV-në arriti në 8.4%.

Sa i përket **ligjit mbi kompanitë**, procesi i regjistrimit të biznesit është thjeshtësuar. Është larguar dispozita që kërkon depozitim të fillestar të kapitalit minimal për kompanitë me përgjegjësi të kufizuar. Kapitali fillestar për kompanitë aksionare është ulur në 10 000 € Është hequr po ashtu tarifa për regjistrimin e biznesit. Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë kryen regjistrimin e të gjitha bizneseve. Kompanitë e huaja janë të lejuara të hapin dhe drejtojnë një biznes në të njëjtte kushte sikurse bizneset lokale për aq kohë sa ato janë të regjistruar me agjencinë. Në një përpjekje për decentralizimin dhe lehtësimin krijimit and regjistrimit të një biznesi, 28 Qendra për Shërbimin e Qytetarëve tani ofrojnë shërbime në komuna të ndryshme.

Në përgjithësi, përafrimi me standardet evropiane mbi lëvizjen e personave, shërbimet dhe të drejtat e themelimit, si dhe ligjit për kompaninë, është ende në një fazë shumë të hershme. Nevojitet kapacitet administrativ dhe një analizë e mangësive, sidomos në lëvizjen e lirë të shërbimeve. Përafrimi dhe kapaciteti administrativ në shërbimet financiare janë më të avancuara.

4.1.3 Lëvizja e lirë e kapitalit

Lëvizja e kapitalit është liberalizuar në masë të madhe në Kosovë. Një banke e re e huaj hyri në tregun bankar në nëntor të vitit 2012. Momentalisht, nëntë bankat e huaja kontrollojnë pothuajse 90% të sektorit bankar të Kosovës. Në vitin 2012, në përgjithësi investimet e huaja të drejtpërdrejta kanë rënë dukshëm (nga 41.9%) në krahasim me vitin 2011, duke qëndruar në 6.6% të BPV-së.

Në muajin prill ishte miratuar ligji mbi **sistemet e pagesave**. Kjo synon të krijojë një infrastrukturë ligjore për licencimin, autorizimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve të pagesave, operatorët e pagesës, sistemet e kliringut dhe letrave me vlere. Në muajin qershor, SWIFT-i ka atribuar një kod për bankën qendrore.

Në fushën e **blerjes së pasurive të patundshme** nga jo-kosovarët kuadri ligjor bazë është liberal dhe jo-diskriminuese. Dispozitat administrative parandalojnë jo-qytetarët e Kosovës nga ushtrimi faktik i kësaj të drejtë.

Në përgjithësi, sistemi për lëvizjen e kapitalit është shumë liberal. Nuk ka kufizime në lidhje me pronësinë ose investimin e huaj në sektorin financiar. Kufizime administrative ekzistojnë lidhur me pronën e paluajtshme. Kjo duhet të adresohet. Kapaciteti i bankës qendrore për mbikëqyrjen e sektorit është adekuat. Duhet të theksohet më shumë mbi qasjen e bazuar në rrezik.

4.1.4 Doganat dhe tatimet

Sa i përket **doganave**, Kosova ka përmirësuar më tej infrastrukturën, kapacitetin e saj administrativ dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Sistemi i Automatizuar për të Dhënat e Doganave (ASYCUDA) ka qenë plotësisht funksional që nga vjeshta e vitit 2012. Në fillim të vitit 2013, doganat janë ristrukturuar përbrenda për ti përmirësuar kontrollet dhe për t'i bërë auditimet më efektive. Ky proces gjithashtu kërkon të përmirësoje bashkëpunimin me Administratën Tatimore të Kosovës dhe shmang dyfishimin e përpjekjeve përmes operacioneve dhe kontrolleve të përbashkëta.

Doganat e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Austrinë, Poloninë dhe Italinë, duke arritur në gjithsej njëmbëdhjetë marrëveshje të ndihmës reciproke. Që nga fundi i vitit 2012, Sistemi i Shkëmbimit Elektronik të Dhënave (SEED) ka qenë plotësisht funksional në mes të doganave të Kosovës dhe të Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Kosova është inkurajuar të nënshkruajë dhe ratifikojë Konventën Pan-Euro-Med mbi rregullat e prejardhjes.

Procedurat doganore në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë përparuar më tej me hapjen e pikave të përbashkëta të përkohshme të kalimit kufitar në dhjetor të vitit 2012 dhe janar të vitit 2013 në gjashtë lokacione, duke përfshirë edhe dy pikat kufitare në veri të Kosovës, sipas marrëveshjes së MIK-ut. Themelimi i këtyre pikave të bashkë-vendosura të kalimit kufitar ka lejuar bashkëpunim të përditshëm mes dy administratave dhe shkëmbim të rregullt të informacionit. Më 17 janar të vitit 2013, të dyja palët arritën një marrëveshje për restaurimin e kontrolleve doganore në dy pikat kufitare (porta 1 dhe 31). Miratimi i ligjit për buxhetin e Kosovës në muajin korrik lejoi krijimin e një fondi zhvillimor për veriun, i cili do të financohet nga taksat që mblidhen në dy pikat kufitare. Në ndërkohë, kufiri/kufiri administrativ ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbetet i ndjeshëm ndaj aktiviteteve të paligjshme.

Dogana e Kosovës ka mbledhur të ardhura me vlerë rreth 844 milion € në vitin 2012. Kjo është 2.2% më shumë sesa në vitin 2011, por 32 milion € më pak se të hyrat e planifikuara, pjesërisht për shkak të një reduktimi në importe. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2013, janë mbledhur 360 milion € në të ardhura, rreth 2% më shumë se në vitin 2012, por 7% më pak sesa ishte planifikuar. Në të njëjtën periudhë, doganat kanë shqiptuar gjoba në vlerë prej rreth 261,000 € Kjo është dukshëm më pak sesa periudha e njëjtë e vitit të kaluar ku ishin mbledhur 886,000€

Kodi i ri Penal futi disa ndryshime për sa i përket kompetencave dhe kualifikimeve të veprave penale. Pasi më shumë kundërvajtje tani janë të kualifikuara si vepra penale, prokuroria ka një rol më të madh në fazën hetimore. Dogana mund të aplikojnë diskrecion në trajtimin e kundërvajtjeve minore me anë të aplikimit të gjobave administrative.

Në lidhje me **tatimet**, një numër i ligjeve janë amandamentuar në vitin 2012. Kjo përfshin legjislacionin për administratën dhe procedurën tatimore, tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin e vlerës së shtuar, tatimin mbi lojërat e fatit dhe të ardhurat e korporatës. Administrata Tatimore dhe Agjencioni i Regjistrimit të Biznesit ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për lehtësimin e regjistrimit të biznesit. Janë bërë përpjekje për të rritur pajtueshmërinë vullnetare me taksat. Kërkesat për kthim e TVSH-në, tatimit në burim dhe kontributeve pensionale tani mund të paraqiten në mënyre elektronike.

Të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore arritën në vlerën e 396.9 milion € në vitin 2012, një rritje prej 9% në vitin 2011. Kjo është ende e pamjaftueshme për përfaqësimin e një burimi të qëndrueshëm të të ardhurave. Përveç kësaj, kjo përfaqëson një përqindje më të vogël të BPV-së sesa në vitin 2011. Në gjysmën e parë të vitit 2013, të ardhurat e mbledhura arritën shumën e 148,1 milion € TVSH-ja përfaqëson përqindjen më të lartë të taksave të mbledhura në rreth 47%, me tatimin në korporata në vetëm mbi 22%, e ndjekur nga tatimi në burim dhe tatimet mbi bizneset individuale.

Sa i përket **kapaciteteve administrative dhe funksionale**, sistemi on-line është duke u përdorur gjithnjë e më shumë nga tatimpaguesit. Administrata tatimore është e lidhur me sistemet informative të institucioneve qeveritare të tilla si: dogana, banka qendrore dhe disa ministri. Njësia hetimore e administratës tatimore ka katërmëdhjetë zyrtarë pasuar lëvizjen në detyra tjera si pjesë e stafit të njësisë hetimore në muajin shkurt. Ajo ka arritur rezultate të kufizuara gjatë periudhës raportuese. Në vitin 2012, ka lëshuar shtatëmbëdhjetë gjoba me vlerë në një total prej rreth 6800 € Njësi i inteligjencës tatimore ka staf prej dy personave. Administrata tatimore ka nevojë për modernizimin e platformës së TI-së dhe procedurat e saj për të përmirësuar efikasitetin.

Bordi i Pavarur për Shqyrtim për apelet nga bizneset dhe tatimpaguesit kundrejt administratës tatimore dhe doganore ka ndërmarrë hapa për kryerjen e rasteve të mbetura. Efikasiteti i tij është përmirësuar që nga fillimi i vitit 2013. Bordi ka trajtuar 690 raste në gjashtë muaj. Megjithatë, nuk ka gjasa që rastet e mbetura të kryhen deri në fund të vitit. Në muajin korrik, ishin ende afër 1200 raste në pritje. Qeveria ka ende nevojë për zgjatjen e mandatit të bordit.

Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës mbi doganat është kryesisht në përputhje me Kodin Doganor të BE-së. Përpjekje të mira janë bërë në mbledhjen e detyrimeve doganore dhe në bashkëpunimin ndërkombëtar. Mbledhja e informacioneve, hetimeve dhe menaxhimi i rrezikut janë duke përmirësuar, pasi stafi është duke fituar përvojë. Doganat dhe administrata tatimore duhet të vazhdojnë në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve të tyre administrative. Zbatimi i legjislacionit tatimor mbetet një sfidë e madhe. Mbledhja e tatimeve drejtpërdrejta është rritur, por mbetet në nivelin e qëndrueshëm. Administrata tatimore ka nevojë për një platformë të re të TI-së për përmirësimin e performancës së saj. Luftës kundër ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal duhet ti jepet prioritet dhe të rritet efikasiteti i saj në mënyrë të konsiderueshme.

4.1.5 Konkurrenca

Sa i përket **anti-trustit dhe bashkimeve**, janë nxjerr disa legjislacione zbatuese. Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës miratoi disa vendime. Këtu përfshihen vendimet mbi marrëveshjet e ndaluara në çmimet e biletave për transport ndër-urban, mbi përcaktimin dhe ngritjen e çmimit të miellit dhe të bukës, një vendim lidhur me dyshimin për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e çimentos, dhe dy vendimet për bashkim në sektorët e bulmetit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Autoriteti ka lëshuar po ashtu mendime dhe rekomandime jo-detyruese për qeverinë mbi draftet specifike të legjislacionit dhe vendimeve. Kjo përfshin ligjet mbi duhanin dhe transportin publik, dhe vendimet për mbrojtjen e prodhimit të çimentos në Kosovë. Autoriteti po ashtu ka monitoruar sektorin bankar dhe atë të sigurimeve për mundësinë e praktikimit të marrëveshjeve të fshehta. Nuk kanë gjetur asnjë të tilla, por lëshoi një paralajmërim për kompanitë e sigurimit për parandalimin e praktikave të tilla.

Autoriteti duhet të vazhdojë të rrit kapacitetin e tij, sidomos për sa i përket ekspertizës dhe përvojës së stafit të tij. Autoriteti është ende i vendosur në ndërtesën e kuvendit dhe nuk kanë lokalet e tyre. Për më tepër, menaxhimi i autoritetit dhe procedurat e saj duhet të përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme. Këto mangësi vënë kufizime serioze mbi aktivitetet e autoritetit. Ato duhet të trajtohen si një çështje prioritare. Duhet të bëhet më shumë për rritjen e ndërgjegjësimit të rregullave të konkurrencës dhe mbrojtjes së tyre.

Ligji mbi **ndihmën shtetërore** ka qenë në fuqi që nga janari dhe formon bazën e regjimit të ndihmës së shtetit të Kosovës. Rregullat e punës dhe formati i njoftimit ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2012. Janë themeluar Komisioni i Ndhmës Shtetërore dhe Zyra e Ndhmës Shtetërore (në kuadër të Autoritetit të Konkurrencës). Legjislacioni për kontrollin e ndihmës shtetërore ka nevojë të plotësohet me akte nënligjore mbi bazën e *acquis-it*. Rregullat e brendshme të procedurave për parandalimin e konflikteve të mundshëm të interesit në mes të autoritetit kërkues dhe dhënës janë akoma të nevojshme. Janë emëruar Anëtarët e Komisionit të Ndhmës Shtetërore, por zyra nuk është ende funksionale për shkak të mungesës së zyrave të përshtatshme. Asnjë kërkesë lidhur me ndihmën shtetërore nuk është drejtuar për Zyrën e Ndhmës Shtetërore gjatë periudhës raportuese.

Në përgjithësi, zbatimi i politikës anti-trust dhe asaj të bashkimit është ende në një fazë shumë të hershme. Ligji i konkurrencës është pjesërisht i përafëruar me *acquis-in*. Kapaciteti administrativ i Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës është i pamjaftueshëm për detyrat e tyre të përcaktuara. Harmonizimi i politikës së ndihmës shtetërore është në një fazë shumë të hershme dhe nuk ka asnjë të dhënë të regjistruar të zbatimit.

4.1.6 Prokurimi publik

Është miratuar legjislacioni zbatues që shoqëron ligjin mbi prokurimin publik. Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Agjensioni Qendror i Prokurimit miratoi rregulloret e tyre të brendshme të punës. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i ka dorëzuar kuvendit për miratim raportin e tij për vitin 2012. Mbi 12,000 kontrata janë nënshkruar në vitin 2012.

Operatorët ekonomikë janë informuar në mënyrë adekuate në lidhje me legjislacionin e prokurimit publik.

Janë pranuar afër 380 ankesa dhe rreth 330 prej tyre janë proceduar. Kjo është një rënie e lehtë në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese. Numri i rasteve i kthyer për rivlerësim dhe ri-tenderim në lidhje me shkeljet e gjetura nga ana e organit shqyrtues tregon që specifikimet teknike të paqarta vazhdojnë të jepen në Kosovë. Për momentin organi shqyrtues nuk është funksional pasi që tre nga katër anëtarëve të bordit u ka skaduar mandati në muajin gusht.

Agjencioni Qendror i Prokurimit kryen prokurimin në emër të autoriteteve kontraktuese për projektet me financim ndërkombëtar, por jo për blerjen qendrore, edhe pse ajo është pjesë thelbësore e mandatit të saj. Agjencioni ka staf të përbërë prej pesëmbëdhjetë zyrtareve, ku shtatë prej tyre janë zyrtarë të certifikuar të prokurimit.

Në Kosovë janë të pranishëm 166 autoritete kontraktuese. Të gjithë zyrtarët e prokurimit kanë marrë disa trajnime të ofruara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike. 530 nga 600 zyrtar janë të certifikuar. Sidoqoftë, sistemi i tanishëm i trajnimit duhet të zgjerohet për ti mundësuar të gjithë zyrtarëve të prokurimit të marrin pjesë në trajnim, siç kërkohet nga ligji mbi prokurimin publik.

Në gjykimet e nivelit të lartë në të cilat gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it janë të angazhuar, nëntë persona u shpallen fajtorë për akuzat për korrupsion të lidhura me prokurorin. EULEX-i është duke zhvilluar disa hetime për korrupsion në lidhje me prokurimin publik. Korrupsioni në prokurimin publik është një çështje e përsëritur dhe është përkeqësuar perceptimi publik i transparencës dhe drejtësisë së prokurimit publik.

Në përgjithësi, korniza ligjore përputhet me standardet e BE-së dhe nuk është diskriminuese. Kapaciteti i të gjitha organeve të përfshira duhet të përmirësohet më tej. Është e rëndësishme të shmangen periudhat e gjata gjatë të cilave pozitat kyçe nuk janë të plotësuara. Duhet të forcohet menaxhimi i kontratës dhe kapaciteti planifikues. Vetëdiija duhet të ngrihet sa i përket procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të tyre, dhe korrupsioni duhet të adresohet në mënyrë më efektive nga autoritetet Kosovare.

4.1.7. Ligji i pronësisë intelektuale

Sa i përket **të drejtës autoriale dhe të drejtave të përfaqëta**, është miratuar ligji për ndërmjetësim dhe rregullorja për skemat e kopjeve private që përmirëson përfaqësimin me *acquis-in*. Megjithatë, ende mungojnë dispozitat kyçe zbatuese. Qeveria ka miratuar një strategji kundër piraterisë në tetor të vitit 2012, dhe ngriti një task-forcë për zbatimin e saj. Qëllimi i kësaj task-force është të trajtoj shkeljet e të drejtave të autorit, rritjen e produktivitetit të industrisë kreative dhe luftimin e ekonominë joformale. Task-forca, e cila përbëhet nga organet publike, operatorët e tregut dhe organizatat me interesa ekonomike dhe sociale në drejtat e autorit, kreu veprimet e saj të para në muajin gusht. Janë konfiskuar 10000 CD-e që përmbajnë muzikë, filma, video lojëra dhe programe kompjuterike. Inspektorati i tregut i ka filluar procedurat dhe rastet do të parashtrihen në gjykata kompetente.

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të përfaqëta është i përbërë me personel adekuat. Shtatë ndërmjetësuesit janë rekrutuar sipas ligjit të tanishëm për lehtësimin e kontakteve mes të shoqërive mbledhëse dhe transmetuesve. Stafi ka nevojë për trajnim të mëtejshëm për përmirësimin e ekspertizës së tij. Në praktikë, dy licenca janë ndarë për shoqëritë mbledhëse, njëra për muzikë dhe tjetra për punët audio-vizuale. Të dy organizatat janë në proces të negociimit të tarifave.

Sa u përket të **drejtave të pronësisë industriale**, legjislacioni i ri mbi treguesit gjeografikë u miratua në muajin maj. Zbatimi i legjislacionit po ashtu është miratuar në pajtim me Komisionin i Apeleve të Zyrës për Pronësi Industriale, regjistrimit të patentave, dizajnëve

industriale dhe markave tregtare. Sistemi i Automatizimit të Pronësisë Industriale është plotësisht funksional. U krijua Komisioni i Apelit. Këshilli Kombëtar i Pronësisë Intelektuale është krijuar, por nuk është takuar rregullisht. Procedurat janë ende të gjata, veçanërisht për markat tregtare, dhe ekziston një numër i vazhdueshëm i aplikacioneve të mbetura, pasi që Zyra e Pronësisë Industriale nuk ka personel të mjaftueshëm.

Për sa i përket zbatueshmërisë, një dhomë e veçantë brenda departamentit tregtar të Gjykatës Themelore të Prishtinës është përgjegjëse për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me drejtat e pronës intelektuale. Njësitë doganor për të drejtat e pronësisë intelektuale ka hartuar një plan veprimi me objektivat dhe detyrimet specifike. Policia nuk ka një njësit të specializuar për të drejtat e pronësisë intelektuale dhe ekspertiza e oficerëve policor në këtë fushë është e kufizuar. Legjislacioni për zbatueshmëri nuk është në përputhje me rregulloren e re të BE-së mbi konfiskimin, magazinimin dhe shkatërrimin e mallrave.

Në përgjithësi, korniza legjislativë është kryesisht i përafuar me *acquis-in*, me përjashtim të zbatimit. Kapaciteti administrativ në këtë fushë mbetet i dobët, veçanërisht në kuadër të Zyrës për Drejtat e Autorit, Drejtat e Përafuara dhe Zyrës së Pronësisë Industriale, përkundër numrit të stafit. Zbatueshmëria vazhdon të jetë një sfidë, posaçërisht sa i përket burimeve njerëzore, koordinimit, legjislacionit dhe infrastrukturës. Zbatimet e para premtuese kanë ndodhur në kohën e fundit.

4.1.8. Politikat e punësimit dhe ato sociale, politikat e shëndetit publik

Sa i përket **politikës së punësimit** dhe ofrimit të shërbimit, menaxhimi i sistemit informativ të punësimit është modernizuar dhe ka filluar në muajin prill. Kjo i lejon zyrtarëve të punësimit të kryejnë profilizim dhe shënjestrim më të mirë të grupeve më të rrezikuara dhe ka për qëllim të kontribuojë në përshtatjen më efektive të punës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka vazhduar të zbatojë politikat aktive të tregut të punës përmes rrjetit të saj në shtatë qendrat rajonale të punësimit dhe 23 zyrave komunale të punësimit, si dhe Qendrës së Aftësisimit Profesional në bashkëpunim me ndërmarrjet e sektorit privat. Është zhvilluar softueri për sistemin informativ të tregut të punës, por akoma nuk është funksional. Bazat e të dhënave të ndërmjetësisimit janë krijuar dhe instaluar brenda institucioneve që tashmë i kishin bazat e brendshme të të dhënave. Politikat e punësimit do të përfitojnë nga anketat e fuqisë punëtore të vitit 2012 të kryera nga zyra e statistikave. Për të përmirësuar lidhjen në mes të tregut të punës dhe institucioneve arsimore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka miratuar një strategji dhe një plan veprimi për praktikën profesionale.

Mbeten i kufizuar kapaciteti i ministrive dhe institucioneve tjera për kryerjen e një analizë të hollësishme, hartimin e politikave dhe ndërhyrjeve në program. Këto kufizime janë: kapacitetet teknike, burimet njerëzore dhe infrastruktura fizike. Ndarja buxhetore për masat aktive të tregut të punës (më pak se 1% e buxhetit të konsoliduar) është i pamjaftueshëm për të adresuar në mënyrë efektive nevojat. Zbatimi i masave aktive të tregut të punës mbetet i financuar nga donatorët, me mbështetje shumë të kufizuar nga buxheti i Kosovës, për këtë arsye i mungon financimi i qëndrueshëm.

Situata për të rinjtë në masë të madhe ka mbetur e njëjtë, posaçërisht për ata që janë më të margjinalizuar. Ky grup është i ndikuar negativisht nga mungesa e mekanizmave të duhur qeveritarë për zbatimin e politikës ekzistuese. Sondazhi i fundit ka treguar se 75% e të rinjve duan arsimim cilësor (formal dhe joformal) si një çështje me prioritet. Në anketën e kryer nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në rrjedhën e zhvillimit të strategjisë së re të të rinjve dhe planit të veprimit për vitet 2013-2017, 25% e të intervistuarve thanë se arsimi joformal kishte një rol kyç në zhvillimin e tyre profesional. Papunësia tek të rinjtë (për ata të moshës 15-24 vjeçare) është vlerësuar në 73%, me 30% të të rinjve të cilët kërkojnë mbështetje financiare dhe institucionale për fillimin e bizneseve. Aktiviteti i ulët dhe normat e

përgjithshme të punësimit, sidomos në mesin e grave, pjesa e madhe e sektorit joformal, dhe papunësia shumë e lartë mbeten shqetësime serioze për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Sa i përket **politikave sociale**, *ligji i punës* ka nevojë të amendamentohet dhe zbatimi i saj duhet të mbështetet nga burime të mjaftueshme financiare. Ligji mbi *shëndetin dhe sigurinë në punë* u miratua në muajin maj. Inspektorati i punës ka organizuar trajnim për inspektorët shëndetësor dhe ata të sigurisë. Në vitin 2012, janë raportuar 62 aksidente në punë (shtatëmbëdhjetë me fatalitet, 45 me lëndime të rënda trupore). Inspektorati i punës ka 49 inspektorë. Kjo është e pamjaftueshme.

Në aspektin e *dialogut social*, janë lëshuar udhëzimet administrative që do të lejonin regjistrimin e marrëveshjeve kolektive. Ligji mbi grevat ishte amendamentuar. Buxheti ishte rezervuar për Këshillin Ekonomiko-Social. Megjithatë, partnerët socialë, sidomos sindikatat, kanë kapacitet të kufizuar. Shumica e sindikatave tregtare, me përjashtim të atyre në shëndetësi dhe arsim, kanë mungesa themelore të aftësive menagjeriale dhe avokuese. Ka po ashtu ekspertiza të pamjaftueshme ligjore për asistimin në procesin legjislativ.

Për sa i përket *përfshirjes sociale*, Kosova ka nevojë të përqendrohet në përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit të rregullt të përfundimeve të orientuara në rezultate të politikave aktuale sociale, duke përfshirë zhvillimin e politikave të bazuara në dëshmi. Kapaciteti lokal duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme. Kjo vlen po ashtu për partnerët socialë për zhvillimin e politikave, zbatimin dhe monitorimin në punësim si dhe fushave të politikës së përfshirjes sociale.

Sa i përket *mbrojtjes sociale*, licencimi i ofruesve të shërbimeve shoqërore ka filluar dhe Strategjia për Decentralizimin e Shërbimeve Sociale për vitet 2013-2017 është miratuar. Megjithatë, shërbimet sociale të decentralizuara nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Komunat nuk janë duke zbatuar plotësisht përgjegjësitë për decentralizimin e shërbimeve sociale dhe formulën e buxhetit për decentralizimin, i zhvilluar në vitin 2012, ende nuk është funksional. Grandet e dedikuara të rezervuara për të gjitha shërbimet sociale në buxhetet komunale duhet të ndahet për të siguruar decentralizim efektiv. Koordinim më i mirë ndërministror i veprimtimit dhe alokimit të resurseve është i nevojshëm për të ofruar shërbime efektive.

Sa i përket *mundësive të barabarta*, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (2008-2013) do të përfundojë në fund të këtij viti. Qeveria duhet të vlerësojë zbatimin e saj me kujdes dhe të marrë parasysh mësimet e nxjerra pasi të fillon hartimi i programit të ardhshëm dhe planit veprues në këtë fushë. Dispozita e ligjit të punës që prezanton pagesën e pushimit të lehonisë deri në nëntë muaj, ka pasur një ndikim negativ në punësimin e gruas në disa raste, veçanërisht në sektorin privat.

Në lidhje me **politikën e shëndetit publik**, një ligj i amendamentuar shëndetësor hyri në fuqi në muajin maj. Shkalla e vdekshmërisë perinatale ka vazhduar të bjerë pasi janë bere përmirësime në shërbimet e shëndetit të nënës dhe fëmijës. Të prekurit nga kontaminimi me plumb nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të kenë mbështetje mjekësore. Megjithatë, burimet e pamjaftueshme financiare pengojnë politikën dhe zbatimin e kornizës ligjore lidhur me shëndetin e përgjithshëm. Mbetet një shqetësim mungesa e të dhënave statistikore mbi shëndetin, sidomos në shëndetin e nënës dhe fëmijës. Kapaciteti dhe funksionimi i Sistemit Informativ Shëndetësor duhet të bëhen përmirësime për të siguruar të dhëna të besueshme statistikore shëndetësore në nivel qendror dhe komunal. Mbetet sfida mbulimi i tërë territorit.

Ligji i amendamentuar *mbi kontrollin e duhanit*, i miratuar në muajin prill, prezantoi hapësira publike 100% pa duhan. Ajo përputhet me udhëzimet e OBSH-së nga Konventa Kornizë mbi

Kontrollin e Duhanit. Me përjashtim të ndalimit të konsumit të duhanit oral, legjislacioni i duhanit është përafshuar me standardet evropiane.

Në fushën e *sëmundjeve ngjitëse*, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik raporton 95% mbulim me imunizim, me përjashtim të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptas.

Sa i përket të *drejtës së pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkuftar*, janë duke u zbatuar marrëveshjet bilaterale.

Për sa i përket *shëndetit mendor*, stigmatizimi i të prekurve duhet të adresohet. Është i nevojshëm investimi i mëtejshëm në trajnim, infrastrukture, kujdes shëndetësor mendor të komunitetit dhe bashkëpunimit ndër-ministror.

Në fushën e *monitorimit të kancerit*, janë mbajtur aktivitetet fillestare. Përpjekje të mëtejshme, duke përfshirë një program të kontrollit të kancerit dhe fondeve shtesë, nevojiten para se programet e monitorimit të mund të fillojnë. Është zhvilluar një plan veprimi për vitet 2013-2015 që adreson çështjen e *sëmundjeve të rralla*.

Në përgjithësi, sektori shëndetësor nuk është konsideruar si një prioritet. Shpenzimet publike në shëndetësi mbetet me të ulëta në rajon dhe alokimet janë menaxhuar në mënyrë joefikase. Shpenzimet nga xhepi janë të larta (40-60%). Kjo vazhdon të pengojë përmirësimin e nevojave themelore për shëndetin e nënës dhe fëmijës, ushqyeshmerisë dhe shëndetit publik. Nevojiten investime të mëtejshme në sektorin shëndetësor (infrastrukture, cilësi dhe ofrim) për të siguruar qasje në shërbimet shëndetësore për të gjithë qytetarët. Parimet e llogaridhënies dhe ndarjes së përgjegjësisë, si dhe procesi i hartimit, shqyrtimit, zbatimit dhe forcimit të legjislacionit dhe ndarjes buxhetore duhet të përforcohen. Reformat e planifikuara duhet të miratohen dhe zbatohen.

Në përgjithësi, Kosova përballlet me sfida të mëdha në këto fusha. Fokusi duhet të jetë në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit, synim më i mirë në përdorimin e burimeve të kufizuara financiar të alokuara për këto fusha duhet të jetë më efikas. Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë për të përmirësuar perspektiven e punësimit, sidomos për të rinjtë.

4.1.9. Arsimi dhe hulumtimi

Qeveria miratoi ligjin mbi **arsimin** e të rriturve në dhjetor dhe e rishikoi ligjin mbi arsimin dhe aftësimin profesional në shkurt. Ligji mbi arsimin e lartë u plotësua me njëmbëdhjetë udhëzime administrative të finalizuara në vitin 2012. Në shkurt, në kontekst të shqyrtimit të dytë të përbashkët vjetor për arsim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e sajoi një raport progresi sektorial dhe një *aide memoire* për përcaktimin e prioriteteve të politikave për vitet 2013-2014.

Shpenzimet e qeverisë për arsimin u rritën pak deri në 4.1 % të BPV-së, kryesisht për shkak të rritjes së pagave të mësimdhënësve, ndërsa shpenzimet për nxënës mbeten të ulëta. Në fund të vitit 2012, ministria ka finalizuar Kurrikulumin themelor të Kosovës. Dhjetë shkolla janë të përfshirë në një pilot të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës dhe Kurrikulumit themelor. Në arsimin e lartë u miratua një vendim ministror mbi reformën e cilësisë së programeve të trajnimit të mësimdhënësve të Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës ka përgatitur një koncept se si aplikohen këto reforma gjatë pesë viteve të ardhshme. Një universitet i ri publik u hap në Pejë. Zbatimi i marrëveshjes mbi pranimin e diplomave universitare e arritur në dialogun Beograd/Prishtinë, në korrik të vitit 2011, është duke përparuar.

Lidhur me qasjen të barabartë në arsimin cilësor, nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kanë norma më të ulëta të regjistrimit, norma të larta të braktisjes së shkollës, si dhe nivele të dobëta të performancës akademike. E njëjta gjë vlen edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Arsimi parashkollor nuk është i mbështetur në mënyrë adekuate. Gjysma e shkollave të regjistruara punojnë në dy ndërrime; shumë të tjera në tri ndërrime. Shkollave ju mungojnë laboratorët shkencor, objektet sportive dhe mirëmbajtjet adekuate të ndërtesave shkollore. Ministria ndan një buxhet më të madh për qendrat e kompetencës së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP) se sa shkollave të tjera të AAP-së, të cilat marrin burime të pamjaftueshme. Në arsimin e lartë, nevojiten përpjekje më të mëdha për të rritur cilësinë e programeve universitare dhe pas-universitare, dhe për të siguruar që programet e arsimit janë më të përshtatshme për nevojat e tregut të punës. Disponueshmëria e të dhënave mbetet një sfidë.

Sa i përket **hulumtimit dhe inovacionit**, ligji për veprimtari kërkimore-shkencore u rishikua dhe u miratua në mars. Ligji parashikon një rritje të financimit të kërkimit kombëtar në 0.7% të buxhetit vjetor. Kosova ka ndërmarrë disa hapa për forcimin e kapaciteteve. Kosova ka vazhduar të kërkojë mundësi të bashkëpunimit në kuadër të programit të shtatë të Kornizës Evropiane të hulumtimit dhe me rrjetet e tjera të BE-së. Megjithatë, niveli i pjesëmarrjes së Kosovës në kornizë e programit për hulumtime ka stagnuar në krahasim me vitin 2012. Burimet financiare, kapaciteti administrativ dhe angazhimi janë ende tepër të dobëta që të bashkëpunojnë me sukses në hulumtim dhe inovacion brenda BE-së. Duhet të bëhet më shumë për të stimuluar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve private në hulumtim, zhvillimin apo veprimtari të inovacionit.

Në përgjithësi, zhvillimi i cilësisë dhe sigurimi i cilësisë mbetet një sfidë në tërë sektorin e arsimit. Kapaciteti në nivel komunal duhet të forcohet. Bashkëpunim më i ngushtë me sektorin privat do të ndihmojë për të përmirësuar përshtatshmërinë dhe cilësinë e programeve të trajnimit dhe aktiviteteve hulumtuese. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së arsimit për grupet e marginalizuara, veçanërisht për fëmijët e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, dhe atyre me aftësi të kufizuara. Në hulumtim dhe inovacion, kanë ndodhur disa zhvillime inkurajuese. Nevojiten më shumë përpjekje për të forcuar kapacitetet e hulumtimit dhe inovacionit të Kosovës dhe për të lehtësuar integrimin e Kosovës në Zonën Evropiane të Hulumtimit.

4.1.10. Çështjet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT)

Kosova nuk është anëtare e OBT-së dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap formal për anëtarësim në OBT.

4.2 Politikat sektoriale

4.2.1. Industria dhe NVM-të

Sa i përket **politikës industriale** dhe **NMV-ve**, Kosova ka vazhduar thjeshtësimin e legjislacionit të saj. Në shkurt, Kuvendi miratoi ligjin për zonat ekonomike. Ligji përcakton rolin e qeverisë dhe komunave në krijimin e zonave të lira ekonomike, duke iu referuar në veçanti zonave të lira, parqeve industriale, parqeve teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit. Në mars, qeveria miratoi një strategji për zhvillimin e sektorit privat 2013 - 2017 me qëllim të zhvillimit të sektorit privat konkurrues. Për këtë qëllim, strategjia identifikon sektorët strategjikë industriale dhe prioritet për përafrimin me rregullat e BE- së në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave dhe të tregtisë.

Kosova po e zbaton Aktin për biznes të vogël. Tarifat e regjistrimit të kompanisë janë të pakushtueshme dhe certifikatat e regjistrimit të kompanisë lëshohen brenda disa ditësh. Kosova ka eliminuar tarifat e regjistrimit të biznesit dhe kërkesat minimale të kapitalit për kompanitë me përgjegjësi të kufizuar. Kërkesat minimale të kapitalit për shoqëritë aksionare janë reduktuar nga 25000€ në 10000€ dhe procesi i regjistrimit të biznesit është bërë më i efektshëm. Kostot e pajtueshmërisë mbeten mjaft të larta. Mbrojtja për investitorët është rritur me aplikimin e kërkesës për miratim nga aksionari i transaksioneve të palës përkatëse.

Takimet e rregullta të grupeve që kanë të bëjnë me politikën tregtare kanë kontribuar për koordinim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet agjencive për zhvillimin e NVM-ve, promovimit të investimeve dhe odës ekonomike. Akterët e tjerë të tillë si komuniteti i gjerë i biznesit duhet të përfshihen më shumë në përcaktimin e politikave.

Ekziston Legjislacioni i falimentimit. Ai nuk është sistematik dhe zbatimi i tij është në një fazë të hershme.

Mjedisi i biznesit në Kosovë mbetet sfidues. Qasja në financa konsiderohet si një nga pengesat kryesore që pengojnë zhvillimin e NVM-ve. Zbatimi i dobët ligjor i kontratave dhe rregullave të biznesit pengojnë rritjen e mëtejshme. Regjistrimi i kompanisë përmes internetit është i mundur vetëm në 28 'zyra pritëse' ose qendrat komunale të biznesit. Në rastet tjera, kompanitë duhet t'u përmbahen procedurave njoftuese dhe të marrin licencën komunale për të filluar një biznes.

Në përgjithësi, mjedisi i biznesit është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Megjithatë, mbetet një sfidë, sidomos për NMV-të. Qeveria nevojitet të aplikojë vlerësimin e ndikimit rregullator. Kosova duhet të përqendrohet më shumë në zbatimin e kontratave, reduktimin e rregullave të panevojshme të biznesit dhe krijimin e një mjedisi që lehtëson qasjen në financa. Autoritetet duhet të vazhdojnë zhvillimin e kornizës institucionale për zbatimin e politikave të NVM-ve. Zbatimi i strategjisë së zhvillimit të NVM-ve dhe planit të veprimit duhet të vazhdojë dhe duhet të monitorohet më mirë.

4.2.2. Bujqësia dhe peshkataria

Sa i përket **politikës bujqësore dhe zhvillimit rural**, Kosova ka miratuar dhjetë ligje dhe trembëdhjetë udhëzime administrative për të përmirësuar përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis-in*. Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është rritur për 10% krahasuar me vitin 2012. Qeveria ka vazhduar skemën e saj të pagesave, e cila përbëhet nga pagesat e kombinuara për fermerët në sektorët e drithërave dhe blegtorisë. Kjo u zgjerua në sektorë të rinj, duke përfshirë sektorët e produkteve të qumështit, frutave dhe verës. Janë lansuar projekte specifike të zhvillimit rural për të ndihmuar ristrukturimin e sektorit. Njësia e pagesave e ministrisë u avancua në agjencion për menaxhimin dhe kontrollin e ndihmave. Kosova ka ndërmarrë hapa për të krijuar një fond garantues të rrezikut për të lehtësuar kreditë për fermerët dhe përpunuesit e agro-ushqimit. Është rritur përdorimi i shënimeve nga rrjeti i të dhënave për kontabilitet të fermave.

Për të zbatuar si strategjinë për konsolidimin e tokës 2010-2020 ashtu edhe ligjin, janë lëshuar pesë udhëzime administrative. Skemat e konsolidimit të tokës janë zhvilluar në tri komuna. Ndërtimi i paligjshëm në tokën bujqësore mbetet ende një sfidë. Shërbimet këshillëdhënëse për fermerët nuk janë sistematike dhe pengohen nga mungesa e legjislacionit dytësor. Ligji i vitit të kaluar mbi bujqësinë organike nuk është zbatuar në mungesë të një autoriteti të kontrollit dhe komisionit mbi prodhimin organik. Ka mospërputhje të vazhdueshme në statistika në mes të atyre të EUROSTAT-it, Entit Statistikor të Kosovës dhe ministrisë, mbi tregtinë bujqësore BE-Kosovë .

Në sektorin e pylltarisë, u krijua një bord i menaxhimit të pyjeve. Dy ligje të reja mbi parqet kombëtare kanë ndryshuar kornizën e operimeve për sektorin shtetëror të pylltarisë. Qeveria duhet të marrë vendim mbi modelin institucional të këtij sektori. Niveli i prerjeve të paligjshme mbetet një shqetësim i madh, pavarësisht ligjit të vitit të kaluar që i fuqizoi sanksionet. Mungesa e koordinimit në mes të organeve vë në rrezik përpjekjet e Kosovës për ti luftuar zjarret pyjore.

Sa i përket **sigurisë së ushqimit** dhe kontrollit **veterinar**, janë ndryshuar një numër i ligjeve, (ligji për ushqimin, ligji për veterinarinë, ligji mbi inspeksionin sanitar dhe ligji për blegtorinë). Ato ishin të shoqëruara nga procedurat e zgjeruara të standardeve të operimit dhe udhëzimeve për inspektorë. Megjithatë, implementimi dhe fuqizimi i legjislacionit ka mbetur prapa. Plani vjetor dhe shumëvjeçar i kontrollit për sëmundjet e kafshëve është i pakompletuar dhe i vjetruar.

Ende nuk është finalizuar transferimi i kompetencave të inspektimit nga komunat tek Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinarisë. Disa hapa janë ndërmarrë për të krijuar një sistem të identifikimit, regjistrimit dhe kontrollit të lëvizjes së kafshëve. Në të njëjtën kohë duhet të përmirësohet niveli i raportimit të lëvizjes së kafshëve dhe regjistrimi i tyre në bazën e të dhënave.

Agjencia Kosovare e Ushqimit dhe Veterinarisë duhet të zbatojë masat e saja të kontrollit mbi kontrabandën dhe therjen e paligjshme të kafshëve. Buxheti i agjencisë mbetet i ulët. Pajisja dhe plotësimi me personel i Laboratorit të Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës është përmirësuar, por laboratori ende nuk është akredituar. Gama e shërbimeve testuese që laboratori mund të ofrojë është e kufizuar. Nuk ka asnjë sistem për mbledhjen dhe përpunimin e produkteve dytësore të kafshëve. Vlerësimi i stabilimenteve për përpunimin e produkteve të qumështit dhe mishit, thertoreve dhe depove të ftohta të magazinimit ka përfunduar në vitin 2012. Duhet të krijohet strategjia për të përmirësuar këto stabilimente.

Është ndryshuar ligji për mbrojtjen e bimëve për sa i përket kontrollit **fitosanitar**. Lista e sëmundjeve të bimëve të pranishme në Kosovë nuk është finalizuar. Sa i përket **organizmave të modifikuara gjenetiksht**, puna në ligjin kornizë është pezulluar. Në sektorin e

peshkatarisë, shumica e standardeve evropiane nuk vlejnë për Kosovën, e cila nuk ka peshkim detar.

Në përgjithësi, autoritetet e Kosovës kanë një kornizë të mjaftueshme ligjore për të ushtruar detyrat dhe obligimet e tyre. Ato tani duhet të përqendrohen në zbatim. Përmirësimet në kapacitetin e autoriteteve të veterinarisë dhe fitosanitarisë janë të nevojshme. Sfida kryesore mbetet buxheti i kufizuar i alokuar për kontrollin e sigurisë së ushqimit, veterinarisë dhe fitosanitarisë. Ministria duhet të forcojë kapacitetet administrative pagues të agjencisë për të administruar dhe kontrolluar pagesat e kombinuara dhe skemat e grandeve. Po ashtu duhet të përdor sistemet e pagesave të kombinuara dhe grandet bashkërenduese për të inkurajuar përfituesit që ti përmbahen detyrimeve tjera (siç janë sistemi i kontrollit të identifikimit, regjistrimit dhe lëvizjes së kafshëve, regjistrin e fermës dhe tokës dhe zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit) . Zgjerimi i mbështetjes për nën-sektorët tjerë të bujqësisë dhe zhvillimit rural duhet të vlerësohet më me kujdes për të shmangur shpërndarjen e burimeve të kufizuara të skemave dhe të mbingarkojë kapacitetet administrative tashmë të kufizuara.

4.2.3. Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

Përafrimi i legjislacionit të Kosovës për **mjedisin** ka qenë i kufizuar në miratimin e ligjit mbi ujërat dhe miratimin e një numri të udhëzimeve administrative për mbeturinat dhe ndotjen industriale. Është rekrutuar staf i ri (kryesisht inspektorë të mjedisit) në të dyja nivelet, atë qendror dhe lokal. Megjithatë, mungesa e stafit teknik në të dyja nivelet është ende një sfidë e rëndësishme.

Janë instaluar stacione shtesë për monitorimin e *cilësisë së ajrit* dhe rrjeti tashmë mbulon tërë territorin. Megjithatë, operimi dhe mirëmbajtja e sistemit duhet të përmirësohet dhe duhet të rekrutohet stafi i kualifikuar teknik, veçanërisht në përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Duhet të përpilohet inventari i ndotësve të ajrit dhe ndotja nga burimet kryesore të matet në mënyrë të saktë, sidomos ndotja nga termocentrali Kosova A. Nevojitet përpjekje e konsiderueshme për ti zbatuar standardet e BE-së.

Sa i përket *menaxhimit të mbeturinave*, është miratuar një numër i akteve zbatuese për ti menaxhuar automjetet e vjetërsuara. Kapaciteti në nivel komunal në lidhje me menaxhimin e mbeturinave është ende shumë i ulët, duke përfshirë deponitë, ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave. Zbatimi i standardeve evropiane për menaxhimin e mbeturinave është në një fazë shumë të hershme.

Sa i përket *cilësisë së ujit*, është miratuar një ligj i ri për ujin. Ligji duhet të adaptohet në mënyrë që të jetë në përputhje me Direktivën Kornizë të BE-së për ujin. Janë përcaktuar zonat e rrezikuara dhe të mbrojtura, por legjislacioni zbatues është i pakompletuar dhe monitorimi duhet të përmirësohet dhe zgjerohet për të mbuluar të gjitha burimet e ndotjes. Duhet të rregullohet përdorimi i plehrave kimike dhe ndikimi i tyre në burimet ujore. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm është i zhvilluar dobët dhe një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ende nuk është e kyçur në sistem. Investimi në këtë sektor është i pamjaftueshëm.

Sa i përket *mbrojtjes së natyrës*, janë miratuar ligjet për emërimin e dy parqeve kombëtare ("Bjeshkët e Nemuna" dhe "Sharri"). Megjithatë, deri më tani nuk ka rregulla zbatuese dhe ende nuk ka monitorim të zonave të mbrojtura. Korniza legjislative për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit duhet të rregullohet në përputhje me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Legjislacioni zbatues (identifikimi i zonave dhe specieve të mbrojtura) i ligjit ekzistues për mbrojtjen e natyrës ende nuk është miratuar.

Kosova ka miratuar *udhëzimet për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes industriale*. Gjithashtu janë miratuar një sërë udhëzimesh administrative mbi formën dhe përmbajtjen e aplikacionit të lejes së integruar dhe mbi procedurat për zhvillimin dhe miratimin e teknikave më të mira të mundshme.

Lidhur me *kemikalet*, Kosova ka miratuar një udhëzim administrativ për vlerësimin e rrezikut. Nuk ka zhvillime për të raportuar mbi *zhurmën, mbrojtjen civile dhe legjislacionin horizontal*.

Kosova nuk e ka një politikë gjithëpërfshirëse dhe as strategji për **klimën**, dhe nuk ka zhvillime për të raportuar në lidhje me përafrimin me *acquis-in* mbi klimës. Janë identifikuar gjashtë instalime stacionare me qëllim të zbatimit të ardhshëm të një sistemi të tregtimit të emetimeve dhe është përgatitur një inventar i gazrave serrë (2008-2009).

Kosova duhet të ndërmarrë hapa konkretë për përafrim dhe zbatimin e *acquis-it* të BE- për klimën, duke filluar nga legjislacioni i mekanizmit monitorues. Në përputhje me Dokumentin e Gjelbër të BE-së mbi ' Një kornizë të vitit 2030 mbi politikat klimatike dhe ato të energjisë'. Kosova është ftuar të fillojë reflektimin mbi kornizën e saj të klimës dhe energjisë për vitin 2030. Duhet të vendoset bashkëpunimi ndër-institucional mes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Transportit për të mundësuar zvogëlimin e emetimit të karbonit. Kosova ka marrë pjesë aktivisht në punën mbi klimën në kuadër të Rrjetit Rajonal Mjedisor për Anëtarësim. Duhet të bëhen përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet dhe për të promovuar bashkëpunim midis të gjitha palëve relevante të interesit.

Kapaciteti administrativ në sektorët e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike mbetet i dobët. Bashkëpunimi ndër-institucional është i brishtë dhe i paqëndrueshëm. Duhet të përmirësohet cilësia e raportimit për mjedisin. Nuk ka asnjë mekanizëm financiar për të mbështetur investimet në projektet mjedisore. Investimet kapitale, në veçanti për sistemet e kanalizimit, impiante të trajtimit të ujërave të zeza dhe trajtimin e mbeturinave dhe sistemet e deponimit të mbeturinave mbeten jashtë planeve të shpenzimeve të qeverisë.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë ende në një fazë të hershme. Korniza ligjore dhe institucionale për të zbatuar standardet e BE-së ekziston pjesërisht. Kapaciteti për të realizuar dhe zbatuar legjislacionin në nivel qendror dhe lokal duhet të fuqizohet. Buxheti i alokuar për sektorin është i pamjaftueshëm. Standardet mjedisore dhe klimatike nuk janë kanalizuar në politikat e tjera, veçanërisht në energji, transport, bujqësi dhe industri. Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme njerëzore, administrative dhe kapitale për ti zbatuar standardet mjedisore klimatike të BE-së. Sektori i energjisë është burimi kryesor i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. Nevojiten investime të mëdha për ti kyçur qytetarët e Kosovës në rrjetet e ujit të pijshëm dhe të ujërave të zeza. Ka mungesë të kapacitetit për të përpunuar mbeturinat. Kosova duhet të miratojë strategjinë e saj mjedisore, për të krijuar një strategji të klimës dhe një sistem për monitorimin dhe raportimin e gazrave serrë, si dhe të përfundoj inventarin e saj të gazrave serrë.

4.2.4. Politikat e transportit

Sa i përket **rrjeteve trans-evropiane të transportit**, Kosova ka vazhduar të merr pjesë aktivisht në zbatimin e memorandumit të mirëkuptimit të vitit 2004 mbi zhvillimin e Rrjetit Qendror Rajonal të Transportit të Evropës Juglindore dhe Mbikëqyrja e Transportit të Evropës Juglindore. Ndërtimi i segmentit Morinë-Merdare e Korridorit 7 është në vazhdim e sipër. Tenderi për autostradën Prishtinë-Shkup (Korridori 6) është në proces e sipër. Financimi për segmentin e fundit të Korridorit 7 (i cili lidhet me Merdaren) ende nuk është siguruar.

Buxheti për mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve kombëtare u rrit për 15% në vitin 2013, por është ende i pamjaftueshëm. Strategjia aktuale e transportit, me një theks të madh në ndërtimin e rrugëve të reja, vetëm rrit mosbalancimin në sektorin e transportit, në favor të formës më pak miqësore ndaj mjedisit dhe lë jashtë investimet për format tjera të transportit, veçanërisht hekurudhat. Ende nuk është miratuar Strategjia e rishikuar e transportit shumë-modal (2012-2021) dhe plani i veprimit (2012-2016).

Sa i përket **transportit rrugor**, ligji mbi transportin rrugor është miratuar në muajin maj dhe ligji mbi transportin e mallrave të rrezikshme është miratuar në muajin mars. Ligji mbi transportin rrugor parasheh përafrimin me legjislacionin mbi orët e vozitjes, si dhe përdorimin e takografëve digjital. Strategjia e sigurisë rrugore dhe plani i veprimit nuk janë miratuar ende për shkak të kostos së tyre. Ligji mbi sigurinë rrugore duhet të përafrohet me *acquis-in*. Shkalla e aksidenteve të trafikut mbetet i lartë veçanërisht për sa i përket fataliteteve të fëmijëve dhe këmbësorëve. Aftësitë e kufizuara të inspektimit, automjetet e vjetërsuara dhe cilësia e ulët e infrastrukturës rrugore përtej rrugëve kryesore pengojnë zbatimin e këtij legjislacionit.

Në **transportin hekurudhor**, ndarja e menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore (Infrakos) dhe operatorit hekurudhor (Trainkos) ka përfunduar. Të dyja subjektet janë të licencuara dhe të certifikuara për sigurinë nga ana e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Është miratuar deklarata e rjetit dhe skema e ngarkesës së infrastrukturës së vitit 2013. Ka përfunduar regjistri kombëtar i automjeteve dhe regjistri i infrastrukturës. Autoriteti hekurudhor tani është funksional, por i mungon kapaciteti. Buxheti i tij është i pamjaftueshëm për t'i kryer detyrat e veta në mënyrë efektive pasi infrastruktura hekurudhore ashtu edhe operacionet e pasagjerëve janë financuar vetëm në bazë të kontratave të shërbimit. Infrakosi nuk mund të caktoj tarifat vetanake të përdoruesit, siç kërkohet nga *acquis-i* i BE-së. Duhet të aranzhohet funksioni i sigurisë hekurudhore dhe hetimi i aksidenteve. Hekurudhat e Kosovës vazhdojnë të jenë të prekura nga një mungesë serioze e burimeve njerëzore dhe financiare.

Në **transportin ajror**, implementimi i fazës së parë të kërkesave të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit në legjislacionin kombëtar është përfunduar. Inspektorët e aviacionit civil tashmë kanë marrë pjesë në programet ndërkombëtare të trajnimit dhe kanë marrë certifikata ndërkombëtare. Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ende nuk është pjesë e programit të Vlerësimit të Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore (SAFA). Megjithatë, autoriteti ka miratuar një rregullore të SAFA-së mbi inspektimet e devijimeve të avionëve të vendeve të treta dhe merr pjesë në mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit. Ligji mbi Agjencionin për Shërbimet e Navigacionit Ajror nuk është miratuar ende. Mungesa e vazhdueshme e certifikimit të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror është një çështje shqetësuese. Sektori i aviacionit në Kosovë vazhdon të vuaj për shkak të kufizimeve të fluturimeve të imponuara nga Serbia për fluturimet që vijnë dhe shkojnë nga Prishtina, Kontrolli i hapësirës ajrore të Kosovës është në proces për t'iu caktuar kompanisë Hungarocontrol.

Në përgjithësi, përafrimi me *acquis-in* e BE-së për transportin ka vazhduar. Kosova ka bërë progres në sektorët e hekurudhës dhe aviacionit. Kosova (duke përfshirë dhe operatorët e saj të transportit) nuk mund t'i bashkangjitet shumë prej organeve ndërkombëtare ose evropiane që rregullojnë transportin apo asociacioneve relevante sektoriale. Institucionet rregullatore duhet të fuqizohen më tej. Nevojiten përpjekjet e mëtejshme për të përmirësuar sigurinë rrugore dhe për të rritur investimet në sektorin hekurudhor. Miratimi i Ligjit mbi Agjencionin për Shërbimet e Navigacionit Ajror është një prioritet urgjent.

4.2.5. Energjia

Sektori i energjisë vazhdon të përballet me sfida edhe pse ndërprerjet e energjisë tani janë më pak të shpeshta. Shpërndarja e energjisë elektrike vuan nga humbjet e mëdha teknike, dhe investimet në efikasitetin e energjisë dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë janë të pamjaftueshme për të përmbushur qëllimet e Kosovës për vitin 2020.

Sa i përket **sigurisë së furnizimit**, Kosova nuk ka filluar përgatitjen për të zbatuar *acquis-in* mbi rezervat e detyrueshme të naftës. Rezervat aktuale janë vlerësuar në një nivel prej katër ditëve të konsumit. Investimet dhe mirëmbajtja kanë përmirësuar besueshmërinë në sistemin e transmissioinit të energjisë.

Në shtator të vitit 2013, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje mbi energjinë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Marrëveshja përcakton mënyrën për të zgjidhur mosmarrëveshjen e gjatë midis dy palëve përkitazi me ankesën e operatorit të sistemit transmisionin të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) kundrejt homologut të tij serb për shkelje të mekanizmave të aplikueshëm rajonalë në të cilën Sekretariati i Komunitetit të Energjisë gjeti kundër Serbisë. Marrëveshja parashikon që KOSTT-i dhe homologu i tij serb 'Elektromreža Srbije' të nënshkruajnë një marrëveshje funksionale brenda tre muajve nga arritja e marrëveshjes. Marrëveshja gjithashtu parashikon që kompania furnizuese serbe me energji elektrike do të veprojë ligjërisht në veri të Kosovës.

Për sa i përket **tregut të brendshëm të energjisë**, u rishikua tenderi për ndërtimin e një termocentrali të ri me bazë linjitin për të larguar termocentralin ekzistues Kosova B. Procedura po pëson vonesa të konsiderueshme dhe nuk ka gjasa të përfundohet brenda kornizës kohore të planifikuar. Në dhjetor, qeveria ri-lansoi aktivitetet e tri grupeve punuese për të përgatitur dekomisionimin e Kosovës A. Megjithatë, nuk ka pasur asnjë progres operacional në avancimin e procesit. Kosova nuk e ka parashtruar udhërrëfyesin për implementimin e direktivës për centralet me djegie të lartë tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Qeveria ka finalizuar privatizimin e shpërndarjes dhe funksionet e furnizimit të energjisë elektrike në maj. Afati ligjor për ndarjen e funksionit të shpërndarjes dhe furnizimit nuk është arritur. Të gjithë konsumatorët që nuk janë ekonomi familjare tani kanë të drejtë të blejnë energji nga furnizuesit sipas përzgjedhjes së tyre. Ata vazhdojnë të furnizohen me tarifa të rregulluara pas një vendimi nga ana e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë se tregu nuk është mjaft konkurrues.

Performanca e korporatës në faturim dhe inkasim është përmirësuar, por proporcioni në mes të furnizimit të energjisë elektrike dhe pagesës mbetet i ulët: humbjet (teknike dhe jo-teknike) të të gjithë energjisë në dispozicion për shitje konsiderohen në rreth 34 %. Niveli i inkasimit është përmirësuar për 91% të të gjithë energjisë së faturuar. Megjithatë, punonjësit e Korporatës janë të ekspozuar rregullisht ndaj dhunës dhe sulmeve fizike gjatë kryerjes së detyrave të tyre në terren.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë ka përfunduar rishikimin e tarifave të energjisë për 2013-2017, dhe ka mbajtur tarifat ekzistuese të energjisë elektrike për vitin 2013. Vendimi, i marrë pas ndërhyrjes së qeverisë, ka minuar pavarësinë e kësaj zyre . Qeveria duhet të hartojë një mekanizëm financiar për të marrë në fokus konsumatorët e rrezikuar që nuk mund të përballojnë rritjet e çmimeve të energjisë elektrike. Janë ndërmarrë hapa për eliminimin e subvencioneve të tërthorta në mes të kategorive të konsumatorëve.

Sa i përket **energjisë së ripërtëritshme**, në janar, qeveria miratoi objektivat e saj kombëtare të energjisë së ripërtëritshme për vitin 2013-2020, duke e parashtruar objektivin në 29.4 % të hises së energjisë nga burimet e ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto deri në vitin 2020. Ky është objektiv edhe më i lartë se ai i detyrueshmi prej 25 % i cili rrjedh nga obligimi i Komunitetit të Energjisë së energjisë së ripërtëritshme për vitin 2020. Plani i veprimit i energjisë së ripërtëritshme akoma duhet të miratohet nga Ministria e Financave. Zyra e Rregullatorit në dhjetor ka licencuar një kapacitet të vogël prej 67 MW të hidrocentraleve dhe 30 MW të kapacitetit të erës. Për të arritur objektivat janë të nevojshme masat e mëtejshme mbështetëse (procedurat mbarëvajtëse administrative dhe skemat financiare).

Ligji mbi **efiçencën e energjisë** është miratuar. Fondi i efiçencës së energjisë nuk është themeluar ende. Plani afatmesëm kombëtar i efiçencës së energjisë 2013-2015 ende duhet të miratohet nga Ministria e Financave. Legjislacionit zbatues që promovon efiçencën e energjisë nga përdoruesit e fundit u miratua në nëntor. Është miratuar gjithashtu legjislacioni i ri që përputhet me direktivën kornizë mbi emërtimin e energjisë. Zbatimi i projektit të kombinuar të ngrohjes dhe energjisë (bashkë-gjenerim) në termocentralin Kosova B ka filluar në tetor. Mungesa e statistikave të efiçencës së energjisë është pengesa kryesore në raportimin mbi

kursimet e energjisë. Planifikimi i efijencës së energjisë në nivelin lokal/komunal është përmirësuar paksa. Megjithatë, kapaciteti lokal mbetet i dobët.

Në **sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi**, Kosova është duke miratuar ligjin e saj kornizë për t'u përgatitur për të zbatuar *acquis-in* e BE-së për sigurinë bërthamore dhe mbrojtjes nga rrezatimi. Agjencia për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore ka nevojë për të rritur kapacitetin e saj për masat rregullatore dhe për të rekrutuar më shumë personel. Magazinimi i mbetjeve radioaktive duhet të jetësohet. Nuk ka asnjë organizatë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve radioaktive.

Në përgjithësi, Kosova ka nevojë të fillojë përfarimin me *acquis-in* mbi sigurinë e furnizimit. Ajo duhet të vazhdojë përafrimin e saj dhe zbatimin e *acquis-it* përkitazi me energjinë elektrike, naftën dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi. Përpjekjet për dekomisionimin e Kosovës A duhet të përshpejtohen. Kosova ka nevojë për të forcuar kapacitetet e saj institucionale në fushën e rregullimit të tregut të energjisë dhe sigurinë bërthamore, në veçanti ruajtjen e pavarësisë së Rregullatorit të Energjisë dhe krijimin e mekanizmave transparentë për të caktuar çmimet e energjisë. Marrëveshja mbi energjinë e arritur me Serbinë ofron një mundësi unike për të zgjidhur një sërë çështjesh energjetike të Kosovës. Kosova duhet të zbatojë pjesën e saj të marrëveshjes.

4.2.6. Shoqëria informative dhe mediat

Sa i përket **komunikimeve elektronike dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit** (TIK), ligji mbi komunikimet elektronike u miratua në tetor të vitit 2012, duke synuar transpozimin e kornizës rregullatore të BE-së të vitit 2009. Qeveria miratoi një vendim për liberalizim të mëtejshëm të tregut mobil duke i bërë valët 900 dhe 1 800 MHz me teknologji neutrale, e cila mundëson vendosjen e shërbimeve të reja wireles (pa tela) të brezit të valëve të gjata. Qeveria është në procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të titullarit të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Rregullatori i telekomit ka bërë progres në zbatimin e masave mbrojtëse konkurruese, siç janë zgjedhja e operatorit. Në mars, qeveria miratoi Agjendën digjitale për Kosovën 2020, një dokument i politikave që mbulon komunikimin elektronik dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Norma e depërtimit të transmetuesit fiks për popullatën mbetet e ulët në vetëm 8% sipas të dhënave më të fundit që janë në dispozicion.

Çështjet që lidhen me statusin e Kosovës pengojnë aftësinë e saj për të zbatuar plotësisht *acquis-in*. Kosova nuk ka emër të domenit të internetit. Kosova nuk është anëtare e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU), dhe për këtë arsye ka shpërndarje të pamjaftueshme të frekuencave, përfshirë edhe kalimin digjital.

Kosova nuk e ka kodin e vet të vendit dhe vazhdon të përdorë tri kode të vendeve të ndryshme për telefoninë fikse dhe mobile. Kjo krijon kosto shtesë, zvogëlon kontrollin e Kosovës mbi sistemin e saj dhe është pengesë, p.sh. për të zbatuar rregullat e BE-së për numrin portativ. Megjithatë, në shtator, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje mbi telekomin në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Marrëveshja parashikon që Kosovës t'i alokohet një kod 3-shifror nga ITU-ja që nga viti 2015. Marrëveshja gjithashtu i ofron 'Telekom Srbija'-së të veprojë ligjërish në Kosovë deri në vitin 2015.

Në **shërbimet e shoqërisë së informacionit**, dokumenti i Agjendës Digjitale të Kosovës përshkruan prioritetet dhe objektivat kryesore të politikës së shoqërisë së informacionit kombëtarë, duke u përafruar me strategjinë e Agjendës Digjitale të Evropës. Një ligj i ri mbi e-qeverisjen ka hyrë në fuqi në muajin maj. Ligji i vitit të kaluar mbi shërbimet e shoqërisë së informacionit synon të lehtësojë përdorimin e transaksioneve elektronike, pagesave dhe e-nënshkrimeve. Ligji i prillit mbi organet qeveritare për shoqërinë e informacionit ka themeluar Agjencionin për Shoqërinë e Informacionit në Ministrinë e Administratës Publike. Në përgjithësi, kapacitetet administrativ në këtë fushë mbetet i dobët. Bashkëpunimi efektiv

ndërmjet organeve përkatëse qeveritare duhet të forcohet. Nuk ka plane konkrete për të filluar mbledhjen e statistikave të shoqërisë së informacionit.

Në **politikën audio-vizuale**, Komisioni i Pavarur për Media nuk detyrohet me ligj që të realizoj kërkesat për operatorët kabllorë. Shumica e operatorëve kabllorë mbajnë stacione televizive me shtrirje në mbarë Kosovën dhe stacione televizive lokale në bazë të një tarife (dhe i heqin ato nga pakoja e tyre në rast të vonesës në pagesa). Kjo seriozisht e kufizon të drejtën e publikut për qasje në kanalet e lira tokësore. Strategjia e kalimit digjital e përgatitur nga Komisioni nuk është e përafuar me *acquis*-in dhe nuk ka ofruar një kornizë të mjaftueshme teknike dhe financiare për një proces transparent dhe të hapur. Ajo i është kthyer Komisionit për kompletim. Puna e Komisionit është penguar seriozisht nga ndërhyrjet politike përkitazi me emërimet për bordin e tij dhe organin e tij të për ankesa, si dhe përpjekja e gjatë dhe e paligjshme për të shkarkuar kryeshefin e ekzekutivit të tij (*shih kriteret politike 2.2 - Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve*).

Transmetuesi i shërbimit publik, Radio dhe Televizioni i Kosovës (RTK) mbetet i varur në financimin nga buxheti i Kosovës. Kuvendi ende nuk ka siguruar financimin e qëndrueshëm të RTK-së. Një vit pas miratimit të ligjit, bordi i RTK-së ende nuk është i plotë (ku tre nga njëmbëdhjetë anëtarët mungojnë). Zgjedhja e shumicës së bordit të RTK-së u zbeh nga ndërhyrjet politike, siç ishin emërimet në menaxhmentin e tij. Kanali i dytë i RTK-së (në gjuhën serbe) është plotësisht funksional që nga gushti, edhe pse ai është aktualisht në dispozicion vetëm përmes operatorëve kabllorë. Fondi për Mediet e Pakicave nuk ka shpërndarë asnjë financim që nga viti 2012. Fondi ka humbur financimin e tij të rregullt kur tarifa e abonimit të RTK-së u pezullua në vitin 2009.

Në përgjithësi, Kosova ka nevojë të vazhdojë përpjekjet për plotësimin e kornizës ligjore në këtë fushë. Organet rregullatore duhet të forcohen. Pavarësia dhe kapaciteti i rregullatorit të telekomit dhe rregullatorit të mediave është sfiduar nga ndërhyrjet politike, rrogat e ulëta dhe mungesa e burimeve. Si çështje urgjente, Kosova duhet të sigurojë zbatimin efikas të kalimit digjital dhe të përgatisë një zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit të shërbimit publik. Përveç kësaj, Komisioni i Pavarur për Media duhet mbrojtë pavarësinë e tij nga ndërhyrja politike, por edhe të demonstrojë se mund të kryejë detyrat e veta. Marrëveshja e arritur me Serbinë për telekomin ofron një mundësi unike për të zgjidhur një sërë çështjesh të telekomit të Kosovës. Kosova duhet të zbatojë pjesën e saj të marrëveshjes.

4.2.7. Kontrolli Financiar

Për sa i përket **kontrollit të brendshëm financiar publik**, legjislacioni zbatues mbi certifikimin e auditorëve të brendshëm në sektorin publik u miratua në janar. Ai përfshin kërkesa të përgjithshme të kualifikimit, por nuk bën asnjë referencë në një kurrikullum të veçantë të trajnimit ose në një provim për certifikim. Numri i njësive funksionale të auditimit të brendshëm në sektorin publik është rritur në mbi 65, me mbi 130 auditorë të brendshëm në total. Megjithatë, shumica e njësive të auditimit të brendshëm janë të plotësuara me vetëm një ose dy auditorë dhe prandaj janë shumë të vogla që të jenë efektive. Janë themeluar në total 48 komisione të auditimit.

Kuptimi i konceptit të përgjegjësisë menaxheriale për kontroll të brendshëm është i ulët. Korniza ligjore është aplikuar vetëm pjesërisht në shumicën e organizatave buxhetore. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është përfshirë kryesisht në zhvillimin e procedurave për organizatat buxhetore dhe në përgatitjen e raportit vjetor. Për shkak të pozicionit të saj aktual dhe deklaratës së misionit, njësia ka kapacitet të kufizuar për të drejtuar menaxhimin financiar dhe reformën e kontrollit. Pozita dhe plotësimi me personel i njësive duhet të jetë në nivel të njëjtë me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e

Brendshëm për të avancuar reformën e kontrollit të brendshëm financiar publik.

Për **auditimin e jashtëm**, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është institucion i pavarur që luan rol në luftimin e korrupsionit dhe promovimin e ndryshimeve në financat publike. Zyra tani ka 140 zyrtarë. Në vitin 2012 ishin përgatitur 115 raporte të auditimit. Është theksuar konsolidimi i cilësisë së auditimit financiar dhe përmirësimi i menaxhimit dhe performancës së auditimit. Zbatimi i strategjisë së re të zhvillimit ka filluar në muajin maj e shoqëruar me një plan një vjeçar që skadon në shtator të vitit 2014. Strategjia përqendrohet në qëndrueshmërinë e institucionit dhe arritjen e praktikave më të mira të BE-së.

Në përgjithësi, është krijuar korniza ligjore bazë për kontrollin e brendshëm financiar publik, por nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të zbatuar konceptin e përgjegjësisë së decentralizuar menaxheriale dhe auditimit të brendshëm. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin duhet të ripozicionohet për të avancuar reformat e kontrollit të brendshëm financiar publik. Plotësimi me personel i njësive të auditimit të brendshëm kërkon vëmendje të mëtejshme. Sa i përket auditimit të jashtëm, përpjekjet duhet të vazhdojnë, sidomos në zbatimin e strategjisë së re të zhvillimit.

4.2.8. Statistikat

Për sa i përket **infrastrukturës statistikore**, ristrukturimi i agjencisë statistikore ka filluar, siç parashihet në ligjin mbi statistikat zyrtare. Katër nga pesë zyrtarët e ri të paraparë u rekrutuan në gusht. Menaxhimi i agjencisë statistikore është forcuar përmes aplikimit të treguesve të performancës. Në janar është miratuar plani strategjik 2013-2017 si dhe programi vjetor i punës. Kapaciteti administrativ i agjencisë statistikore mbetet i dobët dhe kjo pengon prodhimin e produkteve thelbësore statistikore.

Për sa i përket **klasifikimeve dhe regjistrave**, aplikimi i klasifikimit evropian të aktiviteteve ekonomike NACE Rev. 2. në regjistrin e biznesit ka filluar. Regjistri i biznesit është funksional, por puna rutinore e mbajtjes së regjistrit duhet të përmirësohet. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për zbatimin e NACE Rev 2.

Për sa i përket **statistikave sektoriale**, është miratuar ligji mbi regjistrimin e bujqësisë në dhjetor të vitit 2012 dhe regjistrimi pilot i bujqësisë është zbatuar me sukses në nëntor 2012. Përgatitjet për regjistrimin e bujqësisë janë duke përparuar mirë. Rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe ekonomive familjare të mbajtur në vitin 2011 u botuan me sukses.

Në statistikat e tjera sektoriale, ka pasur rezultate të kufizuara. Statistikat makroekonomike të Ministrisë së Financave janë përgatitur në kohën e duhur, por nevojiten përmirësime të rëndësishme në fushën e statistikave ekonomike, sidomos në llogaritë kombëtare dhe statistikat e biznesit.

Bashkëpunimi në mes të agjencisë statistikore dhe të institucioneve të tjera është përmirësuar. Megjithatë, shumë të dhëna nuk janë ende në dispozicion në mënyrë elektronike. Nevojitet bashkëpunim më i mirë në mes të institucioneve të grumbullimit të të dhënave për të siguruar se nevojat e veçanta janë të integruara në sistemin e mbledhjes së të dhënave, dhe se përdorimi i klasifikimeve dhe nomenklaturave siguron qëndrueshmëri. Kapaciteti administrativ i agjencisë mbetet i dobët dhe pengon prodhimin e produkteve bazike statistikore.

Në përgjithësi, Kosova ka bërë përpjekje për t'u përgatitur për regjistrimin e bujqësisë dhe për të përmirësuar infrastrukturën statistikore. Për shkak të burimeve të kufizuara të agjencisë statistikore, ka pasur rezultate modeste në fusha të tjera. Kapaciteti administrativ i agjencisë statistikore duhet të forcohet për të përmbushur rolin e saj si ofrues i të dhënave për vendime të bazuara në prova dhe bërjen e politikave strategjike. Për shkak të burimeve të kufizuara,

agjencia vazhdon të përballet me sfida në prodhimin me kohë të statistikave të besueshme dhe në përputhje me standardet evropiane dhe metodat ndërkombëtare. Për të forcuar kapacitetin e menaxhimit të agjencisë, është e rëndësishme të garantohet vazhdimësia e menaxhmentit të lartë të agjencisë në një afat të gjatë. Rekrutimet dhe emërimet afat-shkurtra duhet të bazohen në kompetencat profesionale.

4.3. Drejtësia, liria dhe siguria

4.3.1. Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migrimi

Regjimi i ri i vizave të Kosovës ka hyrë në fuqi në korrik. Regjimi i ri krijon një listë të përbashkët të shteteve qytetarët e të cilave duhet të kenë një vizë ose janë të përjashtuar nga kërkesat për vizë, kur të hyjnë në Kosovë. Vizat lëshohen nga konsullatat. Vetëm kur ka përjashtime nga regjimi dhe varësisht nga kushtet vizat mund të lëshohen në kufi/pikat e kalimit kufitar. Nuk ekziston marrëveshje dypalëshe sezonale për heqjen e vizave me vendet e treta. Legjislacioni i ri zbatues është nxjerr në lidhje me procedurën e aplikimit për pasaporta. Ai kërkon nga autoritet që të marrin shenjat e gishtërinjve nga fëmijët mbi moshën 12 vjeçare, në përputhje me *acquis*-in.

Që nga korriku ka diku rreth 1.470.000 ID të Kosovës të vlefshme, mbi 772 000 pasaporta të Kosovës të vlefshme (pa çip) dhe mbi 270 000 pasaporta të Kosovës të vlefshme biometrike (me çip). Kontrata e re për prodhimin e pasaportave biometrike (me çip) u nënshkrua në prill. Kontrata për ID kartat biometrike u nënshkrua në gusht.

Duhet të hartohen rregulloret zbatuese, siç janë rregullorja e punës përkitazi me vizat e lëshuara në kufi/pika të kalimit kufitar. Hetimi i dyshimeve për korrupsion përkitazi me kontraktimin e prodhimit të pasaportave biometrike (zhdukja prej 1.4 milion eurove nga Ministria e Punëve të Brendshme në tetor 2012) është në vazhdim e sipër.

Ka vazhduar dialogu për liberalizimin e vizave i lansuar në janar të vitit 2012. Në shkurt, Komisioni ka lëshuar raportin e parë me fokus në legjislacion. Pas rekomandimeve nga ana e Komisionit, Kosova ka ndryshuar gjashtë ligje dhe ka miratuar dy ligje të reja. Falsifikimi i dokumenteve dhe migracioni i parregullt në shtetet e caktuara anëtare të BE-së është rritur ndjeshëm në vitin 2013. Kosova është e inkurajuar që të miratojë dhe të zbatojë reformat e nevojshme, duke përfshirë këto dy fusha.

Janë miratuar në total dhjetë pjesë të legjislacionit zbatues për ligjin mbi **gjendjen civile** të vitit 2011. Një sistem i ri i gjendjes civile është lansuar në shkurt. Ai aplikon një bazë të të dhënave qendrore për të dhënat e gjendjes civile, shkrirjen e të dhënave elektronike nga regjistri i mëparshëm civil dhe nga baza e të dhënave e gjendjes civile. Regjistrimi i ngjarjeve të gjendjes civile tani është i lidhur me qytetarët individualë me PIN-in si një identifikues unik personal. Certifikatat do të lëshohen duke përdorur të dhënat e gjendjes civile nga baza qendrore e të dhënave. Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës janë në proces të kyçin çdo individ në një adresë zyrtare. Procesi dorëzimit nga EULEX -i i kopjeve të certifikuar të librave të regjistrimit civil që gjenden në Serbi, është në vazhdim e sipër dhe mbi 6300 libra janë certifikuar deri në fund të korrikut. Kopjet mundësojnë verifikimin e të dhënave të gjendjes civile .

Zbatimi uniform i ligjit mbi gjendjen civile dhe sistemi i sapo prezantuar në funksion të regjistrimit të gjendjes civile i japin rritje sfidave të shumta të cilat duhet të adresohen, duke përfshirë edhe vështirësitë me certifikatat e reja. Nevojitet trajnim për zyrtarët komunal si dhe rritjen e mbikëqyrjeve dhe inspektimeve. Duhet të aplikohen më shumë resurse për të kryer ad hok auditime të proceseve për të siguruar që ato janë në përputhje me procedurat dhe udhëzimet. Duhet të forcohet llogaridhënia e niveleve të menaxhimit për të siguruar që

gabimet nuk do të hyjnë në sistem. Përmirësimi i komunikimit dhe koordinimi në mes të nivelit qendror dhe komunal është thelbësor në këtë drejtim. Mungesa e regjistrimit të qëndrueshëm të vdekjeve, sidomos në zonat rurale, mbetet një shqetësim.

Lidhur me **menaxhimin e kufirit**, shumica e strukturave për menaxhimin e integruar të kufirit (MIK) tani janë vendosur. Të tre agjencitë e kufirit të përfshira në menaxhimin e integruar të kufirit (policia kufitare, doganat dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë) bashkëpunojnë nëpërmjet Bordit Ekzekutiv Kombëtar të MIK-ut nën udhëheqjen dhe drejtimin e një koordinatori kombëtar. Në janar u hap zyrtarisht Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit. U miratuan Ligji i ri mbi bashkëpunimin e menaxhimit të integruar të kufirit, strategji e rishikuar dhe një amendament i ligjit për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit. Zbatimi i legjislationit dhe procedurave standarde të veprimit nuk janë miratuar ende. Si pjesë e dialogut për zbatimin e protokollit të MIK-ut, Kosova dhe Serbia ranë dakord për një procedurë për ndihmë të ndërsjellë juridike. Procedura ka hyrë në fuqi në mars dhe po ndihmohet nga EULEX-i.

Sistemi i TI-së i financuar nga BE-ja për menaxhimin e kufijve (SMK) është plotësisht funksional në të gjitha pikat kufitare si dhe në qendrat rajonale dhe qendrore të komandës policore. Qendra e re e kontrollit të përbashkët në Vërmicë, e policisë kufitare të Kosovës dhe Shqipërisë. Janë bashkë-vendosur dhe janë hapur gjashtë pika të kalimit kufitar me Serbinë. EULEX-i mban praninë e tij atje. Liria e lëvizjes ka qenë e zbatuar në të gjitha gjashtë pikat, dhe bashkëpunim nga të dyja anët është pozitiv dhe konstruktiv. Ka patrullime të përbashkët të rregullta dhe të sinkronizuara të policisë kufitare me Shqipërinë, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi.

Qendra për Menaxhimin e Kufirit është e hapur por ende nuk është plotësisht funksional dhe bashkëpunimi ndërmjet agjencive është i dobët. Policia duhet të nënshkruajë një kontratë të mirëmbajtjes së sistemit të TI-së për menaxhimin e kufijve. Demarkacioni i kufirit me Malin e Zi ende duhet të përfundohet.

Ligji mbi **Azilin** u rishikua për të reflektuar më mirë standardet ndërkombëtare dhe *acquisin*. U shpërndanë fletushka informative në nëntë gjuhë janë shpërndarë në pikë kalimet përkatëse, stacionet policore dhe zyrat që merren me të huajt. Qendra për azil ka kapacitetin e duhur dhe përmbush standardet teknike për akomodimin e azil kërkuesve. Ka pasur 41 kërkesa për azil në gjysmën e parë të vitit 2013 (dhe 45 kërkesa në vitin 2012).

Legjislationi zbatues duhet të jetë i përditësuar në përputhje me ligjin e ri për azil. Nuk ekziston baza e të dhënave të besueshme për azil-kërkuesit dhe nuk është funksionale baza e të dhënave për migrimin. Prandaj nuk ekziston asnjë lidhje në mes të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion dhe policisë përgjegjës për ekzaminim fillestar. Kjo hap mundësinë për azilkërkuesit të cilët janë larguar nga Kosova që të kthehen dhe të kërkojnë azil me një identitet të ndryshëm. Krahasimi i shenjave të gishtërinjve për verifikimin e identitetit nuk mund të përpunohen gjatë shqyrtimit fillestar. Gjithashtu ekzistojnë shqetësime në lidhje me mbrojtjen e të dhënave të azilkërkuesve. Kjo është për shkak të mungesës së një baze të dhënash të besueshme dhe zbatimit të gabuar të dispozitave lidhur me autoritet për futjen e të dhënave në bazën e të dhënave.

Mungesa e informatave mbi origjinën e azilkërkuesve të refuzuar dhe mungesa e dokumenteve të identitetit mbeten pengesat kryesore për largimin e azilkërkuesve të pasuksesshme. Ka një mungesë të shërbimeve të përkthimit. Kjo pengon komunikimin me azilkërkuesit gjatë shqyrtimit fillestar të rastit të tyre. Bashkëpunimi në mes të institucioneve të përfshira në politikën e kthimit duhet të përmirësohet në të gjitha nivelet.

Kosova askujt nuk i ka dhënë statusin e refugjatit. Shumica e azilkërkuesve largohen nga

Kosova para se të merret një vendim. Në prill, organi i shkallës së dytë, Komisioni Kombëtar për Refugjatët, për herë të parë ofron mbrojtje shtesë për një azil-kërkues të cilit kërkesa ishte refuzuar në shkallën e parë. Kosova akoma duhet të zhvilloj mbrojtjen e ndjeshme ndaj mekanizmave të hyrjes për të menaxhuar flukset migruese të përziera dhe për të lejuar individë me të vërtetë që kanë nevojë për qasje në procedurat e azilit dhe për mbrojtje ndërkombëtare. Ekziston një mungesë e komunikimit ndërmjet institucioneve të ndryshme dhe mungesa e kapaciteteve dhe trajnimeve. Qendra e Azilit ka nevojë për financim adekuat dhe staf të trajnuar.

Në lidhje me **migracionin**, Kosova ndryshoi ligjin mbi të huajt. Një strategji për migracionin dhe një profil i migrimit pritet të miratohet. Rregullorja e rishikuar për ri-integrimin e personave të riatdhesuar u miratua në gusht. Njëzet e një vende tani janë të mbuluara nga marrëveshjet dypalëshe të ri-pranimit. Mungesa e marrëveshjeve të ri-pranimit me vendet e origjinës ose transitit është një shqetësim kur është fjala për të përcaktuar origjinën e një azilkërkuesi i cili është refuzuar dhe / ose nuk ka dokumente të identifikimit.

Kosova ka ri-pranuar rreth 4200 shtetas në vitin 2012 (mbi 2500 nga Evropa Perëndimore). Deri në korrik të viti 2013, mbi 2000 persona janë riatdhesuar (mbi 1400 në mënyrë të detyruar, rreth 600 vullnetarisht, mbi 730 pjesëtarë të komuniteteve pakicë). Zyra për Ri-integrimi e Ministrisë së Punëve të Brendshme në Aeroport ka vepruar mirë. Fushatat e ndërgjegjësimit që synojnë migracion të parregullt janë organizuar dhe kanë nevojë që të vazhdojnë.

Departamenti i ri për ri-integrim ka mungesë të personelit dhe kapacitetit adekuat . Ekziston një mungesë e koordinimit dhe komunikimit ndërmjet zyrës së aeroportit dhe departamentit të ministrisë për ri-pranim. Jo të gjitha ardhjet janë njoftuar në kohë, duke lënë disa persona të riatdhesuar të paregjistruar pas mbërritjes. Pagat për disa nga stafi në zyrën e ri-integrimit janë paguar nga fondi i ri-integrimit i vitit 2012, një praktikë e cila duhet të ndalohet. Rasti i sistemit të menaxhimit të ri-integrimit është hartuar dhe prezantuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, por nuk është akoma plotësisht funksional. Harmonizimi i legjislacionit zbatues me ligjin e rishikuar për të huajt mbetet i pazgjidhur.

Kosova ka nevojë që të ketë më shumë vëmendje për sfidat me të cilat përballen personat e ri-pranuar nga komunitetet jo-shumicë. Kjo përfshin qasje të kufizuar në kujdesin shëndetësor, arsim, ndihmë sociale dhe strehim adekuat. Bashkëpunimi në mes vendeve dërguese dhe autoriteteve të Kosovës duhet të forcohet për të adresuar mangësitë në procesin e regjistrimit civil. Kjo çështje vazhdon për një numër të kufizuar të individëve (të lindur në vendin e azilit), për të cilët nuk është ofruar një certifikatë origjinale e lindjes.

Në përgjithësi, Kosova ka miratuar legjislacionin e ri dhe politikat në këtë fushë. Implementimi është në një fazë të hershme dhe shumë sfida mbesin për t'u adresuar. Sa i përket menaxhimit të integruar të kufijve, Kosova ka nevojë të përmirësojë bashkëpunimin brenda dhe ndërmjet agjencive. Informacionet e mbledhura duhet të bëhen të përshtatshme për vlerësimin e kërcënimeve strategjike. Sa i përket ri-integrimit, burime të mjaftueshme njerëzore duhet të alokohen tek departamentit i ri i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Koordinimi duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme në mes të ministrive, por edhe në mes të nivelit qendror dhe atë lokal. Autoritetet e Kosovës duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje nevojave (veçanërisht në arsim, punësimi dhe strehim) të personave nga komunitetet jo-shumicë. Përpjekjet e mëtejshme janë të nevojshme për të siguruar që bazat e të dhënave/sistemet e menaxhimit të çështjeve për migrim dhe ri-integrimin janë të besueshme dhe funksionale.

4.3.2. Pastrimi i parave

Një strategji për parandalimin e pastrimit të parave u miratua në vitin 2012. Në mars kanë hyrë në fuq ndryshimet në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ligji i rishikuar zgjeron dhe forcon mandatin e Njësisë së Inteligjencës Financiare (NjIF). Në

shkurt policia dhe NjIF kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi. Emërimi i zyrtarit ndërlidhës të policisë është ende në pritje. NjIF-ja ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me departamentin e regjistrimit të OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike për t'i mundësuar monitorim më të mirë të detyrimeve financiare të subjekteve raportuese. NjIF ka forcuar marrëdhëniet e saj me bankat në Kosovë. Ajo nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Bankën Qendrore të Kosovës për lejimin e inspektimeve të përbashkëta të Bankës dhe Njesisë.

Në vitin 2012, policia ka hetuar 120 raste që përfshijnë pastrimin e parave; 150 të dyshuar janë arrestuar, 800 kallëzime penale janë ngritur dhe mbi 460 raste janë dërguar për ndjekje penale. Nuk ka statistika mbi dëmin e përgjithshëm të shkaktuar. Gjatë periudhës raportuese NJIF trajtuan mbi 120 raste potenciale të pastrimit të parave/ financimit të terrorizmit. Rreth 40 raste janë përfunduar dhe afër 80 raste janë ende nën hetime. Drejtoria e policisë për krime ekonomik dhe korrupsion hapi 200 raste të reja në gjysmën e parë të vitit 2013. Në të njëjtën periudhë, NJIF-ja ka pranuar mbi 100 kërkesa për informata nga agjencitë e tjera, të tilla si policia, doganat dhe administrata tatimore. Ka pasur një rritje në numrin e raporteve të transaksioneve të dyshimta (rreth 130 në vitin 2011, 200 më shumë se në vitin 2012 dhe mbi 120 deri më sot).

Bashkëpunimi ndërmjet NjIF-së dhe doganave është i mirë. Aktiviteti i paligjshëm në importin dhe eksportin e sasive të mëdha të parave në Aeroportin e Prishtinës është i përfshirë në punën rutinore të doganave. Kjo është bërë një prioritet. Ka pasur një reduktim në konfiskimin e parave të gatshme në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 si rezultat i një fushate intensive të ndërgjegjësimit që çon në një rritje të deklarimit të parave të gatshme para nisjes.

Nuk është miratuar ende plani i veprimit për strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave. Zbatimi i legjislacionit dhe procedurave standarde të operimit janë të nevojshme për të forcuar zbatimin e ligjit të ri për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve relevante të sektorit publik mbi këto çështje duhet të jenë të standardizuara. Përveç kësaj, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e sektorit privat dhe e sektorit të tretë duhet të zgjerohet. Duhet të forcohen kapacitetet analitike dhe hulumtuese të NjIF-së. Duhet të kryhet një vlerësim i brendshëm dhe i jashtëm i kërcënimeve nga pastrimi i parave/financimi i terrorizmit. Duke pasur parasysh natyrën e të dhënave të trajtuara nga NjIF-ja, sistemi i brendshëm dhe i jashtëm i sigurisë duhet të përmirësohet. Për shkak të ndërlikueshmërisë së krimeve ekonomike dhe financiare dhe kundër-pastrimit të parave, eksperiencia e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit që punojnë në raste të tilla duhet të përmirësohet.

Në përgjithësi, Kosova ka vazhduar të përmirësojë legjislacionin e saj në këtë fushë. Megjithatë, zbatimi tani ka nevojë të përmirësohet. Institucionet për zbatim të ligjit dhe ato gjyqësore duhet të përmirësojnë njohuritë e tyre që të jenë në gjendje për të trajtuar këtë lloj të krimeve të ndërlikuara.

4.3.3. Droga

Kosova miratoi strategjinë 2012-2017 dhe planin e veprimit në luftën kundër trafikimit të drogave. Ka pasur një rritje të konsiderueshme në konfiskimet e drogës nga policia gjatë 2011-2012, sidomos sa i përket heroinës, kokainës dhe kanabisit. Sa i përket vitit 2013, ka një rënie relative e sasive të sekuestruara. Janë regjistruar rregullisht konfiskime të vogla të drogave sintetike. Numri i rasteve të lidhura me drogën është rritur nga afro 290 në vitin 2011 pak mbi 400 në vitin 2012. Tani ekzistojnë tetëmbëdhjetë qenë që janë për zbulimin e drogës në Kosovë.

Sa i përket parandalimit dhe zvogëlimit të dëmit, qeveria vendosi që të krijojë 'Observatorin e drogës' në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të nxitur dhe të mbështetur

kërkimin dhe monitorimin e drogave. Pasi të themelohet, ajo do të raportojë në Qendrën Evropiane të Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga. Përfshirja e policisë në parandalimin e përdorimit të drogës është rritur. Janë organizuar fushata ndërgjegjësimi në shkollat e mesme në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe EULEX-in. Programi metadon është duke u zbatuar në pesë lokacione. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2013, rreth 120 persona u janë nënshtruar trajtimit me metadon.

Kosova vazhdon të jetë një rajon transit dhe kryesisht për ruajtjen e heroinës që përfshin grupet lokale të krimit të organizuar. Rritja e konsiderueshme në konfiskimin e kanabisit në vitin 2012 sugjeron se Kosova është një rrugë transit për trafikimin e kanabisit nga plantacionet e Shqipërisë. Administrata doganore duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme për të zbuluar dhe kapur narkotikët në kufi/kufirin administrativ.

Në përgjithësi, rritja e burimeve të policisë që merren me drogë ka pasur disa rezultate pozitive në drejtim të sekuestrimit të drogës. Hetimet e ndara financiare ose hetimet e kombinuara me hetime kriminale në trafikim apo posedim të narkotikëve duhet të përforcohen duke emëruar shumë analistë dhe hetues financiarë.

4.3.4. Policia

Policia gjerësisht perceptohet si institucion i 'sundimit të ligjit' më i besuari në Kosovë. Është themeluar një njësi e veçantë për të mbrojtur dhe siguruar vendet kulturore dhe fetare. Policia është bërë më proaktive në krijimin dhe ruajtjen e partneriteteve me të gjitha komunitetet. Baza për këtë qasje është strategjia e policisë në komunitet dhe plani i veprimit 2012-2016 si dhe Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Janë krijuar shumica e këshillave komunale për Sigurinë në Bashkësi. Nevojitet që disa nga ato të përmirësojnë aktivitetet e tyre.

Ekspertët e Kosovës, EULEX-i dhe ekspertë të tjerë të BE-së janë duke punuar së bashku në drejtorinë për mbrojtjen e dëshmitarëve brenda policisë. Drejtoria është funksionale, por i nevojiten resurse shtesë dhe ngritje e kapaciteteve. Është miratuar zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit në mes të policisë dhe EULEX-it. Policia gjithashtu ka krijuar dhoma miqësore për intervistimin e fëmijëve në shtatë stacione rajonale. Është themeluar shoqata e grave në polici për të promovuar punën e policisë për gratë dhe adresimin e sfidave me të cilat ballafaqohen gratë në ndjekjen e një karriere brenda policisë. Një strategji mbi policinë në bashkësi të udhëhequr nga intelijenca u miratua në shkurt.

Ndarja e përgjegjësive ndërmjet inspektoratit të pavarur të policisë dhe njësisë së standardeve disiplinore të policisë janë të qarta dhe bashkëpunimi mes tyre është i mirë. Në vitin 2012, inspektorati ka pranuar rreth 1080 ankesa kundër zyrtarëve të policisë. Janë ngritur kallëzimet penale në mbi 120 raste dhe mbi 770 raste i janë referuar njësisë disiplinore. Zbatimi i masave disiplinore është ende një sfidë dhe disa hetime të rëndësishme penale nuk janë adresuar seriozisht.

Dhomat miqësore për intervistimin e fëmijëve në stacionet e policisë janë lënë të papërdorura. Kjo është për shkak të mungesës së zyrtarëve të specializuar dhe mungesës së një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e fëmijëve si kundërvajtës të dyshuar, viktime apo dëshmitarë të krimit. Nevojiten resurse më të përshtatshme në këtë fushë. Zbatimi i strategjisë së policisë në bashkësi ka filluar, por kapacitetet dhe ndërgjegjësimi duhet të ngritën edhe më tej. Policia kufitare gjithashtu duhet të jetë pjesë e programit të policisë në bashkësi. Policia në bashkësi nuk është përdorur ende në mënyrë efektive si një burim informacioni për policinë në bashkësi të udhëhequr nga intelijenca. Në përgjithësi, realizimi i policisë në bashkësi të udhëhequr nga intelijenca mbetet një sfidë.

Lidhjet në mes nivelit politik dhe menaxhmentit të policisë janë të ngushta. Ligji për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale u miratua në korrik. Njësia për

Bashkëpunim Ndërkombëtarë në Zbatimin e Ligjit në Ministrinë e Drejtësisë vazhdon të kryejë funksionet e saj në një mënyrë profesionale. Ajo ka proceduar mbi 1600 kërkesa për informacion në periudhën raportuese. Zyra Ndërlidhëse e Interpolit është nën përgjegjësinë e UNMIK-ut. Një zyrtar i policisë së Kosovës ka qenë i deleguar në këtë zyrë. Në vitin 2012, Zyra Ndërlidhëse e UNMIK-ut lehtësoi 31 fletë arreste ndërkombëtare kundër personave të kërkuar ndërkombëtarisht për arrest të përkohshëm (në krahasim me 27 në vitin 2011). Dymbëdhjetë ekstradime nga/në Kosovë janë kryer në vitin 2012. Në vitin 2013, janë lehtësuar dhjetë ekstradime dhe një deportim.

Në përgjithësi, Kosova ka krijuar struktura të reja në kuadër të policisë, sidomos në drejtorinë për mbrojtje të dëshmitarëve. Gjithashtu ka përmirësuar edhe strukturat që merren me policinë në bashkësi. Policia duhet të fokusohet në ofrimin e rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar (përfshirë drogën, trafikimin me qenie njerëzore dhe armëve), dhe luftën kundër korrupsionit. Nevojiten më shumë resurse për mbrojtjen e dëshmitarëve. Zbatimi i policisë në bashkësi i udhëhequr nga inteligjenca mbetet një sfidë e veçantë. Duhet të sigurohet zbatimi i masave disiplinore.

4.3.5. Luftimi i krimit të organizuar dhe terrorizmit

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi miratoi katër strategji dhe plane të veprimit në luftën kundër **krimit të organizuar**, terrorizmit, trafikimit të narkotikëve dhe në parandalimin e krimit. Në nëntor, Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi një plan strategjik për bashkëpunimin ndër-institucional për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Një bazë e të dhënave (mekanizëm përcjellës) u krijua në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor, policinë dhe agjencionet tjera. Qëllimi është që të sigurohet një pasqyrë e hetimeve, ndjekjeve penale dhe vendimeve përfundimtare të gjykatës për rastet që lidhen me veprat penale të krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të armëve, trafikimit të drogës dhe pastrimit të parave.

Ligji mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e aseteve u miratua në shkurt. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ka vazhduar të funksionojë dhe vëllimi i aseteve të konfiskuara është rritur pakë. Kosova u bë anëtare e Rrjetit të Ndër-Agjencioneve të Rikthimit të Aseteve Camden (CARIN) në vitin 2012. Policia dhe prokurorët vendorë bashkëpunojnë mirë me homologët e tyre të EULEX-it në nivel operacional.

Krimi i organizuar mbetet një shqetësim serioz në Kosovë. Frikësimi i dëshmitarëve vazhdon të jetë një shqetësim. Gjykimet më të ndjeshme për krimet e organizuara dhe korrupsionin vazhdojnë të jenë të kryesuara nga panele të përziera të gjyqtarëve vendorë dhe të EULEX-it. Prokuroria Speciale është në proces të transferimit gradual të përgjegjësisë për ndjekjet penale të profilit të lartë nga ndërkombëtarët tek vendorët. Agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet e Kosovës duhet të bashkëpunojnë në një mënyrë më të strukturuar me qëllim që të jetë më efikas dhe efektiv në hetime.

Kosova duhet të krijojë një kornizë të shëndoshë ligjore për përgjimin e telekomunikimeve. Nevojitet të bëhet një dallim i qartë në mes të përgjimit gjyqësor dhe përgjimit për qëllime të inteligjencës. Kjo është për të shmangur ndikimin e mundshëm politik në rastet penale dhe për të siguruar mbikëqyrje adekuate gjyqësore.

Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë demonstruar një hezitim për të nisur hetime financiare. Si rezultat numri i konfiskimeve dhe sekuestrimeve të urdhëruara nga gjyqësori dhe të ekzekutuara nga policia është i ulët. Gjyqësori, veçanërisht prokurorët, duhet të përdorin dispozitat mbi konfiskimin në mënyrë më proaktive. Mandati dhe zinxhiri i përgjegjësive i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar duhet të qartësohen për të gjitha palët e interesit të përfshira në proces. Bashkëpunimi mes këtyre palëve të interesit duhet të

përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme.

Konsideratat përkitazi me statusin e Kosovës vazhdojnë të ndikojnë në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar. Në të njëjtën kohë, policia ishte pjesë e një operacioni të përbashkët me EUROPOL-in në fillim të vitit 2013.

Ligji i ri për parandalimin dhe luftimin e **trafikimit me qenie njerëzore** dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, u miratua në korrik. Drejtoria e Policisë për hetimin e trafikimit me qenie njerëzore në rreth 100 raste ka bërë 180 arrestime në periudhën raportuese dhe janë identifikuar 60 viktima. Në të njëjtën periudhë, prokuroria dhe gjykatat kanë zgjidhur vetëm një numër të kufizuar të kallëzimeve penale dhe lëndëve. Janë arrestuar anëtarët e nëntë grupeve kriminale të përfshira në trafikimin me qenie njerëzore. Janë kryer 19 shkëmbime të informacionit me shtetet e tjera. Janë përpiluar dhe zbatuar procedurat standarde të operimit mbi kujdesin ndaj viktimave. Fushatat për ngritjen e ndërgjegjësimit u organizuan në vitin 2012 dhe janë planifikuar për 2013-2014.

Në prill, pesë persona janë shpallur fajtorë në rastin Medicus të transplantimit të paligjshëm të organeve nga një panel i përbërë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari vendor në gjykatën themelore të Prishtinës. Ata u dënuan në total njëzet vjet për vepra penale të krimit të organizuar, trafikimit me qenie njerëzore dhe shkaktim të lëndimeve të rënda trupore.

Kosova mbetet një vend origjine dhe transiti për viktimat e trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual me një rritje në numrin e viktimave të mitur. Trafikimi i fëmijëve dhe shfrytëzimit të fëmijëve me qëllim të lypjes së lëmshës gjithashtu mbeten të larta. Shkalla e dënimeve për këto krime është e ulët. Duhet të zhvillohet një qasje gjithëpërfshirëse, multi-disiplinore dhe e orientuar në problemin e viktimave si dhe identifikimi i viktimave ka nevojë të përmirësohet më tej. Është thelbësor financimi i qëndrueshëm dhe adekuat i qeverisë për strehimore dhe ri-integrimin e viktimave. Viktimat duhet të kenë qasje të papenguar në ndihma, përkrahje dhe mbrojtje, duke përfshirë edhe ri-integrimin e viktimave pas kthimit. Duhet të përshpejtohet bashkëpunimi me shoqërinë civile si dhe përpjekjet për masa efektive parandaluese.

Policia ka themeluar një njësi të hetimeve të krimeve kibernetike në vitin 2011. Rastet e krimeve kibernetike janë identifikuar si vepra penale që lidhen me ndërhyrje në sistemin kompjuterik ose mashtrime me kartela krediti. Për këtë arsye ato nuk janë të regjistruar si raste të krimeve specifike kibernetike. Që nga themelimi i saj njësia ka hetuar 30 raste dhe ka ofruar ndihmë për hetime të tjera.

Strategjia e Kosovës në **luftën kundër terrorizmit** pasqyron 'parandalim, mbrojtje, ndjekje dhe reagim' linjat e strategjisë së kundër-terrorizmit të BE-së. Kërcënimi nga terrorizmi është i ulët, edhe pse ka disa shqetësime në lidhje me radikalizmin dhe grupet ekstremiste dhe financimin e tyre. Kjo duhet të monitorohet.

Në përgjithësi, në masë të madhe është krijuar korniza ligjor, por zbatimi është i kufizuar. Kjo është pjesërisht për shkak të mungesës së kapacitetit. Kosova ka nevojë të përmirësoj nivelin e ekspertizës për të trajtuar hetime komplekse penale. Një rritje e burimeve për policinë në luftën e saj kundër trafikimit me qenie njerëzore nuk ka pasur përmirësime. Koordinatorët e strategjive dhe planeve të veprimit duhet të bashkëpunojnë më mirë dhe të përqendrohen në zbatim. Kosova duhet të krijoj një kornizë të shëndoshë ligjore për përgjimin e telekomunikimeve. Nevojitet zbatim më proaktiv i ligjit të ri për konfiskimin e pasurisë. Krimi kibernetik është një çështje për të cilën Kosova duhet të jetë më mirë e përgatitur, edhe pse ato nuk ndodhin aq shpesh. Po ashtu, duhet të bëhen përgatitje dhe monitorim më i mirë kur është fjala për luftën kundër terrorizmit.

4.3.6 Mbrojtja e të dhënave personale

Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është pothuajse plotësisht e plotësuar me

personel dhe të gjitha pjesët e legjislacionit zbatues janë miratuar. Agjencia ka bërë përpjekje të vendosur për të rritur ndërgjegjësimin e punës së saj përmes një numri të aktiviteteve të kontaktimit duke marrë në fokus organet publike dhe private. Ajo ka kryer një seri të inspektimeve të drejtpërdrejta, sipas detyrës zyrtare dhe të përgjithshme. Agjencia gjithashtu ka dhënë komente për projektligjet. Agjencia mbanë një anëtar të personelit me orar të plotë në polici.

Agjencia vazhdon të përballet me vështirësi në rekrutimin e stafit nga komunitetet pakicë. Aktivitetet operative të agjencisë janë rritur, por i duhet ende angazhim që të arrijë momentumin. Agjencia ka nevojë që të ngritë më tutje kapacitetin dhe ekspertizën e saj. Agjencia duhet të marrë një qasje proaktive dhe të pavarur për kontrolle si në sektorët privat ashtu edhe ata publik. Shqetësimet për mbrojtjen e të dhënave personale të parashtruara në polici duhet të adresohen me shpejtësi.

Në përgjithësi, mbrojtja e të dhënave personale në Kosovë është në fazat e saj të hershme. Agjencia duhet të mbështes zbatimin e legjislacionit si në sektorët publikë ashtu edhe në atë privatë. Ajo duhet të jetë më pro-aktive dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur.

Shtojca Statistike

TË DHËNAT STATISTIKORE

Kosovë

| Të dhëna themelore | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Popullsia (mijë) | 1) | : | 2 153 | 2 181 | 2 208p | 1,799 | 1,816 |
| Territori gjithsej (km ²) | | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 | 10 887 |
| Llogaritë nacionale | | | | | | | |
| Bruto Produkti Vendor (BPV) (për milion euro) | 2) 3) | 1 624 | 3 940e | 4 008e | 4 291e | 4 776e | : |
| BPV (Euro për kokë banori) | 4) | : | 2 291e | 2 293e | 2 418e | 2 650e | : |
| BVP(sipas Standardeve të fuqisë blerëse (SFB) për kokë banori) | | : | : | : | : | : | : |
| BPV për kokë banori në SFB (BE-27 = 100) | | : | : | : | : | : | : |
| Shkalla reale e rritjes së BPV-së (shkalla e rritjes së vëllimit të BVP-së, monedha nacionale, ndryshimi në % në vitin e kaluar) | 5) | : | 7.2 | 3.5 | 3.2 | 4.5 | : |
| Rritja e punësimit (llogaritë nacionale, ndryshimi në % në vitin e kaluar) | | : | : | : | : | : | : |
| Rritja e produktivitetit të punës: rritja e BPV-së për person të punësuar (ndryshimi në % në vitin e kaluar) | | : | : | : | : | : | : |
| Rritja reale e njësisë së kostos së punës (llogaritë nacionale, ndryshimi në % në vitin e kaluar) | | : | : | : | : | : | : |
| Produktiviteti i punës për një person të punësuar (BPV në SFB për person të punësuar, EU-27 = 100) | | : | : | : | : | : | : |
| Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesor (%) | | | | | | | |
| Bujqësia dhe peshkimi | | : | 15.1 | 15.1 | 17.1 | 17.5 | : |
| Industria | | : | 17.3 | 18.9 | 17.3 | 16.6 | : |
| Ndërtimtaria | | : | 9.4 | 9.5 | 10.1 | 9.9 | : |
| Shërbimet | | : | 58.3 | 56.5 | 55.6 | 56.1 | : |
| Shpenzimet e konsumit final, si pjesë e BPV-së (%) | | : | 110.3 | 107.3 | 106.2 | 105.2 | : |
| Formimi i kapitalit të fiksuar bruto, si pjesë e BPV-së (%) | | : | 23.8 | 25.6 | 27.8 | 28.8 | : |
| Ndryshimet në inventar, si pjesë e BPV-së (%) | | : | 4.0 | 3.4 | 3.5 | 3.3 | : |
| Eksporti i mallrave dhe shërbimeve, në raport me GDP (%) | 6) | : | 15.5 | 16.4e | 19.5 | 20.1 | : |
| Importi i mallrave dhe shërbimeve, në raport me GDP (%) | | : | 53.5 | 52.8 | 56.9 | 57.3 | : |
| Industria | | | | | | | |
| Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2010=100) | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
| | | : | : | : | : | : | : |
| Shkalla e inflacionit | | | | | | | |
| Shkalla mesatare e Inflacionit vjetor (CPI, ndryshimi në % në vitin e kaluar) | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
| | | : | 9.4 | -2.4 | 3.5 | 7.3 | 2.5 |
| Bilanci i pagesave | | | | | | | |
| Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: gjithsej (milion euro) | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
| | | 228 | -461 | -374 | -516 | -658 | -380 |
| Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: bilanci tregtar (milion euro) | | -646 | -1 650 | -1 652 | -1 752 | -2 059 | -2 073 |
| Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: shërbimet neto (milion euro) | | 10 | 152 | 232 | 187 | 266 | 346 |
| Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: të hyrat neto (milion euro) | | 141 | 164 | 62 | 67 | 114 | 154 |
| Bilanci i pagesave llogari rrjedhëse: transferet aktuale neto (milion euro) | | 723 | 873 | 983 | 982 | 1 021 | 1 192 |
| Nga të cilat transfere të Qeverisë (milion euro) | | 809 | 224 | 323 | 320 | 322 | 402 |
| Investimet e huaja direkte neto (IHD) (milion euro) | | : | 342 | 281 | 331 | 379 | 216 |
| Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro) | | : | -25 | -11 | -35 | -16 | -16 |
| Prej të cilave IHD të ekonomisë së raportuar në 27 vendet e BE-së (milion euro) | | : | -9 | -2 | -1 | 0 | -5 |
| Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë e raportuar (milion euro) | | : | 366 | 291 | 366 | 395 | 232 |
| Prej të cilave IHD të 27 vendeve të BE-së në ekonominë e raportuar (milion euro) | | : | 212 | 184 | 218 | 205 | 86 |
| Financat Publike | | | | | | | |
| Deficiti/suficiti i përgjithshëm i qeverisë, në raport me BPV (%) | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
| | | : | : | 7.7 | 7.6 | 6.7e | : |
| Bruto borxhi i jashtëm i gjithë ekonomisë, në raport me eksportet totale (%) | | : | 3.6 | 6.9 | 4.6 | 4.6 | 5.0 |
| Oferta e parasë: M1 (bankënota, monedha, depozita brenda nate, milion euro) | | 971 | : | : | : | : | : |
| Oferta e parasë: M2 (M1 plus depozitat me maturim deri në dy vjet, milion euro) | | 1 096 | : | : | : | : | : |
| Oferta e parasë: M3 (M2 plus instrumentet e tregtueshme, milion euro) | | : | : | : | : | : | : |
| Kredidhënia totale nga institucionet monetare financiare për banorë (e konsoliduar) (milion euro) | | 26 | 1 183 | 1 289 | 1 459 | 1 698 | 1 763 |
| Shkalla e interesit: shkalla e parasë ditë pas dite, për vit (%) | | : | : | : | : | : | : |
| Shkalla e interesit në kredi (një vit), për vit (%) | 7) | : | 14.8 | 14.1 | 14.3 | 13.7 | 13.8 |
| Shkalla e interesit në depozita (një vit), për vit (%) | 7) | : | 4.2 | 4.0 | 3.4 | 3.7 | 3.6 |

| | | | | | | | |
|---|----|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Shkalla e këmbimit të euros: mesatarja e periudhës - 1 euro = ... monedhë nacionale | 2) | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 | 1.000 |
| Indeksi i shkallës efektive të këmbimit (2005=100) | : | : | : | : | : | : | : |
| Vlera e asetëve rezervë (përfshirë arin) (milion euro) | | 286 | 670 | 577 | 635 | 575 | : |

Tregtia e jashtme

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|--------|------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Vlera e importeve: gjitha mallrat, gjithë partnerët (milion euro) | | : | 1 930 | 1 934 | 2 146 | 2 492 | 2 488 |
| Vlera e eksporteve: gjitha mallrat, gjithë partnerët (milion euro) | | : | 196 | 165 | 292 | 319 | 270 |
| Bilanci tregtar: gjitha mallrat, gjithë partnerët (milionë euro) | | : | -1 734 | -1 769 | -1 854 | -2 173 | -2 218 |
| Mënyrat e tregtimit (indeksi i çmimit të eksportit/ indeksi i çmimit të importit) | | : | 1.0 | 1.0 | 1.2 | 1.0 | : |
| Hisja e eksporteve në 27 vendet e BE-së në vlerën e totalit të eksportit | | : | 47.7 | 43.1 | 45.1 | 42.8 | 39.6 |
| Hisja e importeve nga 27 vendet e BE-së në vlerën e totalit të importit | | : | 36.2 | 39.0 | 38.5 | 38.0 | 39.0 |

Demografia

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|------|------|------|------|--------|------|
| Shkalla e Rritjes së natyrshme: ndryshimi natyral (lindjet minus vdekjet) (në 1000 banorë) | | : | 12.7 | 12.5 | : | 11.4bp | 11.3 |
| Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave: vdekjet e fëmijëve nën moshën një-vjeçare për 1000 lindje të gjalla | | : | 9.7 | 9.9 | : | 12.1e | 11.4 |
| Jetëgjatësia e pritur në lindje: meshkuj (vjet) | | : | : | : | : | 68.0e | 69.0 |
| Jetëgjatësia e pritur në lindje: femra (vjet) | | : | : | : | : | 71.9e | 71.0 |

Tregu i punës

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|
| Shkalla e veprimtarisë ekonomike (20-64): hisja e popullsisë në moshë 20-64 që është ekonomikisht aktive (%) | | : | : | : | : | : | : |
| * Shkalla e punësimit (20-64): hisja e popullsisë në moshë 20-64 në punësim (%) | | : | : | : | : | : | : |
| Shkalla e punësimit: meshkuj (20-64) (%) | | : | : | : | : | : | : |
| Shkalla e punësimit: femra (20-64) (%) | | : | : | : | : | : | : |
| Shkalla e punësimit të punëtorëve të moshuar (55-64): hisja e popullsisë në moshë 55-64 në punësim (%) | | 16.7 | 23.8 | 27.9 | : | : | : |
| Punësimi sipas sektorëve kryesorë (%) | | | | | | | |
| Bujqësia | | 6.2 | 8.0 | 6.2 | : | : | : |
| Industria | | 16.9 | 15.4 | 15.5 | : | : | : |
| Ndërtimtaria | | 8.6 | 8.6 | 7.9 | : | : | : |
| Shërbimet | | 68.3 | 65.3 | 67.5 | : | : | : |
| Shkalla e papunësisë: hisja e fuqisë punëtore që është e papunë (%) | | 57.1 | 47.5 | 45.4 | : | : | 35.1 |
| Hisja e fuqisë punëtore mashkullore të papunë (%) | | 51.8 | 42.7 | 40.7 | : | : | : |
| Hisja e fuqisë punëtore femërore të papunë (%) | | 69.9 | 59.6 | 56.4 | : | : | : |
| Shkalla e papunësisë së personave < 25 vjeç: hisja e fuqisë punëtore në moshë <25 vjeç e papunë (%) | | 80.0 | 73.0 | 73.0 | : | : | : |
| Shkalla e papunësisë afatgjate: hisja e fuqisë punëtore e papunë për 12 muaj e më shumë (%) | | 47.6 | 38.9 | 37.1 | : | : | : |

Kohezioni social

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|
| Pagat dhe mëditjet nominale mujore mesatare (valuta kombëtare) | | : | : | : | : | : | : |
| Indeksi i pagave dhe mëditjeve reale (Indeksi i pagave dhe mëditjeve reale pjesëtuar me CPI/HICP) (2000=100) | | : | : | : | : | : | : |
| * Braktisja e hershme e shkollës – hisja e popullsisë së moshës 18-24 vjeç me më së shumti shkollim të ulët të mesëm dhe jo më tutje arsimi dhe trajnim (%) | | : | : | : | : | : | : |

Standardi i jetesës

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|--------|------|-------|-------|-------|--------|-------|
| Numri i automjeteve të udhëtarëve për 1000 persona | | : | 74.1 | : | 90.6p | 111.2e | 111.3 |
| Numri i abonimeve në shërbime të telefonisë celulare për 1000 persona | | : | 376.2 | 369.2 | : | : | : |

Infrastruktura

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|
| Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksion, në 1000 km ²) | | : | : | 30.6 | 30.3 | 30.6 | 30.6 |
| Gjatësia e autostradave (km) | | :z | :z | :z | :z | :z | 60 |

Inovacioni dhe hulumtimet

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|--------|------|------|------|------|------|------|
| Shpenzimet në resurse njerëzore (shpenzime publike në arsim në % të BPV-së) | | : | : | : | : | : | : |
| * Bruto shpenzimet vendore në Kërkim/Zhvillim në % të BPV-së | | : | : | : | : | : | : |
| Përqindja e amvisërive që kanë qasje në internet në shtëpi (%) | | : | : | : | : | : | : |

Mjedisi

| | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|
| * Emetimet e gazrave serrë, ekuivalent me CO2 (tonë, 1990=100) | | : | : | : | : | : | : |
| Intensiteti i energjisë së ekonomisë (kg naftë ekuivalent për 1000 euro BPV) | | : | : | : | : | : | : |
| Energjia elektrike e prodhuar nga burimet e ripërtërishe në % të bruto-konsumit elektrik | | : | : | : | : | : | : |
| Hisja rrugore e transportit të mallrave brenda vendit (% e ton-km) | | : | : | : | : | : | : |

| Energjia | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---|--------|------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Prodhimi primar i gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : |
| Prodhimi primar i naftës së papërpunuar (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : |
| Prodhimi primar i thëngjillit të fortë dhe linjtit (mijëra TOE) | 8) | : | 5 466 | 7 842 | 7 960 | 8 212 | 8 028 |
| Prodhimi primar i gazit natyror (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : |
| Neto-importet e gjitha produkteve energjetike (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : |
| Bruto-konsumi i energjisë brenda vendit (mijëra TOE) | | : | : | : | : | : | : |
| Gjenerimi elektrik (mijëra GVVh) | | : | : | 5.3 | 5.5 | 5.7 | 5.9 |

| Bujqësia | Shënim | 2001 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|--|--------|------|------|------|------|------|------|
| Indeksi i mallrave dhe shërbimeve në vëllimin e prodhimit bujqësor (çmimet e prodhuesit, viti i kaluar =100) | | : | : | : | : | : | : |
| Gjithsej sipërfaqe bujqësore e shfrytëzuar (mijëra hektarë) | | 539 | : | : | : | : | : |
| Bagëtia: gjedhë (mijëra krerë, fundi i periudhës) | | 347 | 342 | 344 | 357e | 362e | 314 |
| Bagëtia: derra (mijëra krerë, fundi i periudhës) | | 75 | 27 | 51 | 51e | 51e | 56 |
| Bagëtia: dele e dhi (mijëra krerë, fundi i periudhës) | | 230 | 180 | 217 | 229e | 247e | 123 |
| Prodhimi dhe shfrytëzimi i qumështit në fermë (totali i përgjithshëm i qumështit mijëra tonë) | | : | : | : | : | : | : |
| Të korrat: drithëra (përfshirë orizin) (mijëra tonë, prodhimi në të korra) | | 459 | 438 | 411 | 423e | 430e | 428 |
| Të korrat: panxharsheqeri (mijëra tonë, prodhimi në të korra) | | : | : | : | : | : | : |
| Të korrat: perime (mijëra tonë, prodhimi në të korra) | | 169 | 176 | 144 | 248e | 254e | 135 |

: = nuk është në dispozicion
:z = nuk është e aplikueshme
b = ndarja në seri
e = vlerë e supozuar
p = e përkohshme
* = indikator i Evropa 2020

Konventat e shenjave për bilancin e pagesave përdoren për IHD. Për IHD jashtë vendit, shenja e minusit do të thotë që investimi jashtë vendit nga ekonomia raportuese ka tejkalluar de-investimin gjatë periudhës, derisa shënimi pa shenjë do të thotë de-investimi ka tejkalluar investimin. Për IHD-të në ekonominë e raportimit shënimi pa shenjë do të thotë që investimi në ekonominë e raportuar ka tejkalluar de-investimin, derisa shenja e minusit tregon që de- investimi ka tejkalluar investimin.

Fusnotat:

- 1) Numri i popullsisë bazohet në regjistrimin e fundit të vitit 2011 dhe shifrat e përafërta që i posedon Agjencia e Statistikave të Kosovës për 3 komunat në veri të cilat nuk kanë marrë pjesë në regjistrim dhe rritje natyrore për periudhën 15 prill deri më 31 dhjetor të vitit 2011.
- 2) Valuta në përdorim është Euro
- 3) Shifrat për vitet 2008 - 2010 janë rishikuar për shkak të rishikimit të të dhënave të BoP.
- 4) Shifrat e BPV-së janë rishikuar në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë në prill të vitit 2011.
- 5) Shifrat 2008 - 2010 janë rishikuar për shkak të rishikimit të të dhënave të BOP në BQK (Dhjetor 2011) për vitet 2008-2010. Këto ndryshime kanë ndikuar në normën e rritjes së BPV-së për vitet e cekura.
- 6) Vlerat e ndërruara nga një raport i lartë i importeve në krahasim me eksportet e mallrave dhe shërbimeve.
- 7) Që nga janari i 2008, normat e interesit mbi kreditë përfshijnë tarifën e pagesës që vendoset nga bankat
- 8) Prodhimi vendor i qymyrit në mijëra ton.